FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 142

Tiranë – E hënë, 2 tetor 2023

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 553, datë 28.9.2023	Për indeksimin e pensioneve.....	15943
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 524, datë 8.9.2023	Për zbatimin e rekomandimit [rec. ICCAT 22-08] "Për ndryshimin e rekomandimit 21-08, për hartimin e një plani menaxhimi shumëvjeçar për tonin në Atlantikun Lindor dhe detin Mesdhe".....	15945
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 212, datë 27.6.2023	Mbi miratimin e "Udhëzuesit për testimin e tregut për Gazsjellësin Trans Adriatik".....	15996
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 268, datë 11.9.2023	Mbi licencimin e shoqërisë "Joint Venture 2B 1979 dhe 2T" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 1950 *kw*.....	15998
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 269, datë 11.9.2023	Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë "Selca Energji" sh.p.k. për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC "Selca".....	15999
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës nr. (11-2023-4767) 952, datë 12.7.2023	Vendim *(i shkurtuar)* për shpalljen të zhdukur të shtetases Ermira Xhaferri.....	16001

VENDIM
Nr. 553, datë 28.9.2023

PËR INDEKSIMIN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 61 e 88, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 17, të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", të ndryshuar, të nenit 24, të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, "Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë", të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 9128, datë 29.7.2003, "Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension", të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 150/2014, "Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë", të nenit 6/1, të ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë", të ndryshuar, të nenit 1, të ligjit nr. 8455, datë 4.2.1999, "Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit", të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 9361, datë 24.3.2005, "Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundrues të nëndetëseve dhe palombarëve të forcave detare në pension", të nenit 8, të ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake", të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit nr. 29/2019, "Për trajtimin financiar suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji", të shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr. 129/2021, "Për statusin 'Fëmijë në përkujdesje të Republikës"', dhe të nenit 4, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Indeksimin në masën 8.6 për qind të:

a) pensioneve të caktuara sipas ligjeve nr. 4171, datë 13.9.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", nr. 4976, datë 29.6.1972, "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë", dhe nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

b) pensioneve sociale, të caktuara në përputhje me ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

c) shtesës mujore, të përfituar me vendimin nr. 326, datë 21.6.1993, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar";

ç) pensioneve të caktuara me dekretin nr. 758, datë 1.2.1994, të Presidentit të Republikës, "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut";

d) shtesës mbi pension, të dhënë sipas nenit 33, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

dh) shtesave mbi pension, të dhëna sipas neneve 38, 39 dhe 48, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe nenit 24, të ligjit nr. 4171, datë 13.6.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë";

e) pensioneve të caktuara dhe të rillogaritura me ligjin nr. 10142, datë 15.5.2009, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara me nenin 21, të këtij ligji;

ë) trajtimeve të veçanta financiare të familjeve të pilotëve fluturues, të caktuara sipas ligjeve nr. 8455,

datë 4.2.1999, "Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit", të ndryshuar, dhe nr. 9128, datë 29.7.2003, "Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension", të ndryshuar;

f) trajtimeve të veçanta financiare të caktuara sipas ligjit nr. 9361, datë 24.3.2005, "Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundrues të nëndetëseve dhe palombarëve të forcave detare në pension";

g) trajtimeve të veçanta financiare të punonjësve të minierave, të caktuara sipas ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë", të ndryshuar;

gj) pensioneve të pleqërisë të punonjësve të minierave, të caktuara me ligjin nr. 150/2014, "Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë";

h) trajtimeve të veçanta financiare të caktuara sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake", të ndryshuar;

i) pensioneve suplementare të caktuara sipas ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, "Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë";

j) pensioneve suplementare të caktuara sipas ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", të ndryshuar;

k) shpërblimit të caktuar sipas ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, "Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", të ndryshuar;

l) pensioneve shtetërore të posaçme të caktuara në përputhje me nenin 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

ll) përfitimeve të caktuara sipas ligjit nr. 29/2019, "Për trajtimin financiar suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji";

m) trajtimeve të veçanta financiare sipas neneve 5/1/a dhe 5/1/b, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

n) trajtimit financiar, sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr. 129/2021, "Për statusin 'Fëmijë në përkujdesje të Republikës'".

2. Indeksimin, sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij vendimi, e përfitojnë edhe pensionet që do të caktohen nga data 1.10.2023 e në vazhdim, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri në datën 30.9.2023, përfshirë edhe këtë datë.

3. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përllogariten në shumën 3 184 000 000 (tre miliardë e njëqind e tetëdhjetë e katër milionë) lekë, të cilat përballohen nga fondi për politikat e indeksimit të pensioneve, të parashikuar në buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH) të vitit, të cilat ndahen, si më poshtë vijon:

a) 3 144 000 000 (tre miliardë e njëqind e dyzet e katër milionë) lekë, për mbulimin e pagesave të përfitimeve;

b) 40 000 000 (dyzet milionë) lekë, për procedurat teknike të zbatimit të këtij vendimi dhe për pagesën e komisioneve të shërbimit të pagesave të pensioneve nga Posta Shqiptare sh.a., dhe bankat e nivelit të dytë.

4. Rregulla të hollësishme për zbatimin e këtij vendimi përcaktohen me udhëzim të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

5. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.10.2023.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

URDHËR
Nr. 524, datë 8.9.2023

PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMIT [REC. ICCAT 22-08] "PËR NDRYSHIMIN E REKOMANDIMIT 21-08, PËR HARTIMIN E NJË PLANI MENAXHIMI SHUMËVJEÇAR PËR TONIN NË ATLANTIKUN LINDOR DHE DETIN MESDHE"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 8, pikat 1 dhe 2 të Konventës Ndërkombëtare për Ruajtjen e Peshkut Ton të Atlantikut, të miratuar me ligjin nr. 9822, datë 29.10.2007, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Ruajtjen e Peshkut Ton të Atlantikut (ICCAT)", dhe të nenit 25, pika 4, të ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, "Për peshkimin", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Zbatimin e Rekomandimit 22-08 të ICCAT-it, "Për ndryshimin e rekomandimit 21-08, për hartimin e një plani menaxhimi shumëvjeçar për tonin në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe", bashkëlidhur këtij urdhri, dhe që është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, për zbatimin e pikave 1–10, 12–29, 33–34, 36–60, 61–73, 76, 80–91, 93, 95–109, 111–129, 131–139, 140–194, 196–206, 207–218, 226–228, 235–236, si dhe shtojcat 1–2, 5 dhe 8–13, të rekomandimit 22–08 të ICCAT-it.

3. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës për zbatimin e pikave 94, 219–225, 229–232, si dhe shtojcat 6–7, të Rekomandimit 22–08 të ICCAT-it.

4. Subjektet e anijeve të peshkimit apo të fermës zbatojnë detyrimet që rrjedhin nga pikat 74–75, 77, 79, 92, 110–112, 119, 121, 124, 130, 133, 146–150, 167–168, 192–194, 195–198, 215–217, si dhe shtojcat 2, 3, 4, 8, 9, 11 dhe 112, të rekomandimit 22-08 të ICCAT-it.

5. Pikat e tjera të rekomandimit 22-08, të paparashikuara në pikat 2–4 të këtij urdhri, janë të detyrueshme për institucionet dhe subjektet e mësipërme, në rast se Shqipëria do të zhvillojë aktivitetet e rregulluara sipas këtyre pikave.

6. Peshkimi i tonit do të kryhet vetëm me mjetet lundruese që përdorin formën e peshkimit me koshilok (me rrethim) sipas parashikimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 719, datë 12.10.2016, "Për menaxhimin e kapaciteteve të peshkimit tregtar dhe disa rregullime të mënyrës së funksionimit të regjistrit të anijeve të peshkimit", të ndryshuar.

7. Urdhri nr. 385, datë 8.9.2022, "Për zbatimin e rekomandimit ICCAT 'Për ndryshimin e rekomandimit 19-04, për ndryshimin e rekomandimit 18-02, për hartimin e një plani menaxhimi shumëvjeçar për tonin në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe' [rec. ICCAT 21-08]", shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe subjektet e anijeve të peshkimit dhe fermës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

REKOMANDIMI I ICCAT-it PËR NDRYSHIMIN E REKOMANDIMIT 21-08, PËR HARTIMIN E NJË PLANI MENAXHIMI SHUMËVJEÇAR PËR TONIN E KUQ NË ATLANTIKUN LINDOR DHE DETIN MESDHE

Duke pranuar këshillën e **SCRS-së** për të konsideruar kalimin nga plani aktual i rimëkëmbjes në një plan menaxhimi dhe se statusi aktual i stokut nuk ka nevojë për masa emergjente të paraqitura në kuadrin e planit të rimëkëmbjes për tonin në Atlantikun Lindor dhe në Detin Mesdhe (rekomandimi- 170707 nga ICCAT-i që ndryshon rekomandimin 14-04);

Duke marrë parasysh që SCRS-ja ka kryer një vlerësim të strategjisë së menaxhimit (**MSE**) për të krijuar një procedurë menaxhimi (**MP**), e cila përfshin rregullat e kontrollit të zënieve (HCR), dhe Komisioni ka vendosur për MP-në në takimin e tij

vjetor të 2022-shit për të krijuar TAC për 2023 e më pas;

Duke pranuar me tej ndikimet e planit të rimëkëmbjes së tonit në flotën e peshkimit artizanal në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe, sidomos në lidhje me reduktimin e kapacitetit të peshkimit;

Duke marrë parasysh kapacitetin e stokut për t'u përgjigjur rekrutimit të ulët në disa vite të njëpasnjëshme, kjo do të jetë e rëndësishme për të siguruar që kapaciteti i peshkimit të mbetet brenda kufijve të qëndrueshëm dhe se kontrolli i kapacitetit mbetet efektiv;

Duke marrë në marrë konsideratë rëndësinë e ruajtjes së qëllimit dhe integritetit të masave të kontrollit dhe përforcimin e gjurmueshmërisë së zënieve, veçanërisht në lidhje me transportin e peshqve të gjallë dhe aktiviteteve në fermat e rritjes;

Duke marrë parasysh se u identifikuan dispozita të ndryshme në rekomandimin 21-08 që do të përfitonin nga qartësimi ose përmirësimi dhe përforcimi.

KOMISIONI NDËRKOMBËTAR PËR KONSERVIMIN E TONIT TË ATLANTIKUT (ICCAT) REKOMANDON QË:

PJESA I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME DHE OBJEKTIVAT

1. Palët Kontraktuese dhe Palët Bashkëpunuese jokontraktuese, subjektet ose entitetet e peshkimit referuar më poshtë si CPCs, anijet e të cilave kanë peshkuar në mënyrë aktive tonin *(Thunnus thynnus)* në Atlantikun Lindor dhe në Detin Mesdhe do të zbatojnë një plan menaxhimi për tonin në atë zonë gjeografike, duke filluar në vitin 2023, bazuar në procedurat e menaxhimit (MP), sipas parashikimeve të rekomandimit të Rekomandimit ICCAT për vendosjen e Procedurave të Menaxhimit për tonin e kuq që duhet të zbatohen në Atlantikun e Perëndimor dhe Lindor dhe zonën e menaxhimit të Mesdheut (Rec. 22-09).

Përkufizimet

2. Për qëllimet e këtij rekomandimi:

a) "Anije peshkimi" është çdo anije e përdorur për qëllimin e shfrytëzimit për qëllime komerciale të resurseve të tonit, duke përfshirë anijet peshkuese, anijet përpunuese të peshkut, anijet mbështetëse, anijet rimorkiuese, anijet që aktivizohen në proceset e transbordimit dhe anijet e transportit të pajisura për transportimin e prodhimeve të tonit dhe anijet ndihmëse, përjashtuar anijet kontejner.

b) "Anije peshkuese" është një anije e përdorur me synim zënien për arsye tregtie të resurseve të tonit.

c) "Anije përpunuese" është një anije, në bordin e së cilës, para se prodhimi të paketohet, mund të ndodhë një ose disa nga aktivitetet e mëposhtme: filetimi apo prerja në feta, ngrirja dhe/ose përpunimi.

d) "Anije ndihmëse" është çdo anije që përdoret për transportimin e individëve jo të gjallë të tonit (jo të përpunuar) nga koshat e transportit/rritjes, nga një koshilok apo kurth në një port të përcaktuar/ose në një anije përpunimi.

e) "Anije rimorkimi/tërheqëse" nënkupton çdo anije që përdoret për tërheqjen e koshave.

f) "Anije mbështetëse" nënkupton çdo anije tjetër të autorizuar për të operuar në peshkimin e tonit të kuq për të kryer detyra mbështetëse, e cila nuk bën pjesë në asnjë nga kategoritë e tjera të përmendura në paragrafin "a" më sipër. Anijet mbështetëse nuk mund të mbajnë në bord ose të transportojnë ton.

g) "Peshkimi në mënyrë aktive" do të thotë, për çdo anije peshkuese, që faktikisht synon të peshkojë tonin gjatë një sezoni të caktuar peshkimi.

h) "Operacion i përbashkët i peshkimit" (referuar në tekst si JFO) nënkupton çdo operacion midis dy ose më shumë anijeve me koshilok, ku zënia e një anijeje me koshilok i atribuohet një ose më shumë anijeve të tjera me koshilok, në përputhje me çelësin e shpërndarjes. JFO-ja mund të përfshijë ose jo të gjithë anijet me koshilok që përbëjnë JFO-në në pjesëmarrjen aktive në kapjen e tonit të të.

i) "Operacion transferimi" nënkupton:

- çdo transferim i individëve të gjallë të tonit nga rrjeta e anijes peshkuese në koshin transportues;
- çdo transferim i tonit të gjallë nga një kurth në koshin transportues pavarësisht nga prania e një anije tërheqëse;
- çdo transferim i individëve të gjallë të tonit nga një kosh transportues në një kosh tjetër transportues;
- çdo transferim i koshave me ton nga një anije tërheqëse në një tjetër anije tërheqëse;

- çdo transferim i tonit të gjallë midis koshave të ndryshëm në të njëjtën fermë (transferimi brenda fermës);

- çdo transferim i tonit të gjallë nga një kosh ferme në një kosh transporti.

j) "Transferim ndërmjet fermave" nënkupton zhvendosjen e tonit të gjallë nga një fermë në një fermë tjetër, e përbërë nga dy faza, një transferim nga koshi i fermës dhuruese në një kosh transporti dhe vendosjen në kosh nga koshi i transportit në koshin e fermës marrëse.

k) "Transferimi i parë" do të thotë transferimi i peshkut ton të gjallë nga një koshilok ose një kurth në një kosh transporti.

l) "Transferim i mëtejshëm" nënkupton çdo operacion transferimi që kryhet pas transferimit të parë dhe përpara mbylljes në kosh në fermën e destinacionit, si p.sh. ndarja ose bashkimi i përmbajtjes së dy koshave të transportit, por që nuk përfshin transferime vullnetare ose kontrolluese.

m) "Operator donator" do të thotë kapiteni i anijes së zënies ose të anijes tërheqëse ose përfaqësuesi i saj, ose përfaqësuesi i një ferme ose i një kurthi, nga e cila buron një operacion transferimi (përjashtuar transferimet e kontrolluara ose vullnetare).

n) "CPC-ja e operatorit dhurues" është Pala kontraktuese që ushtron juridiksionin e saj mbi operatorin dhurues.

o) "Transferim vullnetar" nënkupton përsëritjen e çdo transferimi që zbatohet vullnetarisht nga operatori donator, me qëllim plotësimin e kërkesave të aneksit 8.

p) "Transferim kontrolli" nënkupton përsëritjen e çdo transferimi që zbatohet me kërkesë të autoriteteve të kontrollit.

q) "Kosh kontrolli" është një përsëritje e operacionit të vendosjes në kosha që zbatohet me kërkesë të autoriteteve të kontrollit, me qëllim verifikimin e numrit dhe ose të peshës mesatare të peshqve që futen në kosh.

r) "Kurth" do të thotë pajisje fikse e ankoruar në fund, që zakonisht përmban një rrjetë udhëzuese që e çon tonin në një strehë ose një seri rrethimesh ku ruhet para zënies ose kultivimit.

s) "Vendosja në kosha" nënkupton zhvendosjen e tonit të gjallë nga koshi i transportit ose kurthi në koshat e kultivimit ose të majmërisë.

t) "Majmëri" ose "Kultivim" nënkupton futjen në kosh të tonit në ferma dhe ushqyerjen e mëpasshme me synim majmërinë dhe rritjen e biomasës totale të tyre.

u) "Fermë" nënkupton një zonë detare të përcaktuar qartë nga koordinatat gjeografike, e përdorur për majmërinë ose kultivimin e tonit të kapur nga anijet me koshilok dhe/ose kurthe. Një fermë mund të ketë disa vendndodhje koshash për kultivim, të gjitha të përcaktuara nga koordinatat gjeografike (me një përcaktim të qartë të gjatësisë dhe gjerësisë gjeografike për secilën nga pikat e poligonit).

v) "Vjelje" (harvest) nënkupton vrasjen e tonit në ferma ose në kurthe.

w) "Transportim" nënkupton shkarkimin e të gjithë ose ndonjë prej peshqve në bordin e një anije peshkimi në një anije tjetër peshkimi. Megjithatë, shkarkimi i tonit të ngordhur nga anija me koshilok, kurthi ose anija tërheqëse në një anije ndihmëse nuk do të konsiderohet si transportim.

x) "Peshkim sportiv" do të thotë peshkim jotregtar, anëtarët e të cilit aderojnë në një organizatë sportive kombëtare ose janë të pajisur me licencë sportive kombëtare.

y) "Peshkim rekreativ" do të thotë peshkim jokomercial, anëtarët e të cilit nuk aderojnë në një organizatë sportive kombëtare ose nuk janë të pajisur me licencë sportive kombëtare.

z) "Kamerë stereoskopike" nënkupton një aparat fotografik me dy ose më shumë lente, me një sensor të veçantë imazhi ose kornizë filmi për secilën lente, që mundëson marrjen e imazheve tredimensionale, për qëllimin e matjes së gjatësisë së peshkut dhe për të ndihmuar në përcaktimin e numrit dhe peshës së tonit.

aa) "kamerë kontrolli" nënkupton një kamerë stereoskopike dhe/ose videokamera konvencionale, për qëllimet e kontrolleve të parashikuara në këtë rekomandim.

bb) "BCD ose BCD elektronike (eBCD)" do të thotë një dokument i zënies së tonit.

cc) "Gjatësia e anijes" do të thotë gjatësia e përgjithshme e saj.

dd) "Anije peshkimit artizanal" është një anije me të paktën tri nga pesë karakteristikat e mëposhtme: a) gjatësia e përgjithshme <12 m; b) anija peshkon ekskluzivisht brenda ujërave territoriale të saj; c) udhëtimet e peshkimit kanë një kohëzgjatje prej më pak se 24 orë; d) numri maksimal i ekuipazhit është përcaktuar në katër persona; ose e) anija peshkon

duke përdorur teknika të cilat janë selektive dhe kanë një ndikim të reduktuar në mjedis.

ee) "CPC-ja e fermës" nënkupton shtetin kontraktues nën juridiksionin e së cilës ndodhet ferma e tonit.

ff) "CPC-ja flamur" nënkupton shtetin kontraktues flamurin e të cilit anija e peshkimit mban.

gg) "CPC-ja e kurthit" nënkupton shtetin kontraktues nën juridiksionin e të cilit ndodhet kurthi.

hh) "Input i kapacitetit të fermës" nënkupton sasinë maksimale të tonit që një fermë lejohet të vendosë në kosha gjatë një sezoni peshkimi.

PJESA II
MASAT MENAXHUESE

TAC (ZËNIET TOTALE TË LEJUARA) KUOTAT DHE KUSHTET E LIDHURA ME NDARJEN E KUOTAVE PËR CPCS

3. Çdo CPC duhet të marrë masat e nevojshme për të siguruar që sforzoja e peshkimit, nga anijet e peshkimit dhe kurthet e tij, janë në përputhje me mundësitë e peshkimit të tonit në dispozicion të këtij CPC-je në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe, duke përfshirë vendosjen e kuotave individuale për anijet e peshkimit me gjatësi mbi 24 m përfshirë në listën e përmendur në paragrafin 48, pika "a" të këtij rekomandimi.

4. Totali i zënieve të lejuara (TAC), duke përfshirë edhe peshqit e ngordhur hedhurinë, për vitet 2023–2025 do të vendoset në 40,570 t, në përputhje me MP. TAC-të për vitin 2026 dhe më pas do të vendosen në mbledhjen vjetore të Komisionit 2025 në përputhje me MP-në.

Sasia 40,570 t do të ndahet në vitet 2023–2025 në përputhje me skemën e mëposhtme:

CPC	Kuota për vitet 2023–2025 (t)
Shqipëria	264
Algjeria	2,023
Kina	112
Egjipt	512
Bashkim Evropian	21,503
Islanda*	224
Japoni	3,114
Kore	221
Libi	2,548
Marok	3,700
Namibia	50
Norvegji	368
Siri	129
Tunizi	3,000
Turqi	2,600
Mbretëria e Bashkuar	63
Kina Taipie	101
Total	40,533
Rezerva të paalokuara	37
TOTAL	**40,570**

Kjo tabelë nuk do të interpretohet që të ketë ndryshuar çelësat e shpërndarjes të paraqitura në rekomandimin 14-04. Hapat e tjerë do të bëhen në të ardhmen nga Komisioni.

Mauritania mund të peshkojë deri në 5t për kërkime çdo vit, në qoftë se ata respektojnë rregullat e raportimit të zënieve të përcaktuara në këtë rekomandim. Zëniet do të zbriten nga rezerva e pashpërndara.

Senegali mund të peshkojë deri në 5t për kërkime çdo vit, në qoftë se ata respektojnë rregullat e raportimit të zënieve të përcaktuara në këtë rekomandim. Zëniet do të zbriten nga rezerva e pashpërndara

Në varësi të disponueshmërisë, Kina Taipie mund të transferojë deri në 50t të kuotave të saj Koresë në vitet 2023–2025.

5. CPC-ja flamur mund t'i kërkojë një anijeje peshkimi të kthehet menjëherë në një port të përcaktuar prej tij, kur kuota individuale konsiderohet e peshkuar/e mbaruar.

6. Nuk lejohet mbartja e kuotave të papërdorura. Një CPC mund të kërkojë të transferojë një maksimum prej 5% të kuotës vjetore nga njeri vit në vitin pasardhës. CPC-ja do të përfshijë këtë kërkesë në planin e tij të kapacitetit të peshkimit që miratohet nga Komisioni.

7. Nuk lejohet asnjë operacion i dhënies së të drejtës *(chartering)* për peshkimin e tonit të kuq.

8. Pavarësisht nga dispozita e rekomandimit 01-12, të gjitha CPC-të e përmendura në mënyrë specifike në tabelën në paragrafin 4, mund të transferojnë një pjesë të kuotës së tyre në një CPC tjetër, me kusht që të dyja CPC-të bien dakord dhe t'i japin njoftim paraprak Sekretariatit të ICCAT-it, në lidhje me sasinë që do të transferohet. Sekretariati do t'ua shpërndajë këtë njoftim të gjitha CPC-ve.

9. Nëse zëniet e një CPC-je në ndonjë vit tejkalojnë sasitë e përcaktuara, CPC-të duhet të pakësojnë atë sasi në vitin pasardhës, në përputhje

me dispozitat në paragrafët 2 dhe 3 të rekomandimit ICCAT 96-14.

Dorëzimi i planeve vjetore të peshkimit, planet e inspektimit dhe të menaxhimit të kapaciteteve të peshkimit dhe të fermave, planet e menaxhimit të fermave të rritjes

10. Deri në 15 shkurt të çdo viti, çdo CPC që ka kuotë të tonit do të paraqesë në Sekretariatin e ICCAT-it:

a) Një plan vjetor të peshkimit për anijet e peshkimit dhe kurthe të peshkimit të tonit në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe të hartuar në përputhje me paragrafët 12–13.

b) Një plan vjetor i menaxhimit të kapacitetit të peshkimit që siguron që kapaciteti i peshkimit i autorizuar i CPC-së është në përpjesëtim me kuotën e alokuar, të hartuar duke përfshirë informacionin e paraqitur në paragrafët 14–19.

c) Një plan monitorimi, kontrolli dhe inspektimi, me qëllim që të sigurojë përputhjen me dispozitat e këtij rekomandimi. Ky plan do të caktojë, gjithashtu, autoritetin kompetent të kontrollit të CPC-së dhe listën e pikave të kontaktit të emëruara si përgjegjëse për zbatimin e këtij plani monitorimi, kontrolli dhe inspektimi.

d) Një plan vjetor të menaxhimit për fermat e rritjes, që është në përputhje me kërkesat e parashtruara në paragrafët 20–30, duke përfshirë inputin maksimal të autorizuara për fermë, kapacitetin maksimal për fermë dhe sasinë totale të peshkut për fermë të mbartur nga një vit më parë, në përputhje me paragrafin 200–206.

11. Para 31 marsit të çdo viti dhe në përputhje me paragrafin 234 të këtij rekomandimi, përveç rasteve kur Komisioni vendos ndryshe, Komisioni do të thërrasë një mbledhje ndërseksionale të panelit 2 për të analizuar dhe miratuar planet e përmendura në paragrafin 10. Ky detyrim mund të kryhet në rrugë elektronike, nëse Komisioni e vendos atë. Nëse Komisioni gjen një gabim serioz në planet e paraqitur dhe nuk mund të miratojë këto plane, Komisioni vendos për pezullimin automatik të peshkimit të tonit në atë vit nga ajo CPC. Mosdorëzimi i planit të përmendur më sipër automatikisht do të çojë në pezullimin e peshkimit të tonit në atë vit.

Planet vjetore të peshkimit

12. Plani vjetor i peshkimit do të identifikojë, ndër të tjera, kuotat e ndara për secilën grup të formave të peshkimit, kur është e aplikueshme, metodën e përdorur për të alokuar dhe menaxhuar kuotat, si dhe masat që sigurojnë respektimin për kuotat individuale, hapjen e sezonit të peshkimit për secilën formë peshkimi, si dhe rregullat e bashkëzënieve *(by catch)*.

13. Çdo modifikim i mëpasshëm i planit vjetor të peshkimit do t'i transmetohet Sekretariatit Ekzekutiv të ICCAT-it, së paku një ditë pune para ushtrimit të veprimtarisë që korrespondon me atë ndryshim. Pavarësisht nga kjo dispozitë, transferimet e kuotave ndërmjet formave të ndryshme të peshkimit dhe transferimet në mes të kuotave të zënieve dhe kuotave të bashkëzënieve *(by catch)* nga i njëjti CPC do të lejohen, me kusht që informacioni mbi transferimet të transmetohet te Sekretariati i ICCAT-it, përpara hyrjes në fuqi.

Masat e menaxhimit të kapacitetit të peshkimit

Kapaciteti i peshkimit

Rregullimi i kapacitetit të peshkimit

14. Çdo CPC do të përshtatë kapacitetin e tij të peshkimit për të siguruar se është në përpjesëtim me kuotën e ndarë për atë, duke përdorur normat përkatëse të zënies vjetore, sipas segmentit të flotës dhe formës së peshkimit të propozuara nga SCRS-ja dhe të miratuar nga Komisioni më 2009-n. Këta parametra duhet të rishikohen dhe çdo herë që një vlerësim i rezervës për tonin kryhet, do të përfshijë normat specifike të zënies për llojet e formave të peshkimit dhe zonat e peshkimit.

15. Plani vjetor i menaxhimit të kapacitetit të peshkimit siç përmendet në paragrafin 10(b) do të rregullojë numrin e anijeve të peshkimit për të demonstruar se kapaciteti i peshkimit është në përpjesëtim me mundësitë e peshkimit të ndara për anijet e peshkimit për të njëjtën periudhë të kuotës. Sa u përket anijeve të peshkimit të vogël bregdetar, kërkesa minimale e kuotës prej 5t (norma e zënies e përcaktuar nga SCRS në vitin 2009) nuk do të jenë më të zbatueshme dhe kuotat e këtij sektori mund të aplikohen në mënyrë alternative tek ato anije, si më poshtë:

a) Nëse një CPC ka anije të peshkimit të vogël bregdetar të autorizuar për peshkimin e tonit, ai do të alokojë një kuotë specifike për këto anije dhe do ta pasqyrojë këtë në planet e tij të peshkimit dhe të

inspektimit për zbatimin e cilave do të merren masa shtesë për të bërë të mundur monitorimin e drejtpërdrejtë të konsumimit (zënies) të kuotës nga ky segment i flotës.

b) Për anijet nga arkipelagët e Azorës, Ishujt Kanarie dhe Madeira, mund të krijohet një kuotë sektoriale për anijet me karrem. Kuota për këtë segment dhe kushtet shtesë për të monitoruar atë duhet të përcaktohen qartë në planin e peshkimit, dorëzuar në bazë të paragrafit 10 më lart.

16. Rregullimi i kapacitetit të peshkimit për anijet me rrethim me koshilok do të kufizohet në një ndryshim maksimal prej 20% në krahasim me kapacitetin bazë të peshkimit të vitit 2018. CPC-të mund të rrumbullakosin numrin e anijeve të peshkimit kur llogaritet kjo përqindje.

17. CPC-të mund të autorizojnë një numër të kurtheve të tyre të angazhuara në peshkimin e tonit në Atlantikun lindor dhe në Detin Mesdhe, i cili lejon shfrytëzimin e plotë të mundësive të peshkimit.

18. Kërkesat për rregullime dhe për numrin e kurtheve të përcaktuara në paragrafët 15, 16 dhe 17 nuk do të zbatohen:

a) nëse CPC- të e vendeve në zhvillim mund të tregojnë se ata kanë nevojë të zhvillojnë kapacitetin e tyre të peshkimit në mënyrë që të përdorin tërësisht kuotën e tyre, duke përdorur normat përkatëse të zënies vjetore, sipas segmentit të flotës dhe formës së peshkimit të propozuar nga SCRS-ja dhe nëse rregullimet e tilla përfshihen në planin vjetor të peshkimit në përputhje me paragrafin 10,

b) në Atlantikun Verilindor, ndaj atyre CPC-ve që peshkojnë kryesisht në zonat e tyre ekonomike (Zonën Ekonomike Norvegjeze dhe Zonën Ekonomike Islandeze).

19. Çdo llogaritje për të vendosur rregullime të kapacitetit të peshkimit do të bëhet në përputhje me metodologjinë e miratuar në takimin vjetor të 2009 dhe me kushtet e përcaktuara në paragrafët 15 dhe 17, me përjashtim të rasteve kur CPC-të në fjalë peshkojnë kryesisht në Zonat Ekonomike Ekskluzive të Norvegjisë ose Islandës.

Kapaciteti i kultivimit

20. Çdo CPC që kultivon do të krijojë një plan vjetor të menaxhimit të kultivimit. Ky plan duhet të tregojë se kapaciteti i përgjithshëm i inputeve dhe kapaciteti i përgjithshëm kultivues është në përpjesëtim me shumën e vlerësuar të tonit të disponueshëm për kultivim, duke përfshirë informacionin e përmendur në paragrafët 21 dhe 23. Planet e rishikuara të menaxhimit të kultivimit, nëse është e nevojshme, duhet t'i dërgohen sekretariatit në 1 qershor të çdo viti. Komisioni do të sigurojë që kapaciteti total kultivues në Atlantikun Lindor dhe në Detin Mesdhe është në përpjesëtim me sasinë totale të tonit të disponueshëm për kultivim në zonë.

21. Çdo CPC do të kufizojë kapacitetin e saj të kultivimit të tonit në kapacitetin total kultivues të fermave, të cilat janë regjistruar në listën ICCAT ose janë autorizuar dhe deklaruar në ICCAT në vitin 2018.

22. Ato CPC të vendeve në zhvillim pa ferma kultivimi ose me më pak se tri ferma dhe që synojnë të krijojnë ferma të reja të kultivimit të tonit, kanë të drejtë të krijojnë ferma të tilla me një kapacitet maksimal kultivues deri në 1800 tonë për CPC. Për këtë qëllim, ata do t'i komunikojnë ICCAT-it, duke i përfshirë ato në planin e tyre të kultivimit, sipas paragrafit 10 të këtij Rekomandimi. Kjo pikë duhet të rishikohet më 2022-shin.

23. Çdo CPC duhet të krijojë një maksimum hyrjesh vjetore për tonin e kuq të egër të kapur dhe futur në fermat e tij në nivel të të dhënave të regjistruara në ICCAT nga ferma e tij më 2005-n, 2006-n, 2007-n apo 2008-n. Nëse një CPC ka nevojë të rrisë kultivimin për tonin e peshkuar, kjo rritje duhet të jetë në përpjesëtim me kuotën e peshkimit të alokuar për atë CPC, duke përfshirë edhe importet e tonit.

24. Sekretariati i ICCAT-it do të përpilojë statistika mbi sasinë vjetore të tonit në kosha (inputin e peshkut të egër të kapur), vjeljen dhe eksportin, sipas fermës së CPC-së, duke përdorur të dhënat në sistemin eBCD. eBCD-TWG do të marrë në konsideratë zhvillimin e një funksionaliteti të tillë të nxjerrjes së të dhënave dhe derisa një funksion i tillë të bëhet i disponueshëm, çdo CPC me ferma duhet t'i raportojë këto statistika sekretariatit të ICCAT-it. Këto statistika do të vihen në dispozicion në faqen e internetit të ICCAT-it, duke iu nënshtruar kërkesave të konfidencialitetit.

Normat e rritjes

25. Mbështetur informacioneve të reja shkencore në dispozicion, përfshirë këtu rezultatet e provave mbi përdorimin e inteligjencës artificiale të përcaktuara në paragrafin 166, SCRS-ja duhet të gjykojë rishikimin dhe përditësimin e tabelës të publikuar më 2022-shin mbi normat e rritjes, sa më shpejt të jetë e mundur dhe te rezultatet të

prezantohen jo më vonë se mbledhja vjetore e Komisionit më 2024-n.

26. CPC e fermave duhet të sigurojnë që normat e rritjes të derivuara nga eBCD të jenë koherente me normat e rritjes të publikuara nga SCRS-ja më 2022-shin. Nëse vërehen mospërputhje të mëdha midis tabelave të SCRS 2022 dhe normave të rritjes të vëzhguara, ky informacion duhet të dërgohet në SCRS për analizë. CPC-ja importuese dhe CPC-ja e fermave duhet të inkurajohen për të bashkëpunuar në monitorimin e normave të rritjes në një mënyrë gjithëpërfshirëse përmes shkëmbimit të të dhënave përkatëse, pa paragjykuar rregullat e aplikueshme për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe t'i raportojë rezultatet e monitorimit panelit 2, sipas rastit.

27. Të konsiderohet nga eBCD TWG në 2023 një opsion brenda sistemit eBCD për të monitoruar në mënyrë automatike normat e rritjes.

PJESA III
MASAT TEKNIKE

Hapja e sezonet të peshkimit

28. Peshkimi me rrethim i tonit do të lejohet në Atlantikun Lindor dhe në Detin Mesdhe gjatë periudhës nga 26 maj deri më 1 korrik.

Përjashtimisht, në Mesdheun Lindor (zonat e peshkimit të FAO-s 37.3.1 Egjeu; 37.3.2 Levant), sezoni hapet nga 15 maji, nëse CPC-të e kërkojnë nën planin e tij të peshkimit.

Përjashtimisht, në Detin Adriatik (zona e peshkimit FAO 37.2.1) sezoni mund të hapet nga 26 maj deri më 15 korrik, për peshqit e kultivuar në Detin Adriatik.

Përjashtimisht, sezoni i peshkimit me rrethim në zonën Ekonomike Norvegjeze dhe në zonën Ekonomike Islandeze do të jetë nga 15 qershori në 15 nëntor.

Përjashtimisht, sezoni i peshkimit me rrethim në Atlantikun lindor dhe zonat e peshkimit të Detit Mesdhe, të kufizuara me ujërat nën sovranitetin ose juridiksionin e Mbretërisë së Marokut mund të jenë të hapura nga 1 maji deri më 15 qershor nëse një CPC e kërkon atë në planin e tij të peshkimit.

29. Nëse kushtet e këqija të motit pengojnë operacionet e peshkimit, CPC-të mund të vendosin që sezonet e peshkimit të referuara në paragrafin 28 të shtyhen me një numër të barabartë të ditëve të peshkimit të humbura, por jo më shumë se 10 ditë.

30. Anijet, me linjë grepash pellagjikë, më të mëdha se 24 metra, do të lejohen të peshkojnë tonin e kuq në Atlantikun Lindor dhe në Mesdhe nga 1 janari deri më 31 maj, me përjashtim të zonës së kufizuar në perëndim prej 10°W dhe në veri të 42°N, si dhe në zonën ekonomike norvegjeze, ku ky lloj peshkimi (me linjë grepash pellagjike) do të lejohet gjatë periudhës 1 gusht deri më 31 janar.

31. CPC-të do të vendosin hapjen e sezonit të peshkimit për flotën e tyre, përveç peshkimit me rrethim dhe anijeve të referuara në paragrafin 30 dhe do ta përfshijnë këtë informacion në planin e tyre të peshkimit të përcaktuar në paragrafin 12 për t'u analizuar dhe për t'u miratuar nga paneli 2 ndërsezonal.

32. Jo më vonë se viti 2020, Komisioni do të vendosë se në çfarë mase sezonet e peshkimit për forma të ndryshme të peshkimit dhe/ose zonave të peshkimit mund të zgjerohen dhe/ose modifikohen në bazë të këshillave të SCRS-së pa ndikuar negativisht në zhvillimin e rezervës peshkore dhe duke siguruar që rezerva të menaxhohet në mënyrë të qëndrueshme.

Madhësia minimale

33. Madhësia minimale për tonin e zënë në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe do të jetë 30 kg ose me gjatësi 115 cm deri në degëzimin e bishtit. Prandaj, CPC-të do të marrin masat e nevojshme për ndalimin e peshkimit, mbajtjen në bord, transbordimin, transferimin, zbarkimin, transportimin, magazinimin, shitjen, reklamimin apo ofrimin për shitje të tonit që peshkon më pak se 30 kg ose me gjatësi më të vogël se 115 cm në bifurkacion.

34. Përjashtimisht nga paragrafit 33, për peshqit me peshë deri në 8 kg ose me gjatësi deri 75 cm aplikohen situatat e mëposhtme (**shiko shtojcën 1**):

a) toni i kapur në Atlantikun Lindor nga barkat me grepa lundrues dhe anijet tërheqëse;

b) toni i kapur në Detin Mesdhe nga peshkimi artizanal bregdetar për peshk të freskët me linja grepash, grepa lundruese dhe grepa dore.

c) toni i kapur në Detin Adriatik për qëllime kultivimi.

Pavarësisht nga sa më sipër, për tonin e zënë në Detin Adriatik nga anijet me flamur kroat për qëllim kultivimi, CPC përkatëse mund të përcaktojnë një nivel tolerance për individë toni me një peshë minimale 6.4 kg ose 66 cm gjatësi, por jo më shumë se 7% të sasisë se zënë nga anijet kroate. Për më tepër, për tonin e zënë nga anijet franceze me grepa

me gjatësi më të vogël se 17 m që veprojnë në Gjirin e Biscay, CPC mund të japë toleranca për të zënë deri në një maksimum 100 tonë me një peshë minimale prej 6.4 kg ose, në alternative, të ketë një gjatësi minimale në bifurkacion prej 70 cm.

35. CPC-të në fjalë do të lëshojnë autorizime specifike për anijet që peshkojnë sipas përjashtimeve të përmendura në paragrafin 34. Përveç kësaj, peshqit poshtë këtyre madhësive minimale, hedhurinë e të ngordhur, do të llogariten brenda kuotës së CPC-së.

Zëniet aksidentale të peshqve me përmasa nën minimumin e lejuar

36. Për anijet dhe kurthet që peshkojnë në mënyrë aktive tonin e kuq, mund të autorizohen zënie aksidentale maksimumi deri 5% të individëve të tonit që peshojnë nga 8 deri 30 kg ose me gjatësi në bifurkacion nga 75 deri në 115 cm gjatësi.

Kjo përqindje llogaritet mbi zëniet totale aksidentale si numër individësh të tonit që ndodhen në bord të anijes, pas çdo operacioni peshkimi, në peshën dhe gjatësinë e përmendur më sipër.

Rregullat e përgjithshme mbi bashkëzëniet *(by-catches)*

37. Të gjitha CPC-të do të ndajnë një kuotë specifike për bashkëzëniet *(by-catch)* për tonin. Nivelet e bashkëzënieve të autorizuara, si dhe metodologjia e llogaritjes së këtyre bashkëzënieve në raport me zënien totale (në peshë ose në numër të individëve) do të përcaktohen qartë në planet vjetore të peshkimit, të dorëzuara në sekretariatin e ICCAT-it, sipas paragrafit 10 të këtij Rekomandimi dhe nuk duhet të kalojë 20% të totalit të sasisë në fund të çdo dalje për peshkimi. Llogaritja e numrit do të zbatohen vetëm për tonin dhe specie e ngjashme me tonin që menaxhohen nga ICCAT-ja. Për anijet e peshkimit të vogël bregdetar sasia e bashkëzënieve duhet të llogaritet në bazë vjetore.

Të gjitha sasitë e bashkëzënieve të tonit të ngordhur, të mbajtur në bord ose të hedhura si hedhurinë, do të zbriten nga kuota e CPC-së dhe duhet të raportohen në ICCAT. Nëse bashkëzënia e tonit është bërë në ujërat nën juridiksionin e peshkimit të CPC-ve, dhe në rast se legjislacioni vendës i këtyre CPC-ve kërkon që të gjithë peshqit e ngordhur duhet të zbarkohen, ky detyrim për zbarkim duhet të përmbushet edhe nga anijet që lundrojnë me flamuj të huaj.

Nëse nuk ka kuota të alokuara nga CPC-ja për anijet dhe kurthet e peshkimit, apo nëse është konsumuar kuota, nuk lejohet peshkimi i tonit si bashkëzënie dhe CPC duhet të marrin masat e duhura për të garantuar lëshimin e gjallë të tyre. Megjithatë, nëse toni i kuq është i ngordhur, duhet të zbarkohet dhe duhen ndjekur veprimet, në përputhje me ligjin kombëtar. CPC-të do të informojnë mbi këto sasi në baza vjetore te Sekretariati i ICCAT-it, i cili do ta vërë atë në dispozicion të SCRS-së.

Procedurat e referuara në paragrafët 89 deri 94 dhe 228 do të zbatohen për bashkëzëniet.

Anijet që nuk peshkojnë në mënyrë aktive për tonin e kuq, çdo sasi të tij që mbajnë në bord duhet ta ndajnë qartësisht nga speciet e tjera për të lejuar kështu që autoritet kontrolluese të monitorojnë respektimin e kësaj rregulle. Procedurat për anijet e paautorizuara në lidhje me eBCD-në do të veprojnë siç përcaktohet në dispozitën përkatëse të rekomandimit ICCAT që ndryshon rek. 21-18 mbi aplikimin e sistemit eBCD (rec. 22–16).

Peshkimi çlodhës/argëtues dhe peshkimi sportiv

38. Kur CPC-të ndajnë, ku është e përshtatshme, një kuotë specifike për peshkimin sportiv dhe argëtues; kjo kuotë e caktuar duhet të vendoset në peshkimin sportiv dhe argëtues edhe nëse zënia dhe lëshimi i tonit është i detyrueshëm, për të llogaritur peshën e mundshme të peshqve të ngordhur. Çdo CPC duhet të rregullojë peshkimin çlodhës/ argëtues, duke lëshuar autorizime të peshkimit për këtë qëllim.

39. CPC-të duhet të marrin masat e duhura për të ndaluar zënien dhe mbajtjen në bord, transbordimin ose zbarkimet e më shumë se një individi toni për çdo anije të peshkimit argëtues në ditë.

Ky ndalim nuk aplikohet tek ato CPC, legjislacioni i të cilëve kërkon që të zbarkohet i gjithë peshku i ngordhur, duke përfshirë edhe individët e zënë nga peshkimi sportiv dhe argëtues.

40. Tregtimi i tonit të zënë në peshkimin sportiv dhe argëtues është i ndaluar.

41. Çdo CPC duhet të marrë masa për të regjistruar të dhënat e zënieve, duke përfshirë peshën e çdo toni të kapur gjatë peshkimit sportiv dhe argëtues dhe t'i komunikojë ato në sekretariatin e ICCAT për vitin paraprak deri më 1 korrik të çdo viti.

42. Sasitë e tonit të ngordhur, të zëna nga peshkimin sportiv dhe argëtues do të llogariten

kundrejt kuotës së alokuar për CPC në përputhje me paragrafin 4.

43. Çdo CPC do të marrë masat e nevojshme për të siguruar, në masën më të madhe të mundshme, lëshimin e tonit, sidomos të të vegjëlve, të kapur gjallë, në kuadrin e peshkimit argëtues dhe sportiv. Çdo ton i zbarkuar duhet të jetë i plotë, i pastruar dhe/ose i prerë.

44. Çdo CPC që dëshiron të kryejë një peshkim "kap dhe lësho" në Atlantikun Verilindor mund të lejojë një numër të kufizuar të anijeve sportive të synojnë tonin, me qëllim të "marko/shënjo dhe liro" pa pasur nevojë të alokojë për to një kuotë specifike. Kjo vlen për ato anije që veprojnë në kuadër të një projekti shkencor të një instituti kërkimi, të integruar në një program kërkimor shkencor, rezultatet e të cilit do t'i komunikohen SCRS. Në këtë kontekst, CPC-ja ka detyrimin: a) paraqesin përshkrimin dhe masat shoqëruese që zbatohen në këtë formë peshkimi si pjesë integrale e planeve të tyre të peshkimit dhe kontrollit, siç referohet në paragrafin 12 të këtij rekomandimi: b) të monitorojë nga afër aktivitetet e anijeve në fjalë për të siguruar përputhshmërinë e tyre me dispozitat ekzistuese të këtij rekomandimi; c) të sigurojë që veprimtaria e markimit dhe lëshimit të tonit, të kryhen nga personel i trajnuar për të siguruar mbijetesën e lartë të peshqve; dhe d) çdo vit të paraqesë një raport mbi aktivitetet shkencore të kryera, të paktën 60 ditë para mbledhjes SCRS të vitit vijues. Çdo ton i kuq që ngordh gjatë aktivitetit të markimit dhe lëshimit do të raportohet dhe të zbritet nga kuota CPC-së.

45. CPC-ja do të vënë në dispozicion, sipas kërkesës nga ICCAT-ja, listën e anijeve të peshkimit sportiv dhe argëtues të cilat kanë marrë një autorizim.

46. Formati për një listë të tillë, referuar paragrafin 45 duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

a) emrin e anijes, numrin e regjistrit;

b) numri e ICCAT (nëse ka);

c) emrin e mëparshëm (nëse ka);

d) emrin dhe adresën e pronarit/ve dhe operatorit/ve).

Përdorimi i mjeteve ajrore

47. Përdorimi i çdo mjeti ajror, duke përfshirë aeroplanë, helikopterë ose çdo lloji të mjeteve ajrore pa ekuipazh për të kërkuar tonin e kuq, është i ndaluar.

PJESA IV
MASAT E KONTROLLIT

SEKSIONI A
REGJISTRI I ANIJEVE, KURTHEVE DHE FERMAVE

Regjistri i ICCAT-it për anijet e peshkimit

48. CPC-ja do të krijojnë dhe do të mbajnë një regjistër ICCAT për të gjitha anijet e peshkimit sipas përcaktimit të paragrafit 2(a). Ky regjistër duhet të përmbajë listat e mëposhtme:

a) anijet e zënies që peshkojnë aktivisht për ton, sipas paragrafit 2(g) të këtij Rekomandimi; dhe

b) anije të tjera të përfshira në aktivitete të lidhura me tonin e kuq, përveç anijeve të kapjes.

49. Çdo listë duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

a) emrin dhe numrin e regjistrit të mjetit lundrues;

b) specifikimin e llojit të mjetit lundrues që diferencon të paktën ndërmjet: anijeve peshkimi, anijeve tërheqëse, anijeve ndihmëse, anijeve mbështetëse, anijeve përpunuese;

c) gjatësia dhe tonazhi bruto i regjistruar (GRT) ose, kur është e mundur, tonazhi bruto (GT);

d) numrin e IMO-së (nëse ka);

e) mjetet e peshkimit të përdorura (nëse ka);

f) flamurin e mëparshëm (nëse ka);

g) emri i mëparshëm (nëse ka);

h) detajet e mëparshme të fshirjes nga regjistrat e tjerë (nëse ka);

i) shenjën e thirrjes ndërkombëtare të radios (nëse ka);

j) emrin dhe adresën e pronarit/ve dhe operatorit/ ve; dhe

k) periudha kohore e autorizuar për peshkimin, operimin dhe/ose transportin e tonit për kultivim.

50. Për anijet me një gjatësi > 24 m (pavarësisht rrjetës së përdorur, duke përjashtuar tratat fundore) dhe për anijet me rrethim me koshilok, CPC-ja duhet të raportojnë numrin e tyre në Sekretariatin Ekzekutiv, si pjesë e planit të tyre të peshkimit të përcaktuara në paragrafin 10 të këtij rekomandimi.

51. Sekretariati Ekzekutiv i ICCAT-it do të krijojë dhe mirëmbajë regjistrin e ICCAT-it për të gjitha anijet e peshkimit që peshkojnë në mënyrë aktive për ton dhe të gjitha anijet e tjera të autorizuara për të operuar për tonin në Atlantikun Lindor dhe në Mesdhe dhe të marrë çdo masë për

të siguruar vlefshmërinë e të dhënave përmes mjeteve elektronike, duke përfshirë vendosjen e tij në faqen e internetit të ICCAT-it, në përputhje me konfidencialitetin e kërkuar nga CPC-të.

52. Çdo CPC flamur do t'i dorëzojë në mënyrë elektronike çdo vit Sekretariatit të ICCAT-it: i. jo më vonë se 15 ditë përpara fillimit të aktivitetit të peshkimit, listën e anijeve të peshkimit të përmendura në paragrafin 48(a); dhe ii. jo më vonë se 15 ditë përpara fillimit të veprimtarisë së tyre, listën e anijeve të tjera të peshkimit të përmendura në paragrafin 48(b). Dorëzimi do të kryhet në përputhje me formatin e përcaktuar në "Udhëzimet për dorëzimin e të dhënave dhe informacionit të kërkuar" nga ICCAT-i.

53. Nuk do të pranohen ndryshime të tjera, përveçse kur një anije peshkimi e përfshirë në listë, nuk mund të marrë pjesë për shkak të arsyeve operacionale të legjitimuara ose *shkaqeve madhore*. Në këto rrethana, CPC-ja në fjalë duhet të informojë menjëherë Sekretariatin Ekzekutiv të ICCAT-it, duke dhënë:

a) Detajet e plota të anijeve të peshkimit që synojnë të zëvendësojnë një apo me shumë anije, të përfshira në regjistrat e përmendur në paragrafin 48; CPC-të me më pak se 5 anije në listën e përmendur në paragrafin 48, mund të zëvendësojnë një anije me një anije tjetër që nuk është përfshirë më parë në regjistër, me kusht që CPC-ja në fjalë t'i paraqesë Sekretariatit të ICCAT-it një kërkesë për një numër ICCAT që t'i jepet anijes, dhe numri i kërkuar është dhënë;

b) Një përshkrim i kuptueshëm i arsyeve që justifikojnë zëvendësimin dhe çdo fakt apo referencë që mbështet atë.

Sekretariati i ICCAT-it do t'i shpërndajë këto raste midis CPC-ve. Nëse ndonjë CPC njofton se rasti nuk është analizuar mjaftueshëm ose është jo i plotë, ai do të dërgohet në Komitetin e Përputhshmërisë për shqyrtim të mëtejshëm dhe do të mbetet në pritje të miratimit të Komitetit të Përputhshmërisë.

54. Pa paragjykuar paragrafin 37 për qëllimet e këtij Rekomandimi, anijet e peshkimit që nuk hyjnë në një nga regjistrat e ICCAT-it të parashikuar në paragrafin 48, në pikat "a" dhe "b", sugjerohet të mos autorizohen për të peshkuar, mbajtur në bord, transborduar, transferuar, përpunuar apo zbarkuar tonin në Atlantikun Lindor dhe në Detin Mesdhe. Ndalimi për mbajtjen në bord nuk aplikohet për CPC, të cilave legjislacioni i brendshëm u kërkon zbarkimin e të gjithë peshqve të ngordhur, duke siguruar që vlera e tyre është subjekt konfiskimi.

55. Kushtet dhe procedurat e referuara në Rekomandimin ICCAT që ndryshon Rekomandimin 13–13, në lidhje me krijimin e një regjistri të ICCAT-it të anijeve me gjatësi të përgjithshme ose më të madhe se 20 metra të autorizuara për të vepruar në zonën e Konventës (rec. 21-14) (përveç paragrafit 3) do të zbatohen pjesë – pjesë (*mutatis mutandis*).

Autorizimet e peshkimit për anijet dhe kurthet e autorizuara për peshkimin e tonit

56. CPC-ja lëshon autorizime të veçanta dhe/ose licencë kombëtare peshkimi për anijet dhe kurthet të përfshira në një prej listave të përshkruara në paragrafët 45, 48 dhe 58. Autorizimet për peshkim do të përmbajnë si informacion minimal atë të paraqitur në **shtojcën 13.** CPC-ja duhet të sigurojnë se informacioni që përmban autorizimi për peshkim të jenë të saktë dhe në përputhje me rregullat e ICCAT-it. CPC-ja do të marrë masat e nevojshme të forcimit të zbatimit të legjislacionit të tyre dhe mund të kërkojë që anija të kthehet menjëherë në një port të caktuar kur kuota individuale është peshkuar.

Regjistri i ICCAT-it për kurthet e autorizuara për të peshkuar tonin e kuq

57. Komisioni krijon dhe mban një regjistër të ICCAT për të gjitha kurthet e tonit të autorizuara për peshkimin e tonit në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe. Me qëllim zbatimin e këtij rekomandimi, kurthet e tonit që nuk janë regjistruar, sugjerohet të mos autorizohen për të peshkuar apo për të mbajtur ton dhe të mos marrin pjesë në aktivitetin e peshkimit, transferimit, zënies apo zbarkimit të tonin.

58. Çdo CPC do të dërgojë në format elektronik në Sekretariatin Ekzekutiv të ICCAT-it, si pjesë e planit të tij të peshkimit, të përcaktuara në paragrafët 12 deri 13, listën (duke përfshirë emrin e kurthit, numrin e regjistrit dhe koordinatat gjeografike të poligonit të kurthit) e kurtheve të autorizuara të tonit sipas paragrafit 56.

59. Çdo CPC do të njoftojë Sekretariatin e ICCAT-it, pas krijimit të regjistrit të kurtheve të ICCAT-it, për çdo shtesë, çdo fshirje nga dhe/ose çdo modifikim të regjistrimit të kurtheve të ICCAT-it në çdo kohë që ndodhin ndryshime të tilla.

60. Sekretariati i ICCAT-it do të marrë çdo masë për të siguruar vlefshmërinë e të dhënave përmes mjeteve elektronike, duke përfshirë vendosjen e tij

në faqen e internetit të ICCAT-it në përputhje me konfidencialitetin e kërkuar nga CPC-të.

Regjistri i ICCAT-it i fermave të autorizuara për të kultivuar tonin

61. Sekretariati i ICCAT-it do të mbajë një regjistër të ICCAT-it për të gjitha fermat e tonit të autorizuara për të kultivuar tonin në Atlantikun Lindor dhe Mesdhe. Për qëllimet e këtij Rekomandimi, fermat e tonit që nuk janë regjistruar në regjistër konsiderohen se nuk janë të autorizuara për të kultivuar tonin.

62. Çdo CPC me ferma do t'i dorëzojë në mënyrë elektronike Sekretariatit të ICCAT-it, si pjesë e planit të tyre të kultivimit të përcaktuar në paragrafin 10(d), listën e fermave të saj të autorizuara për ton, duke përfshirë:

i. emrin e fermës;

ii. numrin e regjistrit;

iii. emrat dhe adresat e pronarit/ve dhe operatorit/ve;

iv. inputet dhe kapaciteti total kultivues i alokuar për çdo fermë;

v. koordinatat gjeografike të zonave të autorizuara për veprimtari kultivuese; dhe

vi. statusi i fermës (aktive ose joaktive).

63. Asnjë aktivitet kultivues, duke përfshirë ushqimin për qëllime majmërie ose vjeljen e tonit të kuq, nuk do të autorizohet jashtë koordinatave gjeografike të miratuara për aktivitetet kultivues.

64. Çdo CPC do të njoftojë Sekretariatin e ICCAT-it për çdo shtesë, çdo fshirje nga dhe/ose çdo modifikim të regjistrit ICCAT të fermave në çdo kohë që ndodhin ndryshime të tilla.

65. Sekretariati ICCAT do të marrë çdo masë për të siguruar vlefshmërinë e të dhënave përmes mjeteve elektronike, duke përfshirë vendosjen e tij në faqen e internetit të ICCAT-it, në përputhje me konfidencialitetin e kërkuar nga CPC-të.

66. Çdo CPC do të marrë masat e nevojshme për të siguruar që asnjë ton nuk vendoset në një fermë të paautorizuar nga CPC-ja ose e listuar në regjistrin e ICCAT-it dhe që fermat të mos marrin ton nga anije që nuk janë përfshirë në regjistrin e anijeve të ICCAT-it të përmendura në paragrafin 48. Çdo CPC do të marrë masat e nevojshme, sipas legjislacionit të tyre në fuqi, për të ndaluar çdo veprim në fermat që nuk janë regjistruar në regjistrin e fermave të ICCAT-it.

Informacion mbi aktivitetin e peshkimit

67. Me 31 korrik të çdo viti, ose brenda 7 muajve të përfundimit të sezonit të peshkimit për ato CPC që përfundojnë fushatën e tyre të peshkimit në korrik, çdo CPC dërgon një informacion të detajuar mbi zëniet e tonit në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe, e cila paraprin periudhën e alokimit të kuotave. Ky informacion duhet të përfshijë:

a) emrin dhe numrin ICCAT të secilës anije peshkimi;

b) periudhën e autorizimit për çdo anije peshkimi;

c) kapjet totale të secilës anije peshkuese, duke përfshirë kthimet zero (pa zënie) gjatë gjithë periudhës së autorizimit;

d) numri i përgjithshëm i ditëve të çdo anije peshkimi që ka peshkuar në Atlantikun Lindor dhe Mesdhe gjatë gjithë periudhës së autorizimit; dhe

e) kapjet totale jashtë periudhës së autorizimit të tyre (bashkëzënie).

68. Për të gjitha anijet të cilat nuk janë të autorizuara për të peshkuar në mënyrë aktive për ton në Atlantikut Lindor dhe Detin Mesdhe, por që kanë zënë ton si bashkëzënie:

a) emri dhe numri ICCAT apo numrin kombëtar të regjistrit të anijes, nëse nuk është e regjistruar me ICCAT;

b) zëniet totale të tonit.

69. Çdo CPC njofton Sekretariatin e ICCAT-it për çdo informacion që ka lidhje me anijet peshkuese që nuk përfshihen në paragrafët 67 e 68, por të njohura apo të supozuara që kanë peshkuar për tonin në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe. Sekretariati i ICCAT-it e përcjell pa vonësë këtë informacion te CPC-ja, për veprim sipas rastit, si dhe një kopje për informacion CPC-ve të tjera.

Operacionet e përbashkëta të peshkimit

70. Çdo operacion i përbashkët i peshkimit për tonin e kuq autorizohet vetëm me pëlqimin e CPC-ve në fjalë. Do të autorizohet, çdo anije për peshkim me rrethim, e pajisur për të peshkuar tonin e kuq, që ka një kuotë individuale të shpërndarë, dhe për të vepruar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në 71 dhe 73. Kuota e alokuara për një operacion të përbashkët peshkimi (JFO), do të jetë e barabartë me totalin e të gjitha kuotave të ndara për çdo anije me rrethim që marrin pjesë në këtë JFO. Për më tepër, kohëzgjatja e JFO-së nuk do të jetë më e gjatë se kohëzgjatja e sezonit të peshkimit për anijet me

rrethim, siç referohet në paragrafin 28 të këtij Rekomandimi.

71. Në momentin e aplikimit për autorizim, duke ndjekur formatin e aneksit 5, çdo CPC duhet marrë masat e nevojshme për të marrë nga anijet e tij me rrethim që marrin pjesë në një operacionin të përbashkët peshkimi, informacionin e mëposhtëm:

- periudha e autorizimit të JFO-së;
- identitetin e operatorëve të përfshirë;
- kuotat individuale të anijeve;
- çelësin ndarës të kuotave ndërmjet anijeve të përfshira në zënie; dhe
- informacion mbi fermat e destinuara ku shkon peshku.

Çdo CPC transmeton gjithë informacionin e përmendur më lart në Sekretariatin e ICCAT-it të paktën pesë ditë para fillimit të sezonit të peshkimit me rrethim, siç përcaktohet në paragrafin 28.

Në rastet e ndonjë force madhore, afati i përcaktuar në këtë paragraf nuk zbatohen në lidhje me informacionin mbi fermat ku shkon peshku. Në raste të tilla, CPC-të i sigurojnë Sekretariatit të ICCAT-it një përditësim të këtij informacioni sa më shpejt që të jetë e mundur, së bashku me një përshkrim të ngjarjeve që përbëjnë forcë madhore. Sekretariati përpilon informacionin e përmendur në këtë paragraf, të siguruar nga CPC-ja, për shqyrtim nga Komiteti Përputhshmërisë.

72. Komisioni krijon dhe mban një regjistër të ICCAT-it për të gjitha operacionet e përbashkëta të peshkimit të autorizuara nga CPC-të në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe.

73. Nuk do të lejohen JFO mes anijeve të peshkimit me rrethim të CPC-së të ndryshme. Megjithatë, një CPC me më pak se pesë anije të autorizuara të peshkimit me rrethim mund të autorizojë operacionet e përbashkëta të peshkimit me çdo CPC tjetër. Çdo CPC që kryen një JFO do të jetë përgjegjës dhe i përgjegjshëm për të zëniet e bëra sipas këtij JFO.

PJESA IV
MASAT E KONTROLLIT

SEKSIONI B
ZËNIET DHE TRANSFERIMET

Kërkesat e regjistrimit

74. Kapitenet e anijeve të peshkimit duhet të mbajnë një libër zënie në forme ditari *(logbook)* ose logbook elektronik për operacionet e tyre të peshkimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në seksionin A të shtojcës 2.

75. Kapitenët e anijeve tërheqëse, ndihmëse dhe përpunuese do të regjistrojnë aktivitetet e tyre në përputhje me kërkesat e përcaktuara në seksionet B, C dhe D të shtojcës 2.

Raportet e zënieve të dërguara nga kapitenet e anijeve dhe operatorët e kurtheve

76. Çdo CPC do të sigurojë që anijet e tij, që peshkojnë në mënyre aktive për ton, gjatë gjithë periudhës për të cilën ato janë autorizuar të peshkojnë tonin, do të komunikojnë në formë elektronike ose çdo mënyrë tjetër efektive informacione ditore nga *logbook*-et, duke përfshirë datën, kohën, vendin (gjerësi dhe gjatësi gjeografike) peshën dhe numrin e tonit të zënë në zonën e mbuluar nga ky plan, përfshirë edhe lëshimet dhe hedhurinat e peshkut të ngordhur nën minimumin e madhësisë së lejuar, referuar në paragrafin 33. Kapitenët do të dërgojnë këtë informacion me formatin e përcaktuar në aneksin 2, ose përmes kërkesave raportuese të CPC-ve.

77. Kapitenët anijeve të peshkimit me rrethim duhet të përgatisin raporte sipas paragrafin 76 mbi operacionet e peshkimit, duke përfshirë edhe operacionet ku zëniet janë zero. Raportet do të transmetohet nga operatori tek autoriteti CPC i vendit të tij, deri në orën 09:00(GMT) të ditës tjetër.

78. Zotëruesit e kurtheve ose autoritetet e tyre përgjegjëse për peshkimin e tonit duhet të dërgojnë raport ditor mbi zëniet ditore në format elektronik, në të cilin do të përfshijnë numrin e regjistrit ICCAT, datën, kohën, zëniet (pesha dhe numri i peshkut), duke përfshirë edhe ato ku peshkimin zero. Ata do të dërgojnë këtë informacion CPC-së tyre, brenda 48 orësh në formë elektronike sipas formatit të përcaktuar në aneksin 2 përgjatë gjithë periudhës që ato janë të autorizuar për të peshkuar tonin.

79. Përveç anijeve të peshkimit me rrethim dhe kurtheve të zënies së tonit, kapitenët e anijeve të tjera, transmetojnë pranë autoriteteve të tyre të kontrollit, raportet e përmendura në paragrafin 76, së paku deri në mesditën e së martës për javën e mëparshme që përfundon të dielën.

Portet e caktuara

80. Çdo CPC, të cilit i është alokuar një kuote e tonit, do të përcaktojë portet në të cilat operacioni i zbarkimit apo i transbordimi të tonit është i autorizuar. Kjo listë do të komunikohet çdo vit në Sekretariatin e ICCAT-it si pjesë e planit vjetor të peshkimit të komunikuar nga çdo CPC. Çdo ndryshim do t'i komunikohet Sekretariatit të ICCAT-it. CPC-të e tjera mund të caktojnë portet në të cilat autorizohet zbarkimi ose transbordimi i tonit dhe të komunikojnë këtë listë të këtyre porteve te Sekretariati i ICCAT-it.

81. Për një port që të përcaktohet si port i caktuar, shteti portual do të sigurojë që kërkesat e mëposhtme plotësohen:

a) përcaktimin e kohës së zbarkimit dhe të transbordimit;

b) përcaktimin e vendit të zbarkimit dhe të transbordimit;

c) vendosjen e procedurave të inspektimit dhe të mbikëqyrjes që sigurojnë mbikëqyrje e inspektim gjatë të gjitha kohës dhe në të gjitha vendet e zbarkimit dhe të transbordimit në përputhje me paragrafin 85.

82. Ndalohet të zbarkohet ose të transbordohet nga anijet e peshkimit, si dhe nga anijet përpunuese dhe anijet ndihmëse, çdo sasi toni të peshkuara në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe, në çdo vend tjetër përveç se porteve të përcaktuara nga CPC-ja, në përputhje me paragrafët80 deri 81. Megjithatë, përjashtimisht, transportimi i tonit të ngordhur të zënë në kurth/kosh, duke përdorur një anije ndihmese për në anijet e përpunimit, nuk është i ndaluar.

83. Në bazë të informacionit të marrë nga CPC sipas paragrafit 80, Sekretariati i ICCAT do të mbajë një listë të porteve të përcaktuara në website ICCAT.

84. Dispozitat e këtij Rekomandimi nuk do të ndikojnë në hyrjen në port të një anije peshkimi të CPC-ve, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, për arsye të forcës madhore ose fatkeqësisë.

Njoftimi paraprak i zbarkimeve

85. Para hyrjes në ndonjë port, kapitenet e anijeve të peshkimit, si dhe të anijeve e përpunuese dhe anijeve ndihmëse ose përfaqësuesit e tyre, duhet të njoftojnë autoritetin përkatës të portit, të paktën 4 orë përpara kohës së parashikuar të mbërritjes, me sa vijon:

a) koha e parashikuar për mbërritje;

b) sasia e vlerësuar e tonit të mbajtur në bord;

c) informacioni mbi zonën gjeografike ku është zënë toni.

Nëse zonat e peshkimit janë më pak se katër orë nga porti ku mbërrihet, sasitë e vlerësuara të tonit të mbajtura në bord mund të modifikohen në çdo kohë përpara arritjes në port.

CPC-të mund të vendosin të zbatojnë këto dispozita vetëm për zënie të barabarta ose më të mëdha se tre peshk ose një ton. Ata duhet të japin këtë informacion në planin e kontrollit të tyre të monitorimit dhe inspektimit të përmendur në paragrafin 10.

Autoriteti shtetit portual mban një regjistër me të gjitha njoftimet paraprake për vitin në vazhdim.

Të gjitha veprimet e zbarkimit dhe zënieve duhet të kontrollohen nga autoritetet përkatës të kontrollit dhe një përqindje e tyre duhet të inspektohet, bazuar në sistemin e vlerësimit të riskut, duke përfshirë kuotën, përmasat e flotës dhe sforcon e peshkimit. Detaje të plota të këtij sistemi kontrollesh të përshtatura nga çdo CPC, duke përfshirë përqindjen e synuar të zbarkimeve që do të inspektohen, duhet të jenë të detajuara në planin e tyre vjetor të inspektimit referuar paragrafit 10 të këtij rekomandimi.

Pas çdo udhëtimi, kapitenët e anijeve të peshkimit, duhet të dorëzojnë brenda 48 orëve një deklaratë zbarkimi tek autoritetet kompetente të CPC-së ku bëhet ky zbarkim, si dhe shtetit të tij flamur. Kapiteni i anijes peshkimit të autorizuar është përgjegjës për plotësimin dhe vërtetësinë e deklaratës, e cila duhet të tregojë së paku, sasinë e tonit të zbarkuar dhe zonën ku është zënë. Të gjitha zëniet e zbarkuara duhet të peshohen dhe jo vetëm të vlerësohen. Autoriteteve përkatëse do të dërgojnë një regjistrim mbi zëniet në autoritetin përkatës të CPC-së të anijes së peshkimit, brenda 48 orëve nga përfundimi i zbarkimit.

Raportimi i zënieve nga CPC-ja tek Sekretariati i ICCAT-it

86. CPC-të do të dërgojnë raporte dyjavore të zënies për çdo formë e mjet peshkimi, pa vonesë, në Sekretariatin e ICCAT-it, për të siguruar që afati i publikimit të të dhënave të specifikuara më poshtë mund të përmbushet. Në rastin e anijeve me koshilok dhe të kurtheve, raportet do të jenë siç përcaktohen në paragrafët 76 deri në 78. Kapjet totale të raportuara do të publikohen nga Sekretariati i ICCAT-it në faqen e internetit të ICCAT-it një zonë të mbrojtur me fjalëkalim, gjatë javës së dytë të çdo muaji.

87. CPC-të do t'i raportojë Sekretariatit të ICCAT-it datën kur e gjithë kuota e tonit është shfrytëzuar. Sekretariati i ICCAT-it duhet ta shpërndajë këtë informacion të gjitha CPC-ve.

Verifikimi

88. CPC-të duhet të verifikojnë, si raportet e inspektimit dhe raportet e vëzhguesit, të dhënat VMS-ve, ku është e mundur të dhënat eBCD, si dhe dorëzimin në kohë të logbookeve dhe informacionin e kërkuar të shënuar në logbooket e anijeve të peshkimit, në dokumentet e transferimit/transbordimit dhe në dokumentet e zënieve.

Autoritetet kompetente do të kryejnë kontrolle të kryqëzuara, sipas specieve në të gjitha zbarkimet, transshipmentet, transferimet dhe vendosjes në koshave midis sasive të regjistruara në logbookun e anijeve të peshkimit ose në deklaratën e transshipit dhe sasive të regjistruara në deklaratën e zbarkimit ose deklaratën e koshave, dhe çdo dokumentacion tjetër përkatës, të tilla si fatura dhe/ose shënime shitjeje.

Transbordimi

89. Operacionet e transbordimit të tonit në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe do të lejohen vetëm në portet e caktuara sipas përcaktimeve dhe kushtëzimeve në paragrafët 80 deri 84.

90. Para hyrjes në ndonjë port, anija e peshkimit marrëse (që ka marrë peshkun), ose përfaqësuesi i saj, duhet t'i japë autoritetit përkatëse të shtetit portual të paktën 72 orë përpara kohës së parashikuar të mbërritjes, informacionin e shënuar në **shtojcën 3**, sipas ligjit kombëtar të shtetit portual. Çdo transbordim kërkon autorizimin paraprak nga CPC-ja e anijes së peshkimit transborduese. Për më tepër, kapiteni i anijes peshkimit transborduese, në kohën e transbordimit, informon CPC-në e tij sipas të dhënave të kërkuara në **shtojcën 3**.

91. Autoriteti përkatës i shtetit portual duhet të inspektojë anijen marrëse në mbërritje dhe do të kontrollojë ngarkesën dhe dokumentacionin që lidhet me operacionin e transbordimit.

92. Kapitenët e anijeve të peshkimit plotësojnë dhe transmetojnë te CPC-të e tyre deklaratën e transbordimit jo më vonë se 5 ditë pas transbordimit në port, sipas rekomandimit 21-15. Kapitenët e anijeve të peshkimit transborduese plotësojnë deklaratën e transbordimit të ICCAT-it, në përputhje me formatin e përcaktuar në shtojcën 3. Deklarata transbordimit duhet të jetë e lidhur me eBCD për të lehtësuar verifikimin e të dhënave të përmbajtura në to.

93. Organi kompetent i shtetit portual do të dërgojë të dhëna të transbordimit autoritetit të CPC të anijeve të peshkimit transborduese, brenda 5 ditëve pasi transbordimi ka përfunduar.

94. Të gjitha transbordimet do të inspektohen nga autoritetet përkatëse të portit caktuar nga CPC-ja.

PJESA IV
MASAT KONTROLLUESE

SEKSIONI C
PROGRAMET E VËZHGUESVE

Programi i vëzhguesit (mbikëqyrësit) i CPC-së

95. Çdo CPC siguron mbulimin nga vëzhguesit, për të cilët lëshohet një dokument zyrtar identifikimi, për anijet dhe kurthet aktive në peshkimin e tonit, për të paktën:

- 20% të anijeve aktive me peshkim fundor pellagjik (mbi 15 m);
- 20% të anijeve aktive me linje grepash (mbi 15 m);
- 20% të anijeve aktive me grepa lundrues (mbi 15 m);
- 100% të anijeve tërheqëse (rimorkiator);
- 100% të operacioneve të zënies me kurthe.

96. CPC-ja me më pak se pesë anije, sipas tri segmenteve të para të mësipërme, të autorizuara për të peshkuar në mënyrë aktive tonin, duhet të sigurojnë mbulimin me vëzhgues në 20% të kohës që këto anije janë aktive në peshkimin e tonit.

97. Në zbatimin e programit të vëzhguesve, CPC-të duhet të sigurojnë që:

a) mbulimi në kohë dhe hapësire është përfaqësues për të siguruar që Komisioni të marrë të dhëna dhe informacione të përshtatshme dhe të sakta për zëniet, përpjekjet për zënie (efforts) dhe aspekte të tjera shkencore dhe menaxheriale të lidhura me tonin, duke marrë parasysh karakteristikat e flotës dhe peshkimit;

b) janë zbatuar protokolle të fuqishme për mbledhjen e të dhënave;

c) vëzhguesit të CPC-së i sigurohet, përpara fillimit të vendosjes së tij/saj në anije, një listë e kontakteve brenda autoritetit kompetent të CPC-së ku duhet të raportojë vëzhgimet;

d) çdo vëzhgues CPC është trajnuar dhe kualifikuar siç duhet përpara dislokimit;

e) për aq sa është praktike, operimet e anijeve dhe kurtheve në fjalë pësojnë ndërprerje minimale;

f) kapiteni i anijes së peshkimit ose operatori i kurthit i lejon vëzhguesit të CPC-së aksesin në mjetet elektronike të komunikimit në bordin e anijes së peshkimit ose në kurth.

98. Të dhënat dhe informacioni i mbledhur në secilin prej programeve të vëzhgimit nga CPC-të do t'i dërgohen SCRS dhe Komisionit, në përputhje me kërkesat dhe procedurat që do të hartohen nga Komisioni gjatë vitit 2023, duke marrë parasysh kërkesat e konfidencialitetit nga ana e CPC-ve.

99. Për aspektin shkencor të këtij programi, SCRS do të raportojë për nivelin e mbulimit të arritur nga çdo CPC, dhe do të sigurojë një përmbledhje të të dhënave të mbledhura dhe çdo rezultat të rëndësishëm të lidhur me këto të dhëna. SCRS-ja do të japë çdo rekomandim që lidhet me përmirësimin e efikasitetit të programit të vëzhgimit të CPC-së.

100. Detyrimet, përgjegjësitë dhe detyrat e zbatueshme për vëzhguesit e CPC-ve janë të detajuara në aneksin 6.

Programi Rajonal i Vëzhguesve të ICCAT (ROP)

101. Programi Rajonal i Vëzhguesve të ICCAT-it referuar në aneksin 6 do të zbatohet për të siguruar mbulimin 100% me vëzhgues:

- të të gjitha anijeve me rrethim të tonit;
- gjatë të gjitha transferimeve të tonit nga koshiloku anijes në koshat transportues;
- gjatë të gjitha transferimeve të tonit nga kurthet në koshat transportues;
- gjatë të gjitha transferimeve nga një kosh ferme në kosha transporti, të cilat më pas tërhiqen në një fermë tjetër;
- gjatë të gjitha kalimeve të tonit në ferma;
- gjatë gjithë vjeljes së tonit nga fermat; dhe
- gjatë lëshimit të tonit nga fermat.

Pavarësisht nga parashikimet e paragrafit 95, për lëshimet e tonit nga ferma, vetëm vëzhguesi rajonal, dhe jo vëzhguesi kombëtar, duhet të jetë prezent mbi anijen transportuese.

Pavarësisht nga sa më sipër, kur, për arsye të forcës madhore (p.sh., pandemia) të njoftuara siç duhet në ICCAT, vendosja e një vëzhguesi rajonal nuk është i mundur, anija, kurthi ose ferma mund të funksionojnë pa vëzhguesin. Në raste të tilla, CPC-të do t'i japin përparësi këtyre anijeve, fermave dhe kurtheve për kontroll dhe inspektim.

Përveç kësaj, CPC-të do të zbatojnë një sërë masash alternative të përshtatshme që synojnë arritjen e objektivave të programit të vëzhguesit rajonal, duke përfshirë, aty ku është e mundur, vendosjen e një inspektori kombëtar ose një vëzhguesi kombëtar për të vepruar në vend të vëzhguesit rajonal. CPC-ja në fjalë do t'i dërgojë Sekretariatit të gjitha detajet e masave alternative. Sekretariati përpilon dhe i qarkullon Komisionit të gjithë informacionin e marrë për zbatimin e këtyre procedurave. Këto masa alternative dhe veprimet e ndërmarra do të shqyrtohen nga Komiteti i Pajtueshmërisë gjatë çdo takimi vjetor.

102. Si përjashtim i paragrafit 101, vjelja nga fermat deri në 1000 kg në ditë dhe deri në maksimum 50 tonë në fermë në vit për furnizimin e tregut me peshk të freskët mund të autorizohet nga CPC-ja përkatëse me kusht që një inspektor i autorizuar nga CPC e fermës është në vend për 100% të vjeljeve të tilla dhe kontrollon të gjithë funksionimin. Inspektori i autorizuar do të vërtetojë, gjithashtu, sasitë e vjela në sistemin eBCD. Në këtë rast, nënshkrimi i vëzhguesit rajonal nuk duhet të kërkohet në seksionin e korrjes së eBCD. Ky derogim do të rishikohet, sipas rastit, nga PWG, ndoshta përmes grupit të punës të IMM-së, jo më vonë se në vitin 2023.

103. Anijet e peshkimit me rrethim pa një vëzhgues rajonal të ICCAT-it në bord, nuk do të autorizohen për të peshkuar ose të operojnë në peshkimin e tonit.

104. Një vëzhgues rajonal i ICCAT-it do të caktohet në çdo fermë për të gjitha operacionet në

kosha dhe gjate vjeljes. Në rastet e forcës madhore që janë konfirmuar nga autoriteti CPC i fermës, ose në rastin e fermave të afërta, të autorizuara dhe kontrolluara nga CPC e fermës, veprojnë se bashku, një vëzhgues rajonal i ICCAT-it mund të ndahet në më shumë se një fermë për të garantuar vazhdimësinë e operacioneve nëse autorizohet nga autoriteti kompetent i CPC-së.

105. Me përjashtim të paragrafit 104, në rast transferimi ndërmjet dy fermave të ndryshme nën kompetencën e të njëjtit autoritet kombëtar, mund të caktohet një vëzhgues i vetëm rajonal për të mbuluar të gjithë procesin, duke përfshirë transferimin e peshkut në një kosh transporti tërheqës, tërheqja e peshkut nga ferma dhuruese në fermën marrëse dhe kalimi i peshkut në koshin e fermës marrëse. Në këtë rast, një vëzhgues rajonal duhet të vendoset nga ferma e donatorëve dhe kostoja do të ndahet, si nga ferma donatore, ashtu edhe nga ajo pritëse, përveç nëse përcaktohet ndryshe nga fermat.

106. Si çështje prioritare, vëzhguesit rajonalë të ICCAT-it nuk duhet të jenë të së njëjtës kombësi me anijen e zënies, anijen tërheqëse, kurthin ose fermën, për të cilat kërkohen shërbimet e tyre dhe për aq sa është e mundur, Sekretariati i ICCAT-it dhe ofruesi përgjegjës për ROP-në do të sigurojnë që vëzhguesi të ketë një përvetësim të kënaqshëm të gjuhës, të CPC-së së cilës i përket anija dhe ferma ose kurthi. Kërkesa që vëzhguesi rajonal të mos jetë me të njëjtën kombësi me anijen, fermën ose kurthin, i cili po vëzhgohet, do të ketë prioritet në rastin kur vëzhguesit rajonalë të ICCAT-it të dislokuar të kenë njohuri të kënaqshme të gjuhës së anijeve, fermës apo kurtheve të CPC-së së caktuar. Nëse nuk është e mundur të gjenden vëzhgues të huaj me aftësitë e duhura gjuhësore ose në rast të forcës madhore, mund të lejohet vendosja e vëzhguesve rajonalë të ICCAT-it të së njëjtës kombësi, me kusht që njoftimi paraprak për Sekretariatin e ICCAT-it të bëhet nga ofruesi përgjegjës për ROP-në.

107. Detyrimet, përgjegjësitë dhe detyrat e zbatueshme për vëzhguesin rajonal të ICCAT dhe kurthit dhe fermës CPC-të përkatëse, janë të detajuara në shtojcën 6.

PJESA IV
MASAT E KONTROLLIT

SEKSIONI D
TRANSFERIMET E PESHKUT TË GJALLË

Dispozita e përgjithshme

108. Ky seksion zbatohet për të gjitha transferimet e përcaktuara në paragrafin 2(i) të këtij Rekomandimi.

109. Në përputhje me paragrafin 10(c) të këtij Rekomandimi, çdo CPC do të emërojë një autoritet të vetëm kompetent, në vijim të referuar si "autoriteti kompetent i CPC-së", i cili do të jetë përgjegjës për koordinimin e mbledhjes dhe verifikimit të informacionit për kontrollin e transferimeve dhe transporteve përkatëse të tonit të kryera nën juridiksionin e tij, dhe për raportimin dhe bashkëpunimin me CPC-të, në fermat e të cilave do të vendoset peshku në kosh.

110. Kapitenët e anijeve të zënies dhe tërheqëse që kryejnë operacione transferimi duhet të raportojnë aktivitetet e tyre të transferimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aneksin 2 *(logbook)*.

Numër unik i caktuar për kosh

111. Të gjitha koshat e përdorur në operacionet e transferimit dhe transportet shoqëruese do t'i vendoset një numër në përputhje me sistemin unik të numërimit të përmendur në paragrafët 147 deri në 150.

Njoftimi paraprak i transferimit

112. Përpara fillimit të një operacioni transferimi, duke përfshirë transferimet vullnetare, kapiteni i anijes se peshkimit ose rimorkiatorit apo përfaqësuesit e tyre ose përfaqësuesit e fermës apo kurthit, ku nis transferimi në fjalë, duhet t'i dërgojë autoritetit të tij kompetent të CPC-së një njoftim paraprak transferimi. duke treguar, aty ku është e aplikueshme:

- numri dhe pesha e vlerësuar e tonit që do të transferohet;
- emri i anijes që e ka peshkuar, anijeve tërheqëse, fermës ose kurthit dhe numri përkatës i tyre në regjistrin e ICCAT-it,
- datën dhe vendndodhjen e kapjes;
- data dhe koha e parashikuar e transferimit;
- pozicioni i vlerësuar (gjerësia/gjatësia) ku do të bëhet transferimi dhe numrat e koshit të dhuruesit dhe marrësit;

- ferma ku do shkoje;

- emrin dhe numrin ICCAT të fermës dhuruese, në rastin e një transferimi nga koshi i fermës në një kosh transporti;

- numrat e dy koshave të fermës dhe çdo koshi transporti të përfshirë, në rastin e transferimeve brenda fermës.

Autorizimi i transferimit

113. Brenda 48 orëve pas dorëzimit të njoftimit paraprak të transferimit nga operatori dhurues, autoriteti kompetent i CPC-së do t'i caktojë dhe do t'i komunikojë operatorit donator në fjalë një numër të autorizimit të transferimit për çdo operacion transferimi. Numri i autorizimit të transferimit duhet të përfshijë kodin me tri shkronja CPC, katër numra për vitin dhe tri shkronja për të treguar autorizimin pozitiv (AUT) ose negativ (NEG), të ndjekur nga numrat vijues.

114. Operacioni i transferimit në fjalë nuk do të fillojë përpara se numri i tij specifik i autorizimit të transferimit t'i jetë caktuar dhe komunikuar operatorit dhurues.

115. Autorizimi i transferimit nuk paragjykon konfirmimin e ndonjë operacioni të mëvonshëm transferimi ose kalimi në kosha.

116. Transfertat vullnetare dhe ato të kontrollit nuk i nënshtrohen një autorizimi të ri transferimi.

Refuzimi i një operacioni transferimi dhe rrjedhimisht lirimi i tonit

117. Një operacion transferimi nuk do të autorizohet nga autoriteti kompetent i CPC-së i operatorit dhurues nëse, pas marrjes së njoftimit paraprak të transferimit, ai konsideron se:

a) anija peshkimit ose kurthi që deklaron se ka kapur peshkun nuk ka një autorizim të vlefshëm për peshkimin e tonit, të lëshuar në përputhje me paragrafin 56 të këtij rekomandimi;

b) numri dhe pesha e peshkut që i nënshtrohet transferimit nuk është raportuar siç duhet nga anija e peshkimit ose kurthi;

c) anija peshkimit ose kurthi që ka kapur peshkun nuk ka kuotë të mjaftueshme;

d) anija tërheqëse e deklaruar për të transferuar dhe/ose transportuar peshkun nuk është e regjistruar në Regjistrin e ICCAT si anije të tjera të peshkimit të përmendura në paragrafin 48(b), ose nuk është e pajisur me një sistem monitorimi të anijeve (VMS) plotësisht funksional;

e) ferma e ku do shkoje toni, nuk raportohet si aktive në Regjistrin e fermave të ICCAT-it të përmendur në paragrafin 63 të këtij Rekomandimi.

118. Në rast refuzimi, autoriteti kompetent i CPC-së i operatorit dhurues:

a) të informojë menjëherë operatorin dhurues për refuzimin, si dhe organin kompetent të CPC-së për anijen e peshkimit, kurthin ose fermën, nëse është një CPC tjetër;

b) kur është e zbatueshme, të lëshojë një urdhër për lirimin e peshkut në fjalë në det, në përputhje me shtojcën 10.

Monitorimi i operacioneve të transferimit me videokamera

119. Përveç transferimeve të koshave ndërmjet dy anijeve tërheqëse, të cilat nuk përfshijnë lëvizjen e tonit të gjallë ndërmjet këtyre koshave, operatori dhurues duhet të sigurojë që operacioni i transferimit të monitorohet me videokamerë në ujë, në përputhje me standardet minimale dhe procedurat e referuara në shtojcën 8, për të përcaktuar numrin e individëve të tonit që transferohen.

120. Çdo CPC që kryen operacione dhurimi do të marrë masat e nevojshme për të siguruar që kopjet identike të regjistrimeve përkatëse video të jepen (ofrohen) pa vonesë nga operatori dhurues:

a) për operacionin e parë të transferimit dhe transferimin vullnetar eventual, tek vëzhguesi rajonal i ICCAT-it dhe tek anija tërheqëse marrëse dhe, në fund të udhëtimit të peshkimit, tek autoriteti kompetent i CPC-së të operatorit dhurues;

b) për transferime të mëtejshme, tek vëzhguesi i CPC-së në bordin e anijes tërheqëse dhuruese, tek kapiteni i anijes tërheqëse marrëse dhe, në fund të udhëtimit të tërheqjes, tek autoriteti kompetent i CPC-së të anijes tërheqëse dhuruese;

c) për transferimet ndërmjet dy fermave të ndryshme, tek vëzhguesi rajonal i ICCAT-it, tek mjeti tërheqës marrës dhe tek autoriteti kompetent i CPC-së i fermës dhuruese; dhe

d) nëse një autoritet inspektues kombëtar ose i ICCAT-it është i pranishëm gjatë operacionit të transferimit, inspektori/ët do të marrin, gjithashtu, një kopje të regjistrimit përkatës të videos.

121. Pamjet video në fjalë do të shoqërojnë peshkun deri në fermën ku do të dërgohet peshku. Një kopje do të ruhet në bordin e anijes/ve donatore, nga kurthi/at ose nga ferma/et dhe do të

mbetet e aksesueshme për qëllime kontrolli në çdo kohë gjatë fushatës së peshkimit.

122. Kopjet e videoregjistrimeve do t'i jepen SCRS-së sipas kërkesës nga autoriteti kompetent i CPC-së i operatorit dhurues. SCRS-ja do të ruajë konfidencialitetin e aktiviteteve tregtare.

123. Autoriteti kompetent i CPC-së i operatorit dhurues dhe operatori dhurues do t'i ruajnë pamjet video, në lidhje me transferimet për të paktën 3 vjet dhe do t'i ruajnë ato për aq kohë sa është e nevojshme për qëllime kontrolli dhe zbatimi.

Transferimet vullnetare dhe të kontrollit

124. Nëse filmimi video nuk plotëson standardet minimale të përmendura në shtojcën 8, dhe veçanërisht nëse cilësia dhe qartësia e tij nuk janë të mjaftueshme për të përcaktuar numrin e peshqve që transferohen, operatori dhurues mund të kryejë transferimin/et vullnetar.

125. Nëse nuk është kryer asnjë transferim/t vullnetar, ose nëse transferimi/et vullnetar ende nuk lejon përcaktimin e numrit të peshqve që transferohen, autoriteti kompetent i CPC-së i operatorit dhurues do të urdhërojë një transferim kontrolli, i cili do të përsëritet derisa cilësia e regjistrimit video të lejojë vlerësimin e numrit të tonit që transferohet.

126. Transferimi/t vullnetar dhe/ose kontrolli/t do të kryhet në një kosh tjetër i cili duhet të jetë bosh. Numri i peshqve të marrë nga transferimi i vlefshëm vullnetar ose i kontrollit do të përdoret për të plotësuar *logbook*-un, deklaratën e transferimit të ICCAT-it (ITD) dhe seksionet përkatëse të eBCD-së.

127. Ndarja e koshit të transportit nga një anije me koshilok, një kurth ose një kosh ferme nuk duhet të ndodhë përpara se vëzhguesi rajonal i ICCAT-it në bordin e anijes, ose i pranishëm në fermë ose kurth, të ketë kryer detyrat e tij.

128. Megjithatë, nëse pas transferimit/ve vullnetar cilësia e videos nuk lejon përcaktimin e numrit të individëve që transferohen, autoriteti kompetent i CPC-së i operatorit dhurues mund të lejojë ndarjen e anijes me koshilok, kurthit ose koshit të fermës nga koshi/at e transportit. Në një rast të tillë, autoriteti kompetent i CPC-së i operatorit dhurues do të urdhërojë që dera/t e koshit/eve të transportit në fjalë, të vulosen në përputhje me procedurën e përcaktuar në shtojcën 14 dhe të kërkojë një transferim kontrolli që të kryhet në një kohë dhe vend të caktuar, në prani të autoritetit kompetent të anijes, kurthit ose fermës.

129. Në rast se autoritetet kompetente të anijes, kurthit ose fermës nuk mund të jenë të pranishme në transferimin e kontrollit, transferimi i kontrollit do të bëhet në prani të një vëzhguesi rajonal të ICCAT-it. Në këtë rast, përgjegjësia për vendosjen e vëzhguesit rajonal do të jetë mbi operatorin e fermës që zotëron tonin e transportuar, i cili duhet të sigurojë që vëzhguesi rajonal të vendoset për të verifikuar transferimin e kontrollit.

Deklarata e transferimit të ICCAT-it (ITD)

130. Në fund të një operacioni transferimi, operatori dhurues duhet të plotësojë një ITD në përputhje me formatin e përcaktuar në shtojcën 4. Operatori dhurues do t'ia transmetojë ose vërë në dispozicion pa vonesë, ITD-në, autoritetit të tij kompetent të CPC-së, vëzhguesit rajonalë të ICCAT-it ku prania e tij është e detyrueshme dhe, sipas rastit, kapitenit të anijes tërheqëse ose fermës që merr peshkun.

131. Autoriteti kompetent i CPC-së të operatorit dhurues do të sigurojë që formulari ITD të jetë i numëruar, duke përdorur kodin CPC me tri shkronja, i ndjekur nga katër numrat që tregojnë vitin dhe tre numrat vijues, të ndjekur nga tri shkronjat ITD (CPC- 20**/xxx/ITD).

132. Origjinali i ITD-së duhet të shoqërojë peshkun e transferuar deri në fermën/at e destinacionit ku peshku do të vendoset në kosh:

a) në transferimin e parë, origjinali i ITD-së do të kopjohet nga operatori dhurues kur një zënie e vetme transferohet nga koshiloku i anijes ose kurthi në më shumë se një kosh transporti;

b) në rastin e një transferimi të mëtejshëm, kapiteni i anijes tërheqëse dhuruese do të përditësojë ITD-në duke plotësuar pjesën 3 (transferime të mëtejshme) dhe do t'i japë ITD-në e përditësuar anijes tërheqëse marrëse.

133. Një kopje e ITD-së do të mbahet në bordin e anijeve se peshkimit ose tërheqëse të dhuruesit, ose nga kurthi apo ferma e dhuruesit dhe të jetë e aksesueshme në çdo kohë për qëllime kontrolli gjatë kohëzgjatjes së fushatës së peshkimit.

Hetimi nga autoriteti kompetent i CPC-së i operatorit dhurues

134. Autoriteti kompetent i CPC-së i operatorit dhurues do të hetojë të gjitha rastet, kur:

a) ka më shumë se 10% diferencë midis numrit të peshkut të raportuar në ITD nga operatori

dhurues dhe numrit të peshqve të vlerësuar nga vëzhguesi rajonal i ICCAT-it, ose nga vëzhguesi kombëtar i CPC-së, sipas rastit; ose

b) kur vëzhguesi rajonal i ICCAT-it nuk ka nënshkruar ITD.

Marzhi i gabimit prej 10% i përmendur më sipër do të shprehet si përqindje e shifrave të operatorit dhurues.

135. Kur është e aplikueshme, hetimi do të përfshijë analizën e të gjitha pamjeve përkatëse të videos. Me përjashtim të rasteve të forcës madhore, hetimi do të përfundojë brenda 96 orëve nga fillimi i tij, dhe në çdo rast para mbërritjes së koshit të transportit në fermën e destinacionit.

136. Në fillimin e një hetimi, autoriteti kompetent i CPC-së i operatorit dhurues do të informojë autoritetin kompetent të CPC-së së anijes/ve tërheqëse, në lidhje me hetimin dhe siguron që, deri në përfundimin e hetimit, të mos lejohet asnjë transferim nga ose në koshin e transportit në fjalë.

137. Për të gjitha operacionet e transferimit ku kërkohet një video, një diferencë më e madhe se 10%, midis numrit të tonit të raportuar nga operatori dhurues në ITD dhe numrit të përcaktuar nga autoriteti kompetent i CPC-së i operatorit dhurues në vijim të një hetimi, do të përbëjë një mospërputhje të mundshme (PNC) të anijes së peshkimit, kurthit ose fermës në fjalë.

Ndryshimet në ITD dhe eBCD pas inspektimeve në det ose hetimeve

138. Nëse pas një inspektimi në det ose një hetimi, rezulton se numri i peshqve është më shumë se 10% nga ai i deklaruar në ITD dhe eBCD, eBCD do të ndryshohet nga autoriteti kompetent i CPC-së i operatorit dhurues për të reflektuar rezultatin e hetimit.

Peshqit që ngordhin gjatë operacioneve të transferimit dhe transportit

139. Numri i peshqve që ngordhin gjatë një operacioni transferimi, ose gjatë transportit të peshkut në fermën e destinacionit, raportohet nga operatori dhurues në përputhje me procedurat dhe modelin e përcaktuar në shtojcën 11.

PJESA IV
MASAT E KONTROLLIT

SEKSIONI E
KULTIVIMI NË KOSHA

Dispozitat e përgjithshme

140. Çdo CPC që ka ferma do të emërojë një autoritet të vetëm kompetent, në vijim i referuar si "autoriteti kompetent i CPC-së për fermën". Ky autoritet do të jetë përgjegjës për koordinimin e mbledhjes dhe verifikimit të informacionit mbi aktivitetet kombëtare të kultivimit në kosha, për kontrollin e aktiviteteve të fermave të kryera nën juridiksionin e tij dhe për raportimin dhe bashkëpunimin me autoritetet kompetente të CPC-ve, anijet me flamur të të cilave ose kurthi i tij, peshkuan tonin e futur në kosha.

141. Kur fermat ndodhen përtej ujërave nën juridiksionin e një CPC-je, dispozitat e këtij seksioni do të zbatohen, *mutatis mutandis*, për CPC-të ku ndodhen personat fizikë ose juridikë përgjegjës për fermën.

142. Të gjitha aktivitetet e fermës do t'i nënshtrohen kontrollit të përshkruar në planin e monitorimit, kontrollit dhe inspektimit të paraqitur sipas paragrafit 10 të këtij Rekomandimi.

143. Të gjitha CPC-të e përfshira në aktivitetet e lidhura me kultivimin do të shkëmbejnë informacion dhe do të bashkëpunojnë për të siguruar që numri dhe pesha e tonit të destinuar për futjen në koshat e rritjes janë të sakta, në përputhje me sasitë e kapjes të raportuara nga anija me koshilok ose nga kurthi dhe të deklaruara në seksionet përkatëse të eBCD.

144. CPC-të me ferma inkurajohen të shkëmbejnë përvojën dhe praktikat më të mira mbi kontrollin dhe inspektimin, në lidhje me aktivitetet e kultivimit, duke përdorur programin pilot për shkëmbimin vullnetar të personelit inspektues sipas rek. ICCAT 19-17.

145. Autoriteti kompetent i CPC-së së fermës do të sigurojë që operatorët e fermave të mbajnë në çdo kohë një plan të saktë skematik të fermave të tyre, duke treguar numrin unik të të gjitha koshave dhe pozicionin e tyre individual në fermë. Plani duhet t'i vihet në dispozicion në çdo kohë autoritetit kompetent të CPC-së së fermës për qëllime kontrolli. Çdo modifikim në planin skematik i nënshtrohet njoftimit paraprak të autoritetit

kompetent të CPC të fermës. Plani skematik i fermës do të përshtatet sa herë që ndryshohet numri dhe/ose shpërndarja e koshave të fermës.

146. Autoriteti kompetent i CPC-së i fermës dhe operatori i fermës do të ruajnë të gjithë informacionin, dokumentacionin dhe materialin, në lidhje me aktivitetet e kryera në fermat nën juridiksionin e tij për të paktën 3 vjet, dhe do ta ruajnë informacionin për aq kohë sa është e nevojshme për qëllime të zbatimit.

Numër unik i caktuar për koshat

147. Përpara fillimit të fushatës së peshkimit të tonit, autoriteti kompetent i CPC-së i fermës do të caktojë një numër unik dhe të identifikueshëm për çdo kosh të fermës nën juridiksionin e tij, duke përfshirë edhe ato kosha të përdorura për transportimin e peshkut në fermë.

148. Çdo kosh duhet të identifikohet me një sistem unik numërimi që përfshin të paktën tri shkronjat e kodit CPC, të ndjekur nga tre numra. Numrat unik të koshit duhet të stampohen ose të pikturohen në dy anët e kundërta të unazës së koshit dhe mbi vijën e ujit, në një ngjyrë në kontrast me sfondin në të cilin janë pikturuar ose stampuar, dhe duhet të jenë të dukshëm dhe të lexueshëm në çdo kohë për qëllimet e kontrollit.

149. Lartësia e shkronjave dhe e numrave duhet të jetë së paku 20 centimetra me trashësi vije të paktën 4 centimetra.

150. Lejohen metoda alternative për të shënuar numrin unik në kosh, me kusht që të ofrojnë të njëjtën garanci për dukshmëri, lexueshmëri dhe paprekshmëri.

Autorizimi për vendosjen në kosha

151. Çdo operacion vendosje në kosha i nënshtrohet një autorizimi për vendosjen në kosha të lëshuar nga autoriteti kompetent i CPC-së ku ndodhet ferma.

Procedurat e mëposhtme duhet të zbatohen:

a) operatori i fermës kërkon autorizimi për vendosjen në kosha tek autoriteti kompetent i CPC-së së fermës, duke specifikuar në veçanti numrin dhe peshën (siç përmendet në ITD) të peshqve që do të vendosen në kosha. Kjo kërkese shoqërohet nga:

i. ITD-të përkatëse;

ii. referenca e eBCD(eve) në fjalë, siç konfirmohet dhe vërtetohet nga autoriteti kompetent i CPC-së së anijes ose të kurthit;

iii. të gjitha raportet mbi peshqit që ngordhin gjatë transportit, të regjistruara në përputhje me shtojcën 11.

b) autoriteti kompetent i CPC-së së fermës i njofton informacionin sipas nënparagrafit "a" autoritetit kompetent CPC të anijes ose të kurthit, dhe kërkon konfirmimin që operacioni "Vendosje në kosha" të autorizohet;

c) brenda 3 ditëve pune, autoriteti kompetent i CPC-së së anijes ose të kurthit njofton autoritetin kompetent të CPC-së së fermës së operacionit "Vendosje në kosha" autorizohet ose refuzohet. Në rast refuzimi, autoriteti kompetent i CPC-së së anijes ose të kurthit duhet të specifikojë arsyen/et për refuzimin, dhe refuzimi do të përfshijë urdhrin e lëshimit pasues;

d) autoriteti kompetent i CPC-së së fermës lëshon autorizimin "Vendosje" në kosha menjëherë pas marrjes së konfirmimit nga autoriteti kompetent i CPC-së së anijes ose të kurthit. Operacioni "Vendosje" në kosha nuk do të autorizohet nga autoriteti kompetent i CPC-së së fermës në mungesë të konfirmimit.

152. Asnjë operacion "Vendosje" në kosha nuk do të autorizohet nëse dokumentacioni i plotë i kërkuar sipas paragrafit 151(a) nuk e shoqëron peshkun që i nënshtrohet autorizimit "Vendosje" në kosha.

153. Në pritje të rezultateve të hetimit të përmendur në paragrafët 134 deri 137 të kryera nga autoriteti kompetent i CPC-së së anijes ose të kurthit, operacioni "Vendosje" në kosha nuk do të autorizohet dhe seksionet përkatës të zënies dhe tregtisë së gjallë në eBCD nuk do të vërtetohen.

154. Nëse autorizimi "Vendosje" në kosha nuk është lëshuar nga autoriteti kompetent i CPC-së së fermës brenda 1 muaji pas kërkesës për autorizim të vendosjes në kosha nga operatori i fermës, autoriteti kompetent i CPC-së së fermës do të urdhërojë dhe do të vazhdojë me lëshimin e të gjithë peshqve që gjenden në koshin e transportit në fjalë, në përputhje me shtojcën 10. Autoriteti kompetent i CPC-së së fermës do të informojë në përputhje me rrethanat pa vonesë autoriteti kompetent i CPC-së së anijes ose të kurthit në fjalë, dhe Sekretariatin ICCAT për lëshimet.

Refuzimi i autorizimi për vendosjen në kosha nga CPC-të e anijes ose të kurthit

155. Nëse, pas marrjes së informacionit të përmendur në paragrafin 151(a) autoriteti

kompetent i CPC-së së anijes ose të kurthit konsideron se:

a) anija zënëse ose kurthi i deklaruar që ka zënë peshkun kishte kuotë të pamjaftueshme për të zënë tonin që do të futet në kosha;

b) peshku që do të vendoset në kosha nuk është raportuar siç duhet nga anija ose nga kurthi dhe nuk është marrë parasysh për llogaritjen e çdo kuotë që mund të jetë e zbatueshme;

c) anija zënëse ose kurthi i deklaruar se ka zënë peshkun nuk ka një autorizim të vlefshëm për të peshkuar ton, i lëshuar në përputhje me paragrafin 56 të këtij Rekomandimi,

ai do të përcaktojë numrin e peshqve për të cilët refuzohet vendosja në kosha dhe do të kërkojë pa vonesë autoritetit kompetent CPC të fermës të vazhdojë me sekuestrimin e peshqve në fjalë dhe t'i lirojë menjëherë në det, në përputhje me shtojcën 10.

Operacioni i vendosjes në kosha

156. Në momentin e mbërritjes së anijes tërheqëse në afërsi të fermës, autoriteti kompetent i CPC-së së fermës do të sigurojë që:

a) anija tërheqëse në fjalë mbahet në një distancë prej të paktën 1 milje detare nga çdo objekti i fermës derisa autoriteti kompetent i CPC-së së fermës të jetë fizikisht i pranishëm; dhe

b) pozicioni dhe aktiviteti i anijes tërheqëse përkatëse monitorohet gjatë gjithë kohës.

157. Asnjë operacion vendosje në kosha nuk do të fillojë:

a) përpara se të jetë autorizuar siç duhet nga autoriteti kompetent i CPC-së së fermës;

b) pa praninë e autoritetit kompetent të CPC-së së fermës dhe vëzhguesit rajonal të ICCAT-t;

c) përpara se seksionet e zënies dhe të tregtisë së gjallë të eBCD-së të plotësohen dhe vërtetohen nga autoriteti kompetent i CPC-së së anijes ose të kurthit.

158. Ankorimi i koshave të transportit si kosha ferme, pa lëvizje të peshkut për të lejuar regjistrimin me kamerën stereoskopike është i ndaluar.

159. Pas transferimit të tonit nga koshi i tërheqjes në koshin e fermës, autoriteti i kontrollit të CPC-së së fermës duhet të sigurojë që koshat e fermave që përmbajnë ton janë të mbyllura gjatë gjithë kohës. Zhvulosja do të jetë e mundur vetëm në prani të autoritetit kompetent të CPC-së së fermës dhe pas autorizimit të tij. Autoriteti i kontrollit të CPC-së së fermës do të krijojë protokolle për vulosjen e koshave të fermave, duke siguruar përdorimin e vula zyrtare dhe se këto vula vendosen në mënyrë të tillë që të pengojnë hapjen e dyerve pa thyerjen e vulave.

160. CPC-të e fermave duhet të sigurojnë që zëniet e tonit vendosen në kosha të veçanta, ose seri koshash, dhe të ndara në bazë të CPC-së së anijes së peshkimit dhe vitit të kapjes. Me përjashtim, nëse toni është zënë në kontekstin e një operacioni të përbashkët peshkimi (JFO), zëniet në fjalë do të vendosen në kosha të veçanta ose seri koshash dhe të ndara në bazë të JFO-ve dhe vitit të zënies.

161. Të gjitha operacionet e mbylljes do të përfundojnë përpara datës 22 gusht të çdo viti, përveç rasteve kur CPC e fermës se peshkut ofron arsye të vlefshme, duke përfshirë forcën madhore. Këto arsye duhet të dokumentohen dhe raportuar në raportin vendosjes në kosha të përmendur në paragrafin 186. Në çdo rast, asnjë ton nuk do të vendoset në kosha pas 7 shtatorit. Afatet e mësipërme nuk zbatohen në rastin e transfertave ndërmjet fermave.

Regjistrimi i operacioneve të vendosjes në kosha nga kamerat e kontrollit

162. Autoriteti kompetent i CPC-së së fermës do të sigurojë që çdo operacion i grumbullimit të tonit në fermat e tij është regjistruar nga operatori i fermës, duke përdorur kamera konvencionale dhe stereoskopike. Të gjitha pamjet video duhet të jetë në përputhje me standardet minimale të përcaktuara në shtojcën 8, me përjashtim të pikës 1(d) për pamjet e kamerave stereoskopike.

163. Nëse cilësia e xhirimeve video të kamerës së kontrollit përdoret për të përcaktuar numrin dhe/ose peshën e tonit të mbyllur në kosha nuk përputhet me standardet minimale të aneksit 8, autoriteti kompetent për CPC-në e fermës do të urdhërojë një kontroll të koshit, derisa të jetë i mundur përcaktimi i numrit dhe/ose i peshës. Përsëritja e operacionit të vendosjes në kosha nuk i nënshtrohet një autorizimi të ri të për vendosjen në kosha.

164. Në rastin e kontrollit të koshit, autoriteti kompetent i CPC-së së fermës do të sigurojë që koshi i fermës dhuruese është i mbyllur dhe se koshi nuk mund të manipulohet përpara operacionit të ri të vendosjes në kosha. Koshat e fermës marrëse që përdoren për kontrollin e koshit duhet të jenë bosh.

165. Në përfundim të operacionit të vendosjes në kosha, autoriteti kompetent i CPC-së së fermës do të sigurojë që vëzhguesi rajonal i ICCAT-së ka akses

të menjëhershëm në të gjitha videot dhe pamjet nga kamerat stereoskopike dhe konvencionale, dhe lejohet të bëjë një kopje, nëse synon të përfundojë detyrën e tij për të analizuar pamjet në një kohë apo vend tjetër.

166. CPC-të me ferma aktive të tonit dhe SCRS-të inkurajohen të marrin pjesë në prova duke përdorur Inteligjenca Artificiale (AI), të përfshira në kuadrin e zbatimit të Rezolutës 22-07, për analizën e pamjeve stereoskopike të kamerave, me qëllim automatizimin e përcaktimit të numrit dhe/ose peshës së tonit të mbyllur në kosha, në mënyrë që të reduktohet ngarkesa e punës dhe të shmanget paragjykim i mundshëm njerëzor.

Ngordhjet e peshkut gjate vendosjes në kosha

167. I gjithë toni që ngordh gjatë operacionit të vendosjes në kosha duhet të raportohet nga operatori i fermës, në përputhje me rrethanat, procedurat e përcaktuar në shtojcën 11.

Deklarata e vendosjes në kosha

168. Çdo autoritet kompetent i CPC-së së fermës do të sigurojë që, për çdo operacion të vendosjes në kosha, operatori i fermës paraqet një deklaratë të vendosjes në kosha brenda 1 jave pasi është kryer operacioni aktual i vendosjes në kosha, duke përdorur formularin e përcaktuar në shtojcën 12

Analiza e pamjeve video stereoskopike nga autoriteti kompetent i CPC-së së fermës

169. Autoriteti kompetent i CPC-së së fermës do të përcaktojë numrin dhe peshën e tonit që do të vendoset në kosha, duke analizuar pamjet video të çdo operacioni vendosje në kosha të ofruar nga operatori i fermës. Për të kryer këtë analizë, autoritetet do të ndjekin procedurat e përcaktuara në pikën 1 të shtojcës 9.

170. Kur ka një diferencë prej më shumë se 10% ndërmjet numrit dhe/ose peshës së përcaktuar nga autoriteti kompetent i CPC-së së fermës dhe shifrat përkatëse të raportuara në deklaratën e vendosjes në kosha, autoriteti kompetent i CPC-së së fermës do të nisë një hetim për të identifikuar arsyet për këtë mospërputhje, dhe bën rregullimin eventual të numrit dhe/ose peshës së peshkut që ka qenë i mbyllur në kosha.

171. Marzhi i gabimit prej 10% i përmendur më sipër do të shprehet si përqindje e shifrave të operatorit të fermës.

Komunikimi i rezultateve të vendosjes në kosha të CPC-së të anijes zënëse ose të kurthit

172. Pas përfundimit të një operacioni vendosjes në kosha ose, në rastin e një JFO-je ose kurtheve të të njëjtit shtet anëtar të CPC/BE, të operacionit të fundit të vendosjes në kosha të lidhur me atë JFO ose ato kurthe, autoriteti kompetent i CPC-së së fermës do t'i dërgojë autoritetin kompetent të CPC-së së anijes ose kurthit, rezultatet e operacioneve të vendosjes në kosha përmendura në shtojcën 9, pika 2, nën "a" dhe "b".

173. Çdo autoritet kompetent i CPC-së së fermës do të dorëzojë procedurat dhe rezultatet në lidhje me programin e kamerës stereoskopike (ose metodat alternative) në SCRS deri më 31 tetor çdo vit. SCRS-ja duhet të vlerësojë procedurat dhe rezultatet e tilla dhe t'i raportojë Komisionit në mbledhjen e ardhshme vjetore.

Investigimet e ndërmarra nga CPC-të e anijes zënëse ose të kurthit

174. Kur, për një operacion të vetëm zënie, numri i tonit që vendoset në kosh siç komunikohet nga autoriteti kompetent i CPC-së së fermës në përputhje me paragrafin 172, ndryshon me 10% ose më shumë nga ato raportuar në ITD ose në seksionin zënie dhe/ose transferuar tek eBCD, autoriteti kompetente CPC-së anijes zënëse ose të kurthit, do të fillojë një hetim për të përcaktuar peshën e saktë të zënies që do të zbritet nga kuota kombëtare e tonit, në përputhje me paragrafët 180 deri 182 (përvetësimi i kuotave).

175. Në mbështetje të këtij hetimi, autoriteti kompetente CPC-se anijes zënëse ose të kurthit do të kërkojë të gjitha informacione plotësuese dhe rezultatet e analizës përkatëse të pamjeve video të kryera, në përputhje me këtë Rekomandim nga autoriteti kompetente të CPC-ve të anijes zënëse dhe fermave që kanë qenë përfshirë në transportin dhe operacionin e vendosjes në kosha.

176. Të gjitha autoritetet kompetente të CPC-ve, përfshirë ato anijet e të cilave janë përfshirë në transportin e peshku, do të bashkëpunojë në mënyrë aktive, duke përfshirë shkëmbimin e të gjithë informacionit dhe dokumentacionit në dispozicion të tyre.

177. Autoriteti kompetent i CPC-së së anijes zënëse ose të kurthit do të përfundojë hetimin brenda 1 muaji nga komunikimi i rezultateve të vendosjes në kosha nga autoriteti kompetent i CPC-së së fermës.

178. Një ndryshim më i madh se 10% midis numrit të tonit të raportuar të zënë nga anija ose kurthi në fjalë dhe numrit të përcaktuar nga autoriteti kompetent i CPC-së së anijes zënëse ose të kurthit si rezultat i hetimit, do të përbëjë një mospërputhje të mundshme (PNC) të anijes ose kurth në fjalë.

179. Marzhi i gabimit prej 10% i përmendur më sipër do të shprehet si përqindje e shifrave të raportuara nga kapiteni i anijes së peshkimit ose përfaqësuesi i kurthit dhe do të zbatohet në nivel individual të operacionit të vendosje në kosha.

Marrja e kuotave

180. Autoriteti kompetent i CPC-së së anijes zënëse ose të kurthit do të përcaktojë peshën e tonit që zbritet nga kuota e tij kombëtare, duke marrë parasysh sasitë e vendosura në kosha, të llogaritura në përputhje me dispozitat e shtojcës 9, i cili siguron që pesha në kosha të llogaritet bazuar në raportin gjatësi/peshë për peshqit e egër dhe vdekshmëritë e raportuara, në përputhje me dispozitat e shtojca 11.

181. Megjithatë, për ato raste kur hetimi i përmendur në paragrafin 174 arrin në përfundimin se individët e tonit mungonin në kuptimin e paragrafit 2 të shtojcës 11, pesha e peshkut të munguar do të zbritet nga kuota kombëtare, në përputhje me shtojcën 11, duke aplikuar pesha mesatare individuale në kosha të komunikuar nga autoriteti kompetent i CPC-së së fermës, të numri i tonit në peshkim, siç përcaktohet nga autoriteti kompetent i CPC-së se anijes zënëse ose të kurthit që rezulton nga analiza e tij e filmimeve të transferimit të parë në kuadër të hetimit.

182. Pavarësisht nga paragrafi 181, pas konsultimit me autoritetin/et kompetent/e të CPC-së të përfshirë në transportin e peshkut deri në fermën e destinacionit, CPC-ja e anijes zënëse ose të kurthit mund të vendosë të mos e zbresë nga kuota kombëtare peshkun e përcaktuar në hetim nëse ka qenë i humbur, kur humbjet janë dokumentuar siç duhet si "forcë madhore" nga operatori (d.m.th., fotografitë e koshit të dëmtuar, raportet meteorologjike), i është komunikuar informacioni përkatës autoritetit kompetent të CPC-së menjëherë pas ngjarjes dhe humbjet nuk kanë rezultuar në vdekshmëritë e ditura.

Lëshimet e lidhura me operacionet e vendosjes në kosha

183. Përcaktimi i peshkut që lirohet do të bëhet në përputhje me dispozitat e shtojcës 9 paragrafi 4.

184. Nëse pesha e tonit që futet në kosha është më e madhe se sa ishte deklaruar si i kapur dhe/ose të transferuara, autoriteti kompetent i CPC-së anijes zënëse ose të kurthit do të lëshojë një urdhër lirimi dhe t'ia komunikojë atë pa vonesë autoritetit kompetent të CPC-së së fermës në fjalë. Urdhri i lirimit do të ndjekë dispozitat e shtojcës 9 paragrafi 4, duke marrë parasysh kompensimin e mundshëm në nivel JFO-je ose kurthi, në përputhje me shtojcën 9, paragrafi 5.

185. Operacioni i lëshimit do të kryhet në përputhje me protokollin e përcaktuar në shtojcën 10.

Raportimi i vendosjes në kosha

186. Brenda 15 ditëve pas përfundimit të urdhrave për lirim, autoriteti kompetent i CPC-së së fermës do të lëshojë një raport për vendosjen në kosha për çdo operacion të vetëm të vendosjes në kosha, ose në rastin e një JFO-je ose kurthe të së njëjtës CPC/BE, për grupin e plotë të operacioneve të vendosjes në kosha, në lidhje me atë JFO ose ato kurthe. Raporti i vendosjes në kosha duhet të përfshijë informacionin e përmendur në aneksin 9, paragrafi 3, dhe t'i komunikohet autoriteti kompetent të CPC-së së anijes zënëse ose të kurthit dhe Sekretariatit të ICCAT-it.

PJESA IV
MASAT E KONTROLLIT

SEKTORI F
VJELJA

187. Anijet përpunuese që synojnë të operojnë në ferma ose kurthe duhet të dërgojnë një njoftim paraprak në fermë ose autoritetet kompetente të CPC-së të paktën 48 orë para mbërritjes së anijes në fermë/apo kurth. Njoftimi paraprak duhet të përfshijë të paktën datën dhe kohën e parashikuar të mbërritjes dhe informacionin nëse anija e përpunimit ka tashmë ton në bord dhe, nëse po, të jepen detaje mbi ngarkesën, duke përfshirë sasitë në peshën e përpunuar dhe peshën e gjallë dhe detajet e origjinës së tonit në bord (fermë/kurth dhe CPC).

188. Çdo operacion vjeljeje në ferma ose kurthe do t'i nënshtrohet një autorizimi nga autoriteti kompetent e CPC-së së fermës ose të kurthit. Për këtë qëllim, ferma ose operatori i kurthit që synon të vjelë tonin duhet t'i paraqesë autoritetit kompetent

të CPC-së një kërkesë, e cila duhet të përfshijë të paktën informacionin e mëposhtëm:

- data ose periudha e vjeljes;
- sasitë e parashikuara që do të vilen në numër individësh dhe kg;
- numri eBCD i lidhur me tonin që do të vilet;
- detajet e anijeve ndihmëse të përfshira në operacion;
- destinacioni i tonit të vjele (anija përpunuese, eksporti, tregu lokal etj.).

189. Përveç individëve të tonit që janë afër ngordhjes, nuk do të kryhet asnjë operacion vjeljeje i paautorizuar përpara se rezultatet e marrjes së kuotës në përputhje me paragrafët 180 deri në 182 përcaktohen dhe janë kryer lëshimet shoqëruese.

190. Operacionet e vjeljes nuk do të zhvillohen pa praninë e një vëzhguesi të CPC në rastin e kurtheve, ose një vëzhgues rajonal i ICCAT-it në rastin e vjeljes në ferma. Për peshqit e dorëzuar në anije përpunuese, CPC-ja ose vëzhguesi rajonal i ICCAT-it mund të kryejë detyrat e tij përkatëse në anijen përpunuese.

191. Autoritetet e kontrollit të CPC-se të fermave ose të kurtheve duhet të verifikojnë dhe kontrollojnë rezultatet e të gjitha vjeljeve që zhvillohen në ferma dhe kurthe nën autoritetin e saj, duke përdorur të gjithë informacionin përkatës. Autoritetet e kontrollit CPC të fermave ose kurtheve do të inspektojnë të gjitha operacionet e vjeljes së tonit të destinuara për anije përpunimi dhe një përqindje e pjesës tjetër të operacioneve të vjeljes bazohet në analizen e rrezikut.

192. Kur destinacioni i tonit është një anije përpunimi, zotëruesi ose përfaqësuesi i tij duhet të plotësojë një deklaratë përpunimi. Kur toni i vjelë do të jetë të zbarkuar direkt në port, ferma ose operatori i kurthit duhet të plotësojë një deklaratë vjelje. Deklaratat e përpunimit dhe të vjeljes do të vërtetohen nga vëzhguesi rajonal i ICCAT-it ose CPC-së së pranishëm në operacionin e vjeljes.

193. Deklarata e përpunimit dhe e vjeljes duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm duke përdorur shtojcën 15:

- data e vjeljes;
- fermë ose kurth;
- numri/at e koshit;
- numri i individëve të vjelë;
- pesha e gjallë dhe pesha e përpunuar në kg e tonit të vjelë;
- Numri/at eBCD i/të lidhur me tonin e vjelë;
- detajet e anijeve ndihmëse të përfshira në operacion;
- destinacioni i tonit të vjelë (d.m.th., eksporti, tregu vendës, apo të tjera);
- vërtetimi nga vëzhguesi rajonal i ICCAT-it ose vëzhguesi i CPC-së, sipas rastit.

194. Deklaratat e përpunimit dhe të vjeljes do t'i dërgohen me *e-mail* autoriteteve kompetente të CPC-së së fermës brenda 48 orëve nga operacioni i vjeljes.

195. Komisioni duhet të konsiderojë "Përpunimin në bord" në eBCD, gjatë mbledhjes vjetore më 2023-shibn. Së fundmi, IMM WG dhe me pas eBCD TWG duhet të diskutojnë kërkesat teknike, administrative dhe të kontrollit, dhe të raportojë rezultatet në Komision.

SEKTORI F
KONTROLLI PAS VENDOSJES NË FERMA
TRANSFERIMI BRENDA FERMËS

196. Transferimi brenda fermës nuk do të bëhet pa autorizimin dhe praninë e autoritetit kompetent të CPC-së fermës. Çdo transferim do të regjistrohet nga kamerat e kontrollit për të konfirmuar numrin e transferuar të individëve të tonit. Pamjet video duhet të jenë në përputhje me standardet minimale të përcaktuara në shtojcën 8. Autoriteti kompetent i CPC-së së fermës do të monitorojë dhe do të kontrollojë transferimet, duke siguruar që çdo transferim brenda fermës të regjistrohet në sistemin eBCD.

197. Pavarësisht nga përkufizimi i vendosjes në kosha në paragrafin 2(s), zhvendosja e tonit midis dy vendndodhje të ndryshme në të njëjtën fermë (transferim brenda fermës), duke përdorur një kosh transporti, nuk do të konsiderohet si vendosje në kosha për qëllimet e kërkesave të përcaktuara në seksionin E.

198. Gjatë transferimeve brenda fermës, rigrupimi i peshqve sipas origjinës dhe të njëjtit JFO, mund të bëhet i autorizuar nga autoriteti kompetent i CPC-së së fermës, duke siguruar gjurmueshmërinë, siç përcaktohet në paragrafin 5 të rekomandimit 18-13, dhe zbatueshmëria e normave të rritjes së SCRS-së, ruhen.

199. Autoriteti kompetent i CPC-së së fermës dhe operatori i fermës do të ruajnë pamjet video nga transferimet brenda fermës të ndërmarra në fermat

nën juridiksionin e tyre për një minimum prej 3 vjetësh dhe të mbajnë informacion për aq kohë sa është e nevojshme për qëllime të zbatimit.

Sasia e mbetur (tepricë e mbartur)

200. Përpara fillimit të sezonit të ardhshëm të peshkimit me koshilok dhe kurth, autoriteti i CPC-ve të fermave kompetente do të vlerësojë tërësisht tonin e gjallë të mbartur (mbetur) në fermat nën juridiksionin e saj. Për këtë qëllim, toni i gjallë në fjalë do të transferohet në një kosh bosh dhe monitorohet duke përdorur kamera/at e kontrollit për të përcaktuar numrin dhe peshën e peshkut të transferuar.

201. Si përjashtim, mbartja e tonit nga vitet dhe koshat ku nuk ka pasur vjelje do të kontrollohet çdo vit, duke zbatuar procedurën e kontrollit të rastësishëm të përmendur në paragrafët 208 deri në 215.

202. Toni i gjallë i mbartur do të vendoset në koshat të veçantë ose seri koshash në fermë, në bazën e vitit të zënies dhe JFO/të njëjtin kurth sipas CPC-së së origjinës.

203. Autoriteti kompetent i CPC-së së fermës do të sigurojë që pamjet video të kamerës së kontrollit për vlerësimin e transferimeve të mbartura janë në përputhje me kërkesat përkatëse të shtojcës 8 dhe përcaktimi i numrit dhe i peshës së peshkut të bartur është në përputhje me shtojcën 9, pika 1, të këtij rekomandimi.

204. Derisa SCRS të zhvillojë një algoritëm për të kthyer gjatësinë në peshë për peshqit e fermës dhe/ose të kultivuar, përcaktimi i peshës së peshkut të transportuar do të vlerësohet duke përdorur rritjen në tabelat më të përditësuar të prodhuara nga SCRS-ja.

205. Një ndryshim sipas numrit të individëve të tonit ndërmjet numrit që rezulton nga vlerësimi i mbartjes dhe numri i pritur pas vjeljes do të hetohen siç duhet nga autoriteti kompetent i CPC-së së fermës dhe i regjistruar në sistemin eBCD. Në rastin e sasisë së tepërt, autoriteti kompetent i CPC-së e fermës do të urdhërojë lirimin e numrit përkatës të peshqve. Operacioni i lirimit do të kryhet në përputhje me shtojcën 10. Kompensimi për diferencat ndërmjet koshave në fermë nuk do të lejohen. Një marzh gabimi deri në 5% ndërmjet numrit të individët që rezultojnë nga vlerësimi i mbartjes dhe numri i pritshëm në kosha, mund të lejohet nga autoriteti kompetent i CPC-së. Kjo përqindje do të rishikohet, sipas rastit, nga IMM-ja më së voni deri në vitin 2023. Komisioni do të shqyrtojë rishikimin e përqindjes bazuar në rekomandim nga IMM.

206. Autoriteti kompetent i CPC-së së fermës do të mbajë pamjet video dhe të gjithë dokumentacionin përkatës nga vlerësimet e mbartjes të kryera në fermat nën juridiksionin e tyre për të paktën 3 vjet, dhe ruan këtë informacion për aq kohë sa është e nevojshme për qëllime të zbatueshmerie.

Deklarate e sasisë se mbartur *(Carry-over declaration)*

207. CPC-të e fermave do të plotësojnë dhe transmetojnë, si një aneks i planit të rishikuar të menaxhimit të veprimtarive në fermë, një deklaratën vjetore të mbartjes në sekretariatin e ICCAT-it brenda 15 ditëve pas përfundimit të operacionit të vlerësimit. Një deklaratë e tillë përfshin:

a) flamurin CPC;

b) emrin dhe numrin ICCAT-it të fermës;

c) viti i zënies;

d) referencat e eBCD që korrespondojnë me zëniet e mbartura;

e) numrat e koshave;

f) sasitë (të shprehura në kg) dhe numri i peshkut të transportuar;

g) pesha mesatare;

h) informacion për secilin prej operacioneve të vlerësimit të mbartjes: data dhe numrat e koshit;

i) informacion mbi transferimet e mëparshme brenda fermës, kur është e aplikueshme.

Raporti i kamerës stereoskopike, kur është e aplikueshme, i bashkëngjitet deklaratës së mbartjes.

Kontrollet rastësore

208. Autoriteti kompetent i CPC-së së fermës do të kryejë kontrolle të rastësishme në fermat nën juridiksionin e tyre. Minimumi i kontrolleve të rastësishme, sipas parashikimeve të paragrafit 209, do të kryhen në ferma ndërmjet kohës së përfundimit të operacioneve të vendosjes në kosha nga koshi i parë i vitit pasardhës. Këto kontrolle përfshijnë transferimet e detyrueshme të të gjithë peshqve nga koshat e fermës në koshat e tjerë të fermës, në mënyrë që numri i individëve të tonit të mund të jetë të numëruara me anë të regjistrimit të videove të kontrollit.

209. Çdo CPC e fermës do të vendosë një numër minimal kontrollesh të rastësishme që do të kryhen në secilën fermë nën sovranitetin e saj. Numri i kontrolleve të rastësishme duhet të mbulojë të

paktën 10% të numrit të koshave në secilin fermë pas përfundimit të operacioneve të mbylljes, gjithmonë duke përfshirë të paktën një kontroll për fermë dhe të rrumbullakosura lart aty ku duhet. Përzgjedhja e koshave që do të kontrollohen do të bazohet në analizën e rrezikut. Planifikimi për kontrollet e rastësishme që do të kryhen duhet të pasqyrohet në planin e kontrollit të CPC-së të përmendur në paragrafin 10 të këtij Rekomandimi.

210. Edhe pse nuk kërkohet, ferma/t në fjalë mund të informohen nga autoriteti kompetent i CPC-së së fermës me një njoftim paraprak maksimal prej dy ditësh kalendarike se kontrolli/et i rastësishme do të bëhet. Koshi/at e përzgjedhur do t'i komunikohen operatorit të fermës vetëm nga autoriteti kompetent i CPC-së së fermës me mbërritjen në fermën përkatëse.

211. Kur jepet njoftim paraprak, operatorët e fermave duhet të sigurojnë që të gjitha mjetet janë në dispozicion për këtë kontroll të rastësishëm që mund të kryhen nga autoriteti kompetent i CPC-së së fermës në çdo kohë dhe në çdo kosh në fermë. Nëse nuk jepet njoftim paraprak, operatorët e fermave duhet të ndërmarrin të gjithë hapat e duhur për të lehtësuar operacionet e kontrollit të rastësishëm.

212. Autoriteti kompetent CPC i fermës do të përpiqet të zvogëlojë afatin kohor ndërmjet njoftimit për kontroll të rastësishëm dhe kohës kur kryhet operacioni i kontrollit. Autoriteti kompetent CPC-së së fermës do të sigurojë që janë marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që operatori nuk ka mundësi për të manipuluar koshat në fjalë derisa të bëhet kontrolli i rastësishëm.

213. Pas kontrollit të rastësishëm, çdo ndryshim midis numrit të tonit që përcaktohet nga kontrollet e rastësishme dhe numrit që pritet të jetë i pranishëm në kosh do të hetohen siç duhet dhe të regjistrohen në sistemin eBCD. Në rastin e numrit të tepërt, autoriteti kompetent i CPC-së së fermës do të urdhërojë lëshimin e numrave përkatës. Operacioni i lëshimit do të kryhet në përputhje me shtojcën 10. Kompensimi për diferencat ndërmjet koshave të ndryshëm në fermë nuk duhet të lejohet. Një marzh gabimi prej 5% midis numrit të individëve që rezulton nga transferimi i kontrollit dhe numri i pritshëm në kosha, mund të lejohet nga autoriteti kompetent i CPC-së. Kjo përqindja do të rishikohet, sipas rastit, nga IMM-ja më së voni deri në vitin 2023. Komisioni do të konsideroni rishikimin e përqindjes bazuar në rekomandimin e IMM-së.

214. Autoriteti kompetent CPC i fermës do të mbajë të gjitha pamjet video nga kontrollet e rastësishme të ndërmarra në fermat nën juridiksionin e tyre për një minimum prej 3 vjetësh dhe ruajnë këtë informacion për aq kohë sa është e nevojshme për qëllime të zbatimit.

215. Rezultatet e kontrolleve të rastësishme do t'i komunikohen sekretariatit të ICCAT-it përpara fillimit të sezonit të ri të peshkimit me koshilok, e zbatueshëm për çdo CPC në përputhje me paragrafin 28, për njoftim në Komitetin e Përputhshmërisë.

Transferimi ndërmjet fermave

216. Transferimi i tonit të gjallë ndërmjet dy fermave të ndryshme nuk do të bëhet pa shkresë paraprake autorizimin nga autoritetet kompetente të CPC-së dy fermave.

217. Transferimi nga koshat e fermës dhuruese në koshat e transportit duhet të jetë në përputhje me kërkesat e seksioni D (Transferimet e peshqve të gjallë), të këtij Rekomandimi, duke përfshirë një videoregjistrim për të konfirmuar numrin e individëve ton të transferuar, plotësimi i një ITD-je dhe verifikimi i operacionit nga një vëzhgues rajonal i ICCAT-it. Pavarësisht sa më sipër, në rastet kur i gjithë koshi duhet të zhvendoset në fermën marrëse, nuk do të jetë e nevojshme të regjistrohet në video operacioni dhe koshi do të transportohet i vulosur në fermën e destinacionit.

218. Mbajtja në koshave e tonit në fermën e destinacionit do t'u nënshtrohet kërkesave për operacionet e vendosjes në kosha e përcaktuara në paragrafët 156 deri në 171, duke përfshirë një regjistrim video për të konfirmuar numrin dhe peshën e tij në kosha dhe verifikimi i operimit nga një vëzhgues rajonal i ICCAT-it. Përcaktimi i peshës për peshqit e mbyllur në kosha nga një fermë tjetër, nuk do të zbatohet derisa SCRS-ja të ketë zhvilluar një algoritëm për të kthyer gjatësinë në peshë për peshqit e rritur dhe/ose të kultivuar.

PJESA IV
MASAT E KONTROLLIT

SEKTORI G
SISTEMI I MONITORIMI TË ANIJEVE (VMS)

219. CPC-të do të zbatojnë një Sistem Monitorimi të Anijeve (VMS) për anijet e tyre të peshkimit me një gjatësi të barabartë ose më shumë se 15 m të përmendura në paragrafin 2(a) të këtij Rekomandimi, në përputhje me Rekomandim nga ICCAT-i në lidhje me standardet minimale për sistemet e monitorimit të anijeve në zonat e konventës ICCAT (rek. 18-10), duke përfshirë detyrimin për të transmetuar të paktën një herë në orë për çantë anije me koshilok dhe të paktën një herë në dy orë për të gjitha anijet e tjera të peshkimit.

220. Pavarësisht nga sa më sipër, të gjitha anijet tërheqëse të përdorura për transportin e tonit të gjallë, pavarësisht nga gjatësia e tyre, instalojnë dhe përdorin VMS, në përputhje me rek. 18-10 dhe transmetojnë mesazhe të paktën një herë në orë.

221. Transmetimi i të dhënave VMS në sekretariatin e ICCAT-it nga çdo anije peshkimi e autorizuar që i nënshtrohet VMS-së, sipas këtij rekomandimi do të:

a) të fillojë të paktën 5 ditë përpara dhe të vazhdojë të paktën 5 ditë pas periudhës së autorizimit të tyre, përveç nëse anija hiqet nga listat e anijeve të autorizuara nga autoriteti kompetent i CPC-së; dhe

b) të mos ndërpritet kur anija është në port, për qëllime kontrolli, përveç rasteve kur ekziston një sistem breshëri brenda dhe jashtë portit.

222. Sekretariati ICCAT do të informojë menjëherë CPC-në e anijes për çdo vonesë ose mosmarrje të transmetimit VMS dhe do shpërndajë raporte mujore për të gjitha CPC-të me informacion specifik mbi natyrën dhe shtrirjen e këtyre vonesave. Këto raporte do të dërgohen çdo javë gjatë periudhës 1 maj deri më 30 korrik.

223. Referuar mjeteve tërheqëse gjatë transportit të tonit në një fermë, në rast të një defekti teknike të VMS-së së tij, anija tërheqëse në fjalë do të zëvendësohet nga një anije tjetër tërheqëse me një VMS plotësisht funksionale. Nëse nuk ka asnjë anije tjetër tërheqëse, do të instalohet një sistem i ri operativ VMS në bord ose përdoret nëse është instaluar tashmë, sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se 72 orë, me përjashtim të rastit të forcës madhore, që duhet t'i komunikohet sekretariatit të ICCAT-it. Ndërkohë, kapiteni ose përfaqësuesi i tij, duke filluar nga momenti kur është zbuluar dhe/ose informuar ngjarja, komunikon me autoritetet e kontrollit të CPC-së çdo 1 orë, duke përditësuar koordinatat e anijes tërheqëse me mjete të përshtatshme telekomunikacioni.

Përdorimi i të dhënave VMS për qëllime kontrolli dhe inspektimi

224. Sekretariati ICCAT do të vërë në dispozicion pa vonesë informacionin e marrë sipas këtij seksioni G për CPC-të me një prani aktive inspektimi në Atlantikun Lindor dhe Mesdhe dhe në SCRS, me kërkesën e saj.

225. Me kërkesë nga CPC-të e angazhuara në operacionet e inspektimit në det në zonën e Konventës, në përputhje me skemën e ICCAT-it të Inspektimit të Përbashkët Ndërkombëtar të përmendur në paragrafët 229 deri 232 të këtij Rekomandim, sekretariati i ICCAT duhet të vërë në dispozicion mesazhet e marra nga të gjitha anije e peshkimit, sipas *paragrafit 3 të rekomandimit nga ICCAT-i që ndryshon rekomandimin 07-08 në lidhje me formatin dhe protokollin e shkëmbimit të të dhënave në lidhje me Sistemin e Monitorimit të Anijeve (VMS) për Peshkimin e tonit në zonën e Konventës ICCAT (rek. 21-16).*

PJESA IV
MASAT E KONTROLLIT

SEKTORI H
ZBATIMI

Zbatimi

226. CPC-të marrin masat e duhura të zbatimit në lidhje me një anije peshkimi, në përputhje me ligjin e saj në rastin kur aktiviteti anijes së tij të peshkimit nuk përputhet me dispozitat e këtij Rekomandimi.

Masat duhet të jenë në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit kombëtar në mënyrë të tillë që të sigurohet që ato i privojnë ato në mënyrë efektive përgjegjës për përfitimin ekonomik që rrjedh nga cenimi i tyre pa paragjykuar ushtrimin e profesionit të tyre. Këto sanksione do të jenë, gjithashtu, në gjendje të prodhojnë rezultate proporcionale me seriozitetin e një shkeljeje të tillë, duke dekurajuar në mënyrë efektive vepra të tjera të të njëjtit lloj.

227. CPC-ja e fermës do të marrë masat e duhura të zbatimit në lidhje me një fermë, ku kanë konstatuar, në përputhje me ligjin e saj, se ferma nuk është në përputhje me dispozitat e kësaj Rekomandimi.

Në varësi të peshës së veprës penale dhe në përputhje me dispozitat përkatëse kombëtare masat e tilla mund të përfshijnë, në veçanti, pezullimin e autorizimit ose tërheqjen nga regjistri i ICCAT-it për objektet e kultivimit të tonit të krijuar në përputhje me paragrafin dhe/ose gjobat.

SEKTORI I
MASAT E TREGTIMIT

Masat e tregtimit

228. Në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas ligjit ndërkombëtar, duke eksportuar dhe duke importuar CPC do të marrë masat e nevojshme:

- të ndalojë tregtinë e brendshme, zbarkimin, importet, eksportet, vendosjen në kosha, rieksportet dhe transbordimet e tonit të Atlantikut Lindor dhe të Mesdheut që nuk shoqërohen me dokumentacionin e saktë, të plotë dhe të vërtetuar të kërkuar nga ky rekomandim, rekomandimi i ICCAT-it që ndryshon rekomandimin 18-13, duke zëvendësuar rekomandimin 11-20 mbi një program dokumentacioni i ICCAT-it për zënien e tonit (rek. 21-19) dhe rekomandimi nga ICCAT-i, duke ndryshuar rek. 21-18 mbi aplikimin e sistemit eBCD (rek. 22-16) mbi programin e dokumentimit të zënieve të tonit.

- të ndalojnë tregtinë e brendshme, importet, zbarkimet, vendosjen në kosha, përpunim, eksport, rieksportim dhe transbordimet brenda juridiksionit të tyre, të tonit të Atlantikut Lindor dhe Mesdheut i zënë nga anije peshkimi ose nga kurthe, CPC-ja e të cilëve nuk kane një kuotë ose kufi peshkimi për ato specie, sipas kushteve të masave të menaxhimit dhe ruajtjes së ICCAT-it, ose kur mundësitë e peshkimit të CPC-së janë shterur, ose kur kuotat individuale të anijeve zënëse të përmendura në paragrafin 3 janë ezauruar;

- për të ndaluar tregtinë e brendshme, importet, zbarkimet, përpunimin dhe eksportet e tonit të Atlantikut Lindor dhe Mesdheut nga fermat që nuk përputhen me dispozitat që lidhen me kultivimin të specifikuara në këtë rekomandim.

PJESA V
SKEMA E INSPEKTIMIT TË PËRBASHKËT NDËRKOMBËTAR ICCAT

229. Në kuadrin e Planit Shumëvjeçar të Menaxhimit për Tonin, secila Palë Kontraktuese bie dakord, në përputhje me nenin IX, paragrafi 3, të Konventës ICCAT, të zbatojë skemën ICCAT i Inspektimit të Përbashkët Ndërkombëtar të miratuar gjatë takimit të tij të 4-të të rregullt, mbajtur në nëntor 1975 në Madridi, i modifikuar në shtojcën 7.

230. Skema e përmendur në paragrafin 229 do të zbatohet derisa ICCAT-i të miratojë një monitorim, kontroll dhe skemën e mbikëqyrjes, e cila do të përfshijë një skemë ICCAT për inspektim të përbashkët ndërkombëtar, bazuar në rezultatet e grupit të punës për masat e integruara të monitorimit, i krijuar me rezolutën nga ICCAT për Masat e Integruara të Monitorimit (rez. 00-20).

231. Kur në çdo kohë, më shumë se 15 anije peshkimi të njërës Palë Kontraktuese janë të angazhuara në aktivitetin e peshkimit të tonit në Atlantikun Lindor dhe në Mesdhe, zona e Konventës, Pala Kontraktuese në bazë të vlerësimit të rrezikut do të ketë një anije inspektimi në zonën e Konventës, ose do të bashkëpunojnë me një Palë tjetër Kontraktuese për të operuar bashkërisht një anije inspektimi. Nëse një Palë Kontraktuese nuk vendos anijen e saj të inspektimit ose nuk kryen operacione të përbashkëta, Pala Kontraktuese do të raportojë rezultatin e vlerësimit të rrezikut dhe masat e tij alternative në planin e tij të inspektimit të përmendur në paragrafi 10.

232. Në rastet kur duhet të merren masa për forcimin e ligjit si rezultat i një inspektimi, kompetencat e inspektorëve të Palës Kontraktuese të anijes së peshkimit, fermës ose kurthit që i nënshtrohet inspektimit do të mbizotërojnë gjithmonë në territorin e tyre, në ujërat e tyre në juridiksion dhe në inspektimin në bord të tyre.

PJESA VI
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Disponueshmëria e të dhënave për SCRS-në

233. Sekretariati ICCAT do të vërë në dispozicion të SCRS-së të gjitha të dhënat e marra në përputhje me këtë Rekomandim. Të gjitha të dhënat do të trajtohen në mënyrë konfidenciale.

Klauzola e rishikimit

234. Në përputhje me paragrafin 11, ICCAT-i do të mbajë një mbledhje ndërsesionale të panelit 2 çdo vit në mars, me qëllim që:

a) të rishikojë, dhe nëse është e përshtatshme, të miratojë planet vjetore të peshkimit, menaxhimin e kapaciteteve të peshkimit, kultivimin dhe planet e inspektimit të dërguara në ICCAT, sipas paragrafit 10 të këtij Rekomandimi;

b) të diskutojë çdo dyshim të mundshëm në lidhje me interpretimin e këtij Rekomandimi dhe, sipas rastit, propozon projektamendamentet e tij për shqyrtim në mbledhjen vjetore.

Vlerësimi

235. Të gjitha CPC-të, me kërkesë të Sekretariatit të ICCAT-it, duhet të paraqesin, rregulloret dhe dokumentet e tjera të ndërlidhura të miratuara prej tyre për zbatimin e këtij Rekomandimi. Për të pasur një transparencë më të madhe në zbatimin e këtij Rekomandimi, Sekretariati i ICCAT-it do të përpunojë çdo dy vjet një raport mbi zbatimin e këtij Rekomandimi.

Përjashtimet për CPC-të për detyrimin e zbarkimit të tonit

236. Dispozitat në këtë Rekomandim që ndalojnë mbajtjen në bord, transbordimin, transferimin, zbarkimin, transportin, ruajtjen, shitjen, ekspozimin ose ofrimin për shitje të tonit nuk zbatohen për CPC-në me një legjislacion vendës të prezantuar përpara vitit 2013 që kërkon që të gjithë peshqit e ngordhur të zbarkohen, me kusht që vlera e këtij peshku të konfiskohet për të mos lejuar që peshkatarët të tërheqin ndonjë fitimi tregtar nga peshq të tillë. CPC-të përkatëse do të marrin masat e nevojshme për të parandaluar që peshku i konfiskuar të eksportohet në CPC të tjera. Sasitë e tonit që tejkalojnë kuotën e alokuar për CPC, në përputhje me këtë përjashtim, do të zbriten vitin e ardhshëm nga kuota CPC në përputhje me paragrafin 9.

Periudha kalimtare për zbatimin e vulosjes së koshave të tonit

237. Për zbatimin e masave lidhur me vulosjen e koshave të peshkut të tonit të përcaktuara në paragrafët 128, 159, 164, 217, aneksi 4, aneksi 6 dhe aneksi 14, një periudhë kalimtare deri në vitin 2023 mund t'u jepet atyre CPC-ve që tregojnë në planet e tyre të peshkimit një nevojë të tillë për të siguruar siç duhet zbatimin e masave. Një vlerësim i zbatimit të kësaj mase gjatë sezonit të peshkimit 2022 do të kryhet nga CPC-të e prekura, me synimin për të diskutuar mbi zbatimin dhe rishikimin ose përditësimin e mundshëm, në takimin ndërsektorial të panelit 2 të marsit 2023 dhe, nëse bie dakord nga Komisioni, takimi i 16-të i grupit të punës të IMM-së më 2023-shin.

Shfuqizimet

Ky rekomandim:

238. Shfuqizon dhe zëvendëson rekomandimin e ICCAT-it që ndryshon rekomandimin 19-04 që ndryshon rekomandimin 18-02 që përcakton një plan shumëvjeçar menaxhimi për tonin në Atlantikun Lindor dhe në Mesdhe (rec. 21-08);

SHTOJCA 1
KUSHTET SPECIFIKE QË APLIKOHEN PËR ANIJET E PESHKIMIT TË PARASHIKUAR NË PARAGRAFIN 34

1. CPC-ja duhet të kufizojnë:

- Numrin maksimal të barkave me grepa *(baitboat dhe trolling boat)* të autorizuara për të peshkuar në mënyrë aktive tonin me numrin e anijeve që kanë marrë pjesë në peshkimin direkt për tonin gjatë vitit 2006.

- Numrin maksimal të anijeve të saj të peshkimit artizanal të autorizuar për të peshkuar në mënyrë aktive tonin në Mesdhe me numrin e anijeve që kanë marrë pjesë në peshkimin e tonit më 2008-n.

- Numrin maksimal të anijeve të peshkimit të autorizuara për të peshkuar në mënyrë aktive tonin në detin Adriatik me numrin e anijeve që kanë marrë pjesë në peshkimin e tonit gjatë vitit 2008. Çdo CPC do t'i alokojë kuota individuale anijeve në fjalë.

CPC-ja do të lëshojë autorizime specifike për anijet e cilësuara në paragrafin 1 të kësaj shtojce. Këto anije duhet të tregohen në listën e anijeve të peshkimit të treguar në paragrafin 48(a) të këtij rekomandimi, atëherë kur zbatohen kushtet për ndryshim.

2. Çdo CPC do të alokojë jo më shumë se 7% të kuotave të saj për tonin për barkat me grepa *(baitboat dhe trolling boat).*

3. Çdo CPC mund të alokojë jo më shumë se 2% të kuotave të saj për tonin për peshkimin artizanal bregdetar të peshkut të gjallë në Mesdhe.

Çdo CPC mund të alokojë jo më shumë se 90% të kuotave të saj për anijet peshkuese në Adriatik për qëllime kultivimi.

4. CPC-të, anijet me grepa, linje grepash, grepa dore dhe grepa tërheqës të të cilave janë të autorizuara të peshkojnë tonin në Atlantikun Lindor dhe në Detin Mesdhe duhet të përcaktojnë kërkesat për shënjimin e bishtit si më poshtë:

a) Shënjimi i bishtit duhet të fiksohet në çdo ton të peshkuar menjëherë pas nxjerrjesh nga uji

b) Çdo shenje e bishtit duhet të ketë një numër unik identifikimi që duhet të përfshihet në dokumentin e zënies dhe shkruar lexueshëm në pjesën e jashtme të çdo paketimi që përmban ton.

SHTOJCA **2**
KËRKESAT E *LOGBOOK*-ut

A. Anijet e peshkimit

Specifikimet minimale për librin e anijes

1. Libri i anijes duhet t'i ketë faqet e numëruara;

2. Libri i anijes duhet të plotësohet çdo ditë (mesnatë) ose përpara mbërritjes në port;

3. Libri i anijes duhet të plotësohet në rastet e inspektimit në det;

4. Njëra nga kopjet e faqeve duhet të mbetet e ngjitur në librin e anijes;

5. Libri i anijes duhet të mbahet në bord në mënyrë që të mbulojë aktivitetin e kryer gjatë një viti.

Informacionet minimale standarde në librin e anijes

1. Emri dhe adresa e kapitenit;

2. Data dhe porti i nisjes, data dhe porti i mbërritjes;

3. Emri i anijes, numri i regjistrit, numri i ICCAT, sinjali i thirrjes ndërkombëtare në radio dhe numri IMO (nëse ka).

4. Veglat e peshkimit:

a) Lloji i kodit sipas FAO;

b) Madhësia (gjatësia, madhësia e syzeve, numri i grepave ...).

5. Aktiviteti në det me një rresht (minimumi) për ditë peshkimi, duke dhënë:

a) Aktiviteti (peshkim, lundrim...);

b) Pozicioni: pozicioni ekzakt ditor (në gradë dhe minuta), regjistruar për çdo aktivitet peshkimi ose në mesditë kur nuk ka pasur peshkim gjatë ditës;

c) Regjistrimi i zënieve që përfshin:

i. kodin e FAOs;

ii. pesha e rrumbullakosur (RWT) në kilogram për ditë;

iii. numri i individëve për ditë.

Për anijet e peshkimit me rrethim (koshilok) kjo duhet të regjistrohet për çdo operacion peshkimi duke përfshirë edhe kthimet bosh.

6. Sigla e kapitenit;

7. Mënyra e matjes së peshës: vlerësim, peshimi në bord, numërimi;

8. Libri i anijes mbahet në peshë të gjallë ekuivalente peshku dhe përmendet faktori i konversionit i përdorur në vlerësim.

Minimumi i informacionit në librin e anijes në rast zbarkimi ose transbordimi

1. Data dhe porti i zbarkimit, transbordimit/ transferimit;

2. Produkti:

a) Speciet dhe paraqitja sipas kodit FAO;

b) Numri i individëve apo i kutive dhe sasia në kilogram.

3. Sigla e kapitenit apo e agjentit të anijes

4. Në rastin e një transbordimi, emrin e anijes marrëse, flamurin e saj dhe numrin ICCAT.

Minimumi i informacionit për librin e anijes në rastin e transferimit në kosha:

1. Data, koha dhe vendi (gjatësi dhe gjerësi gjeografike) i transferimit.

2. Produktet:

a) speciet të identifikuara sipas kodit FAO;

b) numri i peshqve dhe sasia në kg e transferuar në kosha;

3. Emri i anijes transportuese, flamuri i saj dhe numri ICCAT;

4. Emri i fermës ku shkon dhe numri i saj ICCAT;

5. Në rast të operacioneve të përbashkëta të peshkimit (JFO) si shtesë e informacionit të dhënë në pikat 1 deri 4, kapiteni duhet të regjistrojë në librin e tij të anijes:

a) për sa i përket anijes peshkuese që kalon peshkun në kosha:

- sasinë e zënieve të marra në bord;
- shuma e zënieve të numëruara kundrejt kuotës individuale;
- emrat e anijeve të tjera të përfshirë në JFO.

b) për sa u përket anijeve të tjera peshkuese që nuk përfshihen në transferimin e peshkut:

- emrin e anijeve të tjera të përfshira në JFO, sinjalet e radios së thirrjes ndërkombëtare të tyre dhe numrat e ICCAT-it;
- që asnjë zënie nuk është marrë në bord ose është transferuar në kosha;

- shuma e zënieve të numëruara kundrejt kuotave të tyre individuale;

- emrin dhe numrin ICCAT të anijes peshkuese të përmendur në "a'.

B. Anijet rimorkiator (tërheqëse)

1. Kapitenët e anijeve rimorkiator regjistrojnë në ditarin e tyre ditor, datën, kohën dhe pozicionin e transferimit, sasitë e transferuara (numri i peshqve dhe sasia në kg), numri i koshit, si dhe emri i anijes peshkuese, flamuri dhe numrin ICCAT, emri i anijeve të tjera të përfshira dhe numri i tyre ICCAT, ferma e destinacionit dhe numrin ICCAT të saj, si dhe numrin e deklaratës së transferimit të ICCAT-it.

2. Transferimet e mëtejshme në anijet ndihmëse ose anijet e tjera tërheqëse duhet të raportohen duke përfshirë të njëjtin informacion si në pikën 1, si dhe emrin e anijes ndihmëse ose të mjetit tërheqës, flamurin dhe numrin ICCAT dhe numrin e deklaratës së transferimit të ICCAT.

3. Libri i anijes përmban detajet e të gjitha transfertave të kryera gjatë sezonit të peshkimit. Libri i anijes duhet të mbahet në bordin dhe të jetë i arritshëm në çdo kohë për qëllime kontrolli.

C. Anijet ndihmëse

1. Kapitenët e anijeve ndihmëse regjistrojnë çdo ditë aktivitetet e tyre në librin e tyre, duke përfshirë datën, kohën dhe pozicionet, sasitë e tonit të marra në bord dhe anijen e peshkimit, fermën ose emrin e kurthit që veprojnë në bashkëpunim.

2. Libri i anijes duhet të përmbajë detajet e të gjitha aktiviteteve të kryera gjatë sezonit të peshkimit. Libri i anijes duhet të mbahet në bord dhe të jetë i arritshëm në çdo kohë për qëllime kontrolli.

D. Anijet përpunuese

1. Kapitenët e anijeve përpunuese duhet të raportojnë në librin e tyre të anijes, datën, kohën dhe pozicionin e veprimtarive dhe sasitë e transborduara, numrin dhe peshën e tonit të marra nga ferma, kurthe ose anije peshkuese aty ku është e aplikueshme. Ata, gjithashtu, duhet të raportojnë emrat dhe numrat ICCAT të atyre fermave, kurtheve ose anijeve të peshkimit.

2. Kapitenët e anijeve përpunuese duhet të mbajnë një libër të përpunimit ditor, duke specifikuar peshën e rrumbullakosur dhe numrin e peshqve të transferuar ose të transboduar, faktorin e konvertimit të përdorur, peshat dhe sasitë sipas prezantimit të produktit.

3. Kapitenët e anijeve përpunuese duhet të mbajnë një plan depozitimi që tregon vendndodhjen dhe sasitë e secilës specie dhe paraqitjen.

4. Libri i anijes duhet të përmbajë detajet e të gjitha transbordimeve të kryera gjatë sezonit të peshkimit. Libri ditori i anijes, libri i përpunimit, plani i depozitimit, origjinali i deklaratave të transbordimeve ICCAT duhet të mbahen në bordin dhe të jenë të arritshme në çdo kohë për qëllime kontrolli.

SHTOJCA **3**

Nr. i dokumentit DEKLARATA E ICCAT-it PËR TRANSFERIMIN/TRANSBORDIMIN

Anija rimorkiuese/mbajtëse *(tug/carrier vessel)*	**Anija e peshkimit**	**Qendra e kultivimit**	**Kurthi i tonit**
Emri i anijes dhe sinjali i thirrjes në radio Flamuri: Nr. i autorizimit të shtetit flamur: Nr. i Regjistrit Kombëtar Nr. i Regjistrit ICCAT Nr. IMO	Emri i anijes dhe sinjali i thirrjes në radio Flamuri: Nr. i autorizimit të shtetit flamur: Nr. i Regjistrit Kombëtar Nr. i Regjistrit ICCAT Shenjat identifikuese të jashtme Nr. i faqes së librit të anijes së peshkimit	Emri Numri i Regjistrit ICCAT	Emri Numri i Regjistrit ICCAT

Dita, muaji, ora, viti |2_|0_|__|__| emri i kapitenit/përdoruesit të kurthit: emri i kapitenit të rimorkiuesit: VENDI I TRANSFERIMIT
Nisja |__|__| |__|__| |__|__| nga |_____|
Kthimi |__|__| |__|__| |__|__| në |_____| firma: firma:
Transf./Transh. |__|__| |__|__| |__|__| |_____|
Për transferimin, trego peshën në kg ose njësi të përdorura (p.sh. kuti, kosha) dhe peshën e zbarkuar në kg të kësaj njësie: |___| kilogram.
Në rast transferte peshku të gjallë trego numrin e njësive dhe peshën e gjallë

Porti	**Deti: gjer. gjat.**		**Llojet**	**Numri i njësive të peshqve**	**Lloji i prodhimit i gjallë**	**Lloji i prodhimit i plotë**	**Lloji i prodhimit i pastruar**	**Lloji i prodhimit pa kokë**	**Lloji i prodhimit fileto**	**Lloji i prodhimit**	Transferim/të mëtejshme
											Data: Vendi/pozicioni: Nr. CP i autorizimit. Nënshkrimi i kapitenit të anijes transferuese: Emri i anijes marrëse: Flamuri Nr. i regjistrit ICCAT Nr. IMO Nënshkrimi i kapitenit Data: Vendi/pozicioni: Nr. CP i autorizimit. Nënshkrimi i kapitenit të anijes transferuese: Emri i anijes marrëse: Flamuri Nr. Regjistri ICCAT Nr. IMO Nënshkrimi i kapitenit

Nënshkrimi i vëzhguesit të ICCAT-it (nëse është e mundur). Detyrime në raste transferimi:
1. Origjinali i deklaratës transferimit duhet t'i jepen anijes marrëse (tërheqëse/përpunuese/transporti).
2. Kopja e deklaratës së transferimit duhet të mbahet nga anije peshkuese ose kurthin korrespondues.
3. Aktivitete të mëtejshme transferimi do të autorizohet nga CP-ja, e cila autorizon anije për të ushtruar aktivitetin.
4. Origjinali i deklaratës së transferimit duhet të mbahet nga anija marrëse, e cila mban peshkun, deri në qendrën e kultivimit ose të vendit të zbarkimit.
5. Aktivitetet e transferimit do të regjistrohen në librin e çdo anijeje të përfshirë në këtë aktivitet.

SHTOJCA 4

<table>
<tr><td colspan="2">Nr. i dokumentit</td><td colspan="2">Deklarata e transferimit ICCAT</td></tr>
<tr><td colspan="4">1.TRANSFERIMI I BFT I GJALLË I DESTINUAR PËR NË FERMË</td></tr>
<tr><td rowspan="3">Emri i anijes së peshkimit:
Sinjali i thirrjes:
Flamuri:
Nr. i regjistrit ICCAT:
Identifikimi i jashtëm:
Nr. i autorizimit të transferimit:
Logbook nr.:
JFO nr.:
eBCD nr.:</td><td rowspan="3">Emri i fermës:

Nr. i regjistrit ICCAT:

Emri i fermës dhënëse (1):

Nr. i regjistrit ICCAT:</td><td>Emri i anijes së parë tërheqëse:
Flamuri:
Nr. i regjistrit ICCAT:
Identifikimi i jashtëm:
Numri i koshit transportues:</td><td>Emri i fermës së destinacionit:

Nr. i regjistrit ICCAT:</td></tr>
<tr><td>Emri i anijes së dytë tërheqëse:
Flamuri:
Nr. i regjistrit ICCAT:
Identifikimi i jashtëm:
Numri i koshit transportues:</td><td>Emri i fermës së destinacionit:

Nr. i regjistrit ICCAT:</td></tr>
<tr><td>Emri i anijes së tretë tërheqëse:
Flamuri:
Nr. i regjistrit ICCAT:
Identifikimi i jashtëm:
Numri i koshit transportues:</td><td>Emri i fermës së destinacionit:

Nr. i regjistrit ICCAT:</td></tr>
<tr><td colspan="4">2.INFORMACIONI PËR TRANSFERIMIN E PARË</td></tr>
<tr><td colspan="2">Datë: __.___._____</td><td colspan="2">Vendi ose pozicioni: Porti: Gjatësi.: Gjerësi:</td></tr>
<tr><td>Nr. i individëve dhe pesha e vlerësuar (kg) në koshin e parë (4):
Transferimi i parë:
Transferim vullnetar:
Transferim kontrolli:
BFT të ngordhur gjatë transferimit (5)</td><td>Nr. i individëve dhe pesha e vlerësuar (kg) në koshin e dytë (4):
Transferimi i parë:
Transferim vullnetar:
Transferim kontrolli:
BFT të ngordhur gjatë transferimit (5)</td><td colspan="2">Nr. i individëve dhe pesha e vlerësuar (kg) në koshin e tretë (4):
Transferimi i parë:
Transferim vullnetar:
Transferim kontrolli:
BFT të ngordhur gjatë transferimit (5)</td></tr>
<tr><td colspan="2">Emri dhe firma e kapitenit të anijes/operatorit të kurthit/operatorit të fermës:</td><td>Kapiteni i anijes marrëse, emri dhe firma:
Anija e parë marrëse:
Anija e dyte marrëse:
Anija e tretë marrëse:</td><td>Emri i observatorit, nr. ICCAT dhe firma:</td></tr>
<tr><td colspan="2">Prani e observatorit: Po/JO
Numri i individëve i vlerësuar nga observatori rajonal:
Numri i vulave (6):</td><td>Arsyet e mos dakordësisë:</td><td>Rregullat ose procedurat që nuk janë respektuar:</td></tr>
<tr><td colspan="4">3.TRANSFERIM I MËTEJSHËM (7)</td></tr>
</table>

TRANSFERIM I MËTEJSHËM 1			
Datë: __.___._____ Numri ITD		Vendi ose pozicioni: Porti: Gjatësi.: Gjerësi:	
Emri i anijes tërheqëse dhuruese: Emri i anijes tërheqëse dhuruese:	Sinjali i thirrjes: Sinjali i thirrjes:	Flamuri: Flamuri:	Nr. i regjistrit ICCAT: Nr. i regjistrit ICCAT:
Nr. i autorizimit të transferimit:	Identifikimi i jashtëm:	Nr. koshi dhënës: Nr. koshi marrës:	Emri dhe firma e kapitenit të anijes dhënëse: Emri dhe firma e kapitenit të anijes marrëse:
Nr. i individëve dhe pesha e vlerësuar (kg): Trensferime të mëtejshme Transferime vullnetare Transferime kontrolli Ne rastet e transferimeve vullnetare ose të kontrollit: I.Informacioni mbi anijen tërheqëse marrëse: Emri Flamuri Nr. i regjistrit ICCAT Identifikimi i jashtëm Nr. i koshit transportues		Nr. BFT të ngordhur gjatë transferimit:	
TRANSFERIM I MËTEJSHËM 2			
Datë: __.___._____ Numri ITD		Vendi ose pozicioni: Porti: Gjatësi.: Gjerësi:	
Emri i anijes tërheqëse dhuruese: Emri i anijes tërheqëse dhuruese:	Sinjali i thirrjes: Sinjali i thirrjes:	Flamuri: Flamuri:	Nr. i regjistrit ICCAT: Nr. i regjistrit ICCAT:
Nr. i autorizimit të transferimit:	Identifikimi i jashtëm:	Nr. koshi dhënës: Nr. koshi marres:	Emri dhe firma e kapitenit të anijes dhënëse: Emri dhe firma e kapitenit të anijes marrëse:
Nr. i individëve dhe pesha e vlerësuar (kg): Transferime të mëtejshme Transferime vullnetare Transferime kontrolli Në rastet e transferimeve vullnetare ose të kontrollit: I.Informacioni mbi anijen tërheqëse marrëse: Emri Flamuri Nr. i regjistrit ICCAT Identifikimi i jashtëm I.Nr. i koshit transportues		Nr. BFT të ngordhur gjatë transferimit:	

<table>
<tr><td colspan="4">TRANSFERIM I MËTEJSHËM 3</td></tr>
<tr><td colspan="2">Datë: __.___._____
Numri ITD .....</td><td colspan="2">Vendi ose pozicioni: Porti: Gjatësi.: Gjerësi:</td></tr>
<tr><td>Emri i anijes tërheqëse dhuruese:

Emri i anijes tërheqëse dhuruese:</td><td>Sinjali i thirrjes:

Sinjali i thirrjes:</td><td>Flamuri:

Flamuri:</td><td>Nr. i regjistrit ICCAT:

Nr. i regjistrit ICCAT:</td></tr>
<tr><td>Nr. Autorizimit të transferimit:</td><td>Identifikimi i jashtëm:</td><td>Nr. koshi dhënës:

Nr. koshi marres:</td><td>Emri dhe firma e kapitenit të anijes dhënëse:

Emri dhe firma e kapitenit të anijes marrëse:</td></tr>
<tr><td colspan="2">Nr. i individëve dhe pesha e vlerësuar (kg):
Transferime të mëtejshme
Transferime vullnetare
Transferime kontrolli
Ne rastet e transferimeve vullnetare ose të kontrollit:
I.Informacioni mbi anijen tërheqëse marrëse:
Emri
Flamuri
Nr. regjistri ICCAT
Identifikimi i jashtëm
Nr. i koshit transportues</td><td colspan="2">Nr. BFT të ngordhur gjatë transferimit:</td></tr>
</table>

1) Plotësohet në rast transferimi midis dy fermave të ndryshme.

2) Plotësohet në rast se zëniet transferohen në më shumë se një kosh transporti.

3) Plotësohet në rast se koshat e transportit janë të destinuara në më shumë se një fermë.

4) Numri i individëve dhe pesha e vlerësuar nga operatori donator për transfertën që konsiderohet e vlefshme. Në rast se operacioni duhet të përsëritet, tregoni si N/A në rreshtin përkatës (p.sh. nëse transferimi i parë dhe transferimi vullnetar nuk ofruan një video të përshtatshme: Transferimi i parë: N/A, transferimi vullnetar: N/A, kontrolli transferimi: 1030 copë, 123,600 kg).

5) Numri i individëve që kanë ngordhur dhe pesha e vlerësuar

6) Të plotësohet nga vëzhguesi rajonal i ICCAT-it, në rast se koshi i transportit do të vuloset në përputhje me paragrafin 128 dhe aneksin 14.

7) Të plotësohet nga operatori dhurues për secilën prej transferimeve ndërmjet anijeve tërheqëse, të cilat bëhen pas transferimit të

SHTOJCA **5**
AKTIVITETE TË PËRBASHKËTA PESHKIMI

Shteti flamur	***Emri i anijes***	***Nr. ICCAT***	***Kohëzgjatja e aktivitetit***	***Identiteti i operatorëve***	***Kuotat individuale të anijeve***	***Çelësi i alokimit për anije***	***Destinacioni për në fermat e majmërisë e të rritjes***	
							CPC	***Nr. ICCAT***

Data .....
Certifikimi i shtetit flamur .....

SHTOJCA 6
PROGRAMET E VËZHGUESVE

Programi i vëzhguesit CPC

1. Detyrat e vëzhguesit të CPC-së do të jenë, në përgjithësi, të monitorojnë përputhshmërinë me këtë rekomandim të anijeve të peshkimit dhe kurtheve.

2. Kur vendoset në bordin e një anijeje peshkuese, vëzhguesi i CPC-së regjistron dhe raporton mbi aktivitetin e peshkimit, i cili do të përfshijë, ndër të tjera, sa vijon:

i. vlerësimin e tyre për numrin dhe peshën e të tonit të peshkuar (përfshirë zënien e rastësishme);

ii. mënyrën e regjistrimit të peshkut, si i mbajtur në bord, i hedhur i ngordhur ose i lëshuar i gjallë;

iii. zona e peshkimit sipas gjerësisë dhe gjatësisë;

iv. masa e përpjekjes *(efforts)* (p.sh. numri i rrethimeve, numri i grepave etj.), siç përcaktohet në manualin e ICCAT-it për mjetet e ndryshme të peshkimit;

v. datën e zënies;

vi. të verifikojë konsistencën e shënimeve të bëra në *logbook* me vlerësimin e tij të zënies;

3. Kur vendoset në një anije tërheqëse:

a) në rast të një transferimi të mëtejshëm që përfshin lëvizjen e peshkut midis dy koshave të transportit:

i. pa vonesë, analizon pamjet video të transferimit të mëtejshëm në fjalë, për të vlerësuar numrin e individëve që janë transferuar,

ii. t'i komunikojë menjëherë autoritetit kompetent të CPC-së të anijes tërheqëse dhuruese vëzhgimet e tij/saj, duke përfshirë numrin e individëve të vlerësuar nga vëzhguesi i CPC-së dhe numrin përkatës të raportuar në ITD nga kapiteni i anijes tërheqëse dhuruese; dhe

iii. përfshijë rezultatet e analizës së tij në raportin e tij të vëzhguesit drejtuar autoritetit kompetent të CPC-së të anijes tërheqëse dhuruese;

b) regjistron dhe raporton në raportin e tij të vëzhguesit të gjithë tonin e ngordhur gjatë udhëtimit të transportit;

c) të shikojë dhe regjistrojë anijet që mund të peshkojnë në kundërshtim me masat e ruajtjes së ICCAT, dhe

d) t'i komunikojë raportin e vëzhguesit autoritetit kompetent të CPC-së të anijes tërheqëse dhuruese pa vonesë në fund të udhëtimit të tërheqjes.

4. Kur vendoset në një kurth për zënien e tonit:

a) verifikon autorizimin e vjeljes të lëshuar nga autoriteti kompetent i CPC-së së kurthit;

b) vërteton informacionin në deklaratat e përpunimit dhe/ose vjeljes të bëra nga kapiteni ose përfaqësuesi i anijes përpunuese ose operatori i kurthit.

5. Gjithashtu, vëzhguesi i CPC-së do të kryejë punë shkencore, si mbledhja e të gjitha të dhënave të nevojshme të kërkuara nga Komisioni, bazuar në rekomandimet e SCRS-së.

Programi rajonal i vëzhguesve të ICCAT-it

- Çdo CPC duhet t'u kërkojë kurtheve, fermave dhe anijeve të saj me rrethim (koshilok), siç referohen në paragrafin 101 për të vendosur një vëzhgues rajonal ICCAT.

- Sekretariati i Komisionit duhet t'i emërojë vëzhguesit para 1 prillit ose sa më shpejt të jetë praktike për çdo vit, dhe do t'i vendosë ato në kurthe, ferma dhe në bord të anijeve me rrethim që kanë flamurin e një CPC-je të ICCAT-it që zbatojnë programin e vëzhguesit të ICCAT-t. Një kartë vëzhguesi e ICCAT-it do të lëshohet për çdo vëzhgues.

- Sekretariati do të lëshojë një kontratë që liston të drejtat dhe detyrimet e vëzhguesit dhe të kapitenit të anijes, kurthit apo të përdoruesit të fermës së kultivimit. Kjo kontratë do të nënshkruhet nga të dyja palët e përfshira.

- Sekretariati do të hartojë një manual të programit të vëzhguesve të ICCAT-it.

Kualifikimi i vëzhguesve rajonalë të ICCAT-it

Vëzhguesit rajonalë të ICCAT-it duhet të kenë kualifikimet e mëposhtme për të përmbushur detyrat e tyre:

- eksperiencë të mjaftueshme për të identifikuar llojet dhe veglat e peshkimit;

- njohje të kënaqshme të masave konservuese dhe menaxhuese të ICCAT-it e bazuar mbi udhëzimet e trajnimit të ICCAT-it;

- aftësi për të vëzhguar dhe për të regjistruar në mënyrë të saktë;

- aftësi për të analizuar pamjet e regjistrimit video;

- një njohje të kënaqshme të gjuhës së shtetit flamur të anijes apo të shtetit të fermës së vëzhguar, sa të jetë e mundur.

Detyrimet e vëzhguesit

6. Vëzhguesi duhet:

a) ta ketë plotësuar trajnimet teknike të kërkuara nga udhëzimet e hartuara nga ICCAT-i;

b) të ketë kombësinë e njërës nga CPC-ja dhe, aty ku është e mundur, jo të shtetit ku është ferma, kurthi apo të anijes me rrethim;

c) të jetë i aftë në kryerjen e detyrave të përcaktuara në pikën e mëposhtme 7;

d) të jetë i përfshirë në listën e vëzhguesve që mbahet nga sekretariati i Komisionit;

e) të mos ketë aktualisht interesa financiarë apo përfitimi nga peshkimi i tonit.

- Vëzhguesit rajonalë të ICCAT-it do ta trajtojnë si konfidencial të gjithë informacionin në lidhje me operacionet e peshkimit dhe të transferimit të kryera nga anijet me rrethim, fermat dhe kurthe, dhe e pranojnë këtë kërkesë me shkrim, si kusht për t'u emëruar si vëzhgues rajonal i ICCAT-it.

- Vëzhguesit rajonalë të ICCAT-it duhet të respektojnë kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe rregulloret e CPC-së që ushtron juridiksionin mbi anijen, fermën ose kurthin në të cilin është caktuar vëzhguesi rajonal i ICCAT-it.

- Vëzhguesit rajonalë të ICCAT-it do të respektojnë hierarkinë dhe rregullat e përgjithshme të sjelljes që zbatohen për të gjithë personelin e anijeve, fermave dhe kurtheve, me kusht që rregulla të tilla të mos ndërhyjnë në detyrat e vëzhguesit rajonal të ICCAT-it, sipas këtij programi dhe me detyrimet e anijes, fermës dhe personelin e kurthit të përcaktuar në këtë shtojcë.

Detyrat e vëzhguesit rajonal të ICCAT-it

- Detyrat e vëzhguesve rajonalë të ICCAT-it do të jenë në veçanti.

Detyrat e përgjithshme:

i. vëzhgojnë dhe monitorojnë përputhshmërinë e operacioneve të peshkimit dhe të kultivimit të tonit me masat përkatëse të ruajtjes dhe të menaxhimit të ICCAT-it;

ii. të kryejë punë të tilla shkencore, të tilla si mbledhja e mostrave ose e të dhënave të detyrës 2, siç kërkohet nga Komisioni, bazuar në rekomandimet e SCRS-së;

iii. shikojnë dhe regjistrojnë anijet që mund të peshkojnë në kundërshtim me masat e ruajtjes dhe të menaxhimit të ICCAT-it;

iv. të verifikojë dhe të regjistrojë emrin e anijes së peshkimit në fjalë dhe numrin e saj ICCAT;

v. të ushtrojë çdo funksion tjetër të përcaktuar nga Komisioni.

Për sa u përket anijeve me koshilok ose aktivitetit të kurtheve:

vi. vëzhgojnë dhe raportojnë mbi aktivitetet e peshkimit të kryera;

vii. vëzhgon dhe vlerëson zëniet dhe verifikoni shënimet e bëra në *logbook*;

Për sa i përket transferimit të parë nga një anije me koshilok ose kurth në kosh/at transportues:

viii. regjistrojnë dhe raportojnë mbi realizimin e aktiviteteve të transferimit;

ix verifikon pozicionin e anijes kur angazhohet në një transferim;

x. të shqyrtojë dhe analizojë të gjitha pamjet video që lidhen me operacionin e transferimit në fjalë, aty ku është e aplikueshme;

xi. vlerëson numrin e peshqve të transferuar dhe regjistron rezultatin në ITD;

xii. nxjerr një raport ditor të aktiviteteve të transferimit të anijeve me koshilok;

xiii. regjistrojnë dhe raportojnë mbi rezultatin e analizave të tilla;

xiv. të verifikojë hyrjet e bëra në autorizimin paraprak të transferimit të përmendur në paragrafin 112, në ITD të përmendur në paragrafët 130 deri në 133 dhe në eBCD;

xv. të verifikojë që ITD-ja e përmendur në paragrafët 130 deri në 133 t'i transmetohet kapitenit të anijes tërheqëse ose përfaqësuesit të fermës ose kurthit;

xvi. në lidhje me transferimet e kontrollit, verifikon numrin e identifikimit të vulave dhe sigurohet që vulat të vendosen në mënyrë të tillë që të parandalojnë hapjen e dyerve pa thyer vulat.

Për sa u përket operacioneve të vendosjes së tonit në kosha:

xvii. rishikon pamjet e videokamerës të vendosjes se tonit në kosh për të vlerësuar në kohën e duhur numrin e peshqve të futur në kosh, për të lejuar operatorin e fermës të plotësojë deklaratën përkatëse.

Për sa i përket verifikimit të të dhënave:

xviii. të verifikojë dhe vërtetojë të dhënat e përfshira në ITD, deklaratat e vendosjes në kosha dhe eBCD, duke përfshirë analizën e regjistrimeve video;

xix. të nxjerrë një raport ditor të aktiviteteve të transferimit të anijeve me koshilok, fermave dhe kurtheve;

xx. firmos ITD-të, deklaratat e vendosjes në kosha dhe eBCD-në, me emrin dhe numrin e ICCAT të shkruar qartë, kur operacioni përkatës është në përputhje me masat e ruajtjes dhe menaxhimit të ICCAT-it dhe informacioni që përmban këto dokumente është në përputhje me vëzhgimet e tij/saj. Në rast mosmarrëveshjeje, vëzhguesi rajonal i ICCAT-it do të tregojë praninë e tij/saj në deklaratat përkatëse të ITD-së dhe deklaratat e vendosjes në kosha dhe/ose eBCD-së përkatëse, dhe arsyet e mosmarrëveshjes, duke cituar në mënyrë specifike rregullin/at ose procedurën/at që pikëpamja/et e tij/saj nuk është (janë) respektuar.

Për sa u përket lëshimeve (lirimeve):

xxi. për sa u përket lëshimeve përpara mbylljes në kosh, vëzhgon dhe raporton për operacionin e lëshimit nga rrjeta e koshilokut ose koshi i transportit, në përputhje me protokollin e lëshimit në aneksin 10;

xxii. për sa u përket lëshimeve pas mbylljes në kosh, vëzhgon dhe raporton për ndarjen paraprake të peshkut dhe operacionin e mëpasshëm të lirimit, në përputhje me protokollin e lëshimit në aneksin 10, duke përfshirë verifikimin që cilësia e pamjeve video të ndarjes së mëparshme plotëson standardet minimale të aneksit 8 dhe duke vlerësuar numrin e peshqve të liruar;

xxiii. në të dyja rastet, verifikon urdhrin e lirimit të lëshuar nga autoriteti kompetent dhe vërtetoni informacionin në deklaratën e lëshimit të bërë nga dhuruesi ose operatori i fermës.

Për sa i përket veprimtarisë së vjeljes në ferma:

xxiv. të verifikojë autorizimin e vjeljes të lëshuar nga autoriteti kompetent i CPC-së së fermës;

xxv. të vërtetojë informacionin në deklaratat e përpunimit dhe vjeljes të bëra nga kapiteni ose përfaqësuesi i anijes së përpunimit ose nga operatori i fermës.

Për sa i përket raportimit:

xxvi. regjistron dhe verifikon praninë e çdo lloj markimi (tag), duke përfshirë shenjat natyrore, dhe njofton çdo shenjë të fundit për heqjen të etiketës. Për të gjithë individët e markuar elektronikisht, kryen kampionim të plotë biologjik *(otolite,* shtyllë kurrizore dhe kampion gjenetik), duke ndjekur udhëzimet nga SCRS;

xxvii. të krijojë raporte të përgjithshme duke përpiluar informacionin e mbledhur në përputhje me këtë paragraf dhe t'i sigurojë kapitenit të anijes dhe operatorit të fermës mundësinë për të përfshirë në to çdo informacion përkatës;

xxviii. të dorëzojë raportin e përgjithshëm të lartpërmendur tek ofruesi përgjegjës për ROP, për transmetim të mëvonshëm në sekretariatin e ICCAT-IT, brenda 20 ditëve nga përfundimi i periudhës së vëzhgimit;

xxix. në rastet kur vëzhguesi rajonal i ICCAT-it vëren një mospërputhje të mundshme me një rekomandim të ICCAT-it, ai/ajo duhet t'ia dorëzojë këtë informacion pa vonesë ofruesit përgjegjës për ROP, i cili do t'ia përcjellë pa vonesë autoritetit kompetent të CPC-së anijes, kurthit ose fermës në fjalë dhe sekretariatit të ICCAT-IT. Për këtë qëllim, ofruesi përgjegjës për ROP do të krijojë një sistem përmes të cilit ky informacion mund të komunikohet në mënyrë të sigurt;

xxx. të marrë, sa më shumë që të jetë e mundur, prova (p.sh. foto, video) të mospërputhshmërisë së mundshme të zbuluar dhe t'i bashkëngjisë ato në raportin e tij/saj.

Detyrimet e CPC-ve të anijes, kurthit dhe fermës:

- CPC-të e anijes, fermës dhe kurthit duhet të sigurojnë që, veçanërisht, vëzhguesi rajonal i ICCAT-it:

a) t'i lejohet qasja në anijen me koshilok, në fermë dhe kurth, si dhe te pajisjet e peshkimit, pajisjet e koshave, si dhe pamjet e kamerës stereoskopike dhe videokamerës konvencionale;

b) me kërkesë dhe për të kryer detyrat e tyre të përcaktuara në këtë program, lejohet aksesi në pajisjet e mëposhtme, nëse janë të pranishme në anijet në të cilat janë caktuar:

i. pajisjet e navigimit satelitor;

ii. ekranet e radarit kur është në përdorim;

iii. mjetet elektronike të komunikimit;

c) t'i ofrohen akomodim në anije, duke përfshirë fjetje dhe ushqimin dhe në objektet adekuate sanitare, të barabarta me ato të oficerëve të anijes;

d) të pajiset me hapësirë adekuate në urë ose në kabinën e pilotimit për punë zyre, si dhe hapësirë adekuate në kuvertë për kryerjen e detyrave të vëzhguesit; dhe

- CPC-të e anijes, kurthit dhe fermës duhet të sigurojnë që kapiteni, ekuipazhi, ferma, kurthi dhe pronarët e anijeve të mos pengojnë, frikësojnë, ndërhyjnë, influencojnë, japin ryshfet ose tentojnë t'i japin ryshfet një vëzhguesi rajonal të ICCAT-it në kryerjen e detyrave të tij/saj.

- Sekretariatit të ICCAT-it, në përputhje me çdo kërkesë konfidencialiteti të zbatueshëm, i kërkohet t'i ofrojë CPC-së së anijes, kurthit ose fermës, kopje të të gjitha të dhënave të papërpunuara, përmbledhjeve dhe raporteve që kanë të bëjnë me udhëtimin. Sekretariati i ICCAT-it do t'i dorëzojë raportet e vëzhguesve rajonalë të ICCAT-it Komitetit të Përputhshmërisë dhe SCRS-së.

- Autoriteti kompetent i CPC-së së anijes, fermës ose kurthit ku vëzhguesi rajonal i ICCAT-it ofron shërbimet e tij/saj, mund të kërkojë që vëzhguesi të zëvendësohet nëse ata kanë dëshmi se vëzhguesi rajonal i ICCAT-it nuk i përmbush detyrimet e tij ose nuk i kryen në mënyrë adekuate detyrat e përcaktuara në këtë rekomandim. Çdo rast i tillë do t'i raportohet panelit 2.

Tarifat dhe organizimi

- Kostot e zbatimit të këtij programi do të financohen nga operatorët e fermave dhe kurtheve, si dhe pronarët e anijeve me koshilok. Tarifa do të llogaritet në bazë të kostove totale të programit dhe do të paguhet në një llogari të veçantë të sekretariatit të ICCAT-it. Sekretariati ICCAT do të menaxhojë llogarinë për zbatimin e programit.

Asnjë vëzhgues rajonal i ICCAT-it nuk do të caktohet në një anije, kurth ose fermë për të cilën tarifat, siç kërkohet në këtë shtojcë, nuk janë paguar.

SHTOJCA **7**
SKEMA E ICCAT-it MBI INSPEKTIMIN E PËRBASHKËT NDËRKOMBËTAR

Në përputhje me pikën 3 të nenit IX të Konventës, Komisioni i ICCAT-it rekomandon hartimin e marrëveshjeve të mëposhtme për kontrollin ndërkombëtar jashtë ujërave që janë në juridiksionet kombëtare, me qëllim sigurimin e aplikimit të Konventës dhe masave që janë në fuqi nën të:

I. Shkeljet e rënda

1. Për qëllimet e kësaj procedure, me shkelje të rënda kuptohen shkeljet e mëposhtme të dispozitave të masave konservuese dhe menaxhuese të ICCAT-it të adoptuara nga Komisioni:

a) peshkimi pa një licencë, leje apo autorizim të lëshuar nga CPC flamur;

b) mosmbajtja e të dhënave të mjaftueshme mbi zëniet apo lidhur me zëniet në përputhje me kërkesat mbi raportimin të Komisionit apo keqraportime domethënëse të këtyre të dhënave mbi zëniet apo lidhur më zëniet;

c) peshkimin në zona të ndaluara për peshkim;

d) peshkimi gjatë periudhës së ndalimit të peshkimit;

e) marrja ose mbajtja në mënyrë të qëllimshme e llojeve në kundërvajtje me masat konservuese dhe menaxhuese në fuqi të adoptuara nga ICCAT-i;

f) shkeljet domethënëse të limiteve të zënieve dhe kuotave në fuqi që janë përcaktuar nga rregullat e ICCAT-it;

g) përdorimi i veglave të peshkimit të ndaluara;

h) falsifikimi ose fshehja në mënyrë të qëllimshme e shenjave, identitetit apo regjistrimit të një anije peshkimi;

i) fshehja, ngatërrimi apo eliminimi i provave që lidhen me hetimin e një shkeljeje;

j) shkelje të shumëfishta të cilat, të marra së bashku, përbëjnë një mosvlerësim domethënës të masave në fuqi që lidhen me ICCAT-in;

k) sulmimi, rezistenca, frikësimi, ngacmimi seksual, ndërhyrja, bllokimi apo vonimi i padrejtë i një vëzhguesi apo inspektori të autorizuar;

l) çaktivizimi apo manipulimi në mënyrë të qëllimshme i sistemit të vëzhgimit të anijeve;

m) shkelje të tjera që mund të përcaktohen nga ICCAT-i, pasi ato të jenë përshirë dhe qarkulluar në një version të rishikuar të këtyre procedurave;

n) peshkimi me ndihmën e avionëve vrojtues;

o) ndërhyrja në sistemin e monitorimit satelitor dhe/apo veprimi pa sistemin e sistemit të vëzhgimit të anijeve;

p) aktiviteti i transferimit pa deklaratë transferimi;

q) transbordimi në det;

r) mosdhënia e shkalleve për t'u imbarkuar inspektorëve të ICCAT-it, sipas kushteve të rezolutës IMO A.889(21) për të lehtësuar imbarkimin e sigurt në çdo anije peshkimi që kërkon një ngjitje prej me shume se 1.5 metrash.

2. Në rastin e ngjitjes në bord dhe inspektimit të një anijeje peshkimi gjatë të cilës inspektorët e autorizuar vërejnë një aktivitet apo gjendje që do të përbënte një shkelje të rëndë, siç është përcaktuar në pikën 1 të kësaj shtojce, autoritetet e anijes inspektuese duhet të njoftojnë menjëherë autoritetet

e anijes së peshkimit si në mënyrë direkte, ashtu dhe nëpërmjet sekretariatit të ICCAT-it. Në situata të tilla, inspektori duhet të njoftojë, gjithashtu, çdo anije inspektimi të shtetit flamur të anijes së peshkimit që dihet të jetë në afërsi.

3. Inspektorët e ICCAT-it duhet të regjistrojnë inspektimet e ndërmarra dhe shkeljet e zbuluara (nëse ka) në librin e anijes së peshkimit.

4. CPC-ja flamur duhet të sigurojë që, pas inspektimit të kryer sipas pikës 2 të kësaj shtojce, anija e peshkimit në fjalë të ndalojë të gjitha aktivitetet e peshkimit. CPC-ja flamur duhet t'i kërkojë anijes së peshkimit t'i drejtohet brenda 72 orëve në një port të përcaktuar nga ai, ku do të kryhet dhe hetimi.

5. Në rastin kur një inspektim ka zbuluar një aktivitet ose kusht që do të përbënte një shkelje të rëndë, anija duhet të rishikohet sipas procedurave të përshkruara në rekomandimin nga ICCAT-i mbi krijimin e një liste të anijeve që supozohet të kenë kryer aktivitetet e peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar (IUU) (rek. 18-08[1]), duke marrë parasysh çdo veprim përgjigjeje dhe ndjekje të tjera.

II. Kryerja e inspektimit

6. Inspektimi do të kryhet nga inspektorët e shërbimit të kontrollit të peshkimit të Qeverisë Kontraktuese. Emrat e agjencive qeveritare të autorizuara dhe të inspektorëve të përcaktuar për këtë qëllim nga qeveritë përkatëse duhet t'i njoftohen Komisionit.

7. Anijet që kryejnë detyra ndërkombëtare të imbarkimit dhe të inspektimit në përputhje me këtë shtojcë do të mbajnë një flamur ose flamurë të veçantë të miratuar nga Komisioni dhe të lëshuar nga sekretariati i ICCAT-it. Emrat e anijeve të përdorura për këtë qëllim do t'i njoftohen sekretariatit të ICCAT-it sa më shpejt që të jetë e mundur përpara fillimit të aktiviteteve të inspektimit. Sekretariati do të vërë informacionin në lidhje me anijet e përcaktuara të inspektimit të vlefshëm për të gjitha CPC-të, duke përfshirë postimin në faqen e tij të internetit të mbrojtur me fjalëkalim.

8. Çdo inspektor duhet të mbajë një dokument identiteti të lëshuar nga autoritetet e shtetit flamur në formën e treguar në pikën 20 të kësaj shtojce.

9. Në zbatim të marrëveshjes së pranuar në pikën 15 të kësaj shtojce, një anije e përdorur gjatë periudhës së përcaktuar në peshkimin për ton apo lloje të ngjashme me tonin në zonën e Konventës së mbuluar nga ICCAT-i jashtë ujërave të juridiksionit të saj kombëtar do të ndalojë kur i jepet një sinjal i tillë në Kodin Ndërkombëtar të Sinjaleve nga një anije që ka në bord një inspektor të përshkruar në paragrafin 7, përveçse kur është duke kryer aktivitet peshkimi, në këtë rast ajo duhet të ndalojë sapo ka mbaruar këtë aktivitet. Kapiteni i anijes do të lejojë palën inspektuese, siç është specifikuar në paragrafin 10 të kësaj shtojce, të hyjë në bord dhe duhet të sigurojë një shkallë ngjitjeje, sipas kushteve të rezolutës IMO A.889(21) për të lehtësuar imbarkimin e sigurt në çdo anije peshkimi që kërkon një ngjitje prej më shumë se 1.5 metrash. Për të plotësuar kërkesën për t'u pajisur me shkallë ngjitjeje, do të lejohet një periudhë tranzitore për anijet që operojnë në Atlantik, deri në janar 2024.

Kapiteni duhet t'i mundësojë palës së inspektimit që të bëjë një ekzaminim të tillë të pajisjeve, kapjes ose pajisjes dhe çdo dokument përkatës që inspektori i konsideron të nevojshme për të verifikuar pajtueshmërinë me rekomandimet e Komisionit të ICCAT-it në fuqi në lidhje me shtetin flamurin e anijes që inspektohet. Më tej, një inspektor mund të kërkojë shpjegime që ai ose ajo e konsideron të nevojshme,

10. Madhësia e grupit të inspektimit duhet të përcaktohet nga zyrtari komandues i anijes inspektuese, duke marrë parasysh rrethanat përkatëse. Pala inspektuese duhet të jetë sa më e vogël të jetë e mundur për të përmbushur detyrat e përcaktuara në këtë shtojcë në mënyrë të sigurt dhe pa rreziqe

11. Pas hipjes në anije, inspektorët duhet të paraqesin dokumentacionin e identifikimit të përshkruar në paragrafin 8 të këtij aneksi. Inspektorët duhet të respektojnë rregulloret, procedurat dhe praktikat ndërkombëtare të pranuara në përgjithësi, në lidhje me sigurinë e anijes që inspektohet dhe ekuipazhin e saj, dhe do të minimizojë ndërhyrjen në aktivitetet e peshkimit ose në depozitimin e produktit dhe, në masën që është e mundur, të shmangë veprimet që do të ndikojnë negativisht në cilësinë e peshkut të kapur në bord; inspektorët do të kufizojnë hetimet e tyre në konstatimin e respektimit të rekomandimeve të Komisionit të ICCAT-it në fuqi në lidhje me shtetin

[1] Zëvendësuar nga rec. 21-13.

flamurin e anijes në fjalë. Gjatë kryerjes së inspektimit, inspektorët mund t'i kërkojnë kapitenit të anijes së peshkimit për çdo ndihmë që ai mund të kërkojë. Inspektorët duhet të hartojnë një raport të inspektimit në një formë të miratuar nga Komisioni i ICCAT-it. Inspektorët e nënshkruajnë raportin në praninë e kapitenit të anijes, i cili ka të drejtë të shtojë ose t'i ketë shtuar raportit çdo vërejtje që ai ose ajo mund të mendojë të përshtatshme dhe duhet të nënshkruajë këto vërejtje.

12. Kopjet e raportit do t'i jepen kapitenit të anijes dhe qeverisë së palës inspektuese, e cila i transmeton kopjet autoriteteve përkatëse të shtetit flamur të anijes së inspektuar dhe Komisionit ICCAT. Kur zbulohet ndonjë shkelje e rekomandimeve të ICCAT-it, inspektori duhet, kur është e mundur, gjithashtu, të informojë çdo anije inspektuese të shtetit flamur të anijes së peshkimit që njihet dhe që është në afërsi

13. Rezistenca ndaj inspektorëve ose mosrespektimi i udhëzimeve të tyre do të trajtohen nga shteti flamur i anijes së inspektuar në një mënyrë të ngjashme me sjelljen e kryer në lidhje me një kontroll inspektimi kombëtar.

14. Inspektori duhet të kryejë detyrat e tij nën këtë marrëveshje në përputhje me rregullat e hartuara në këtë rekomandim, por ato duhet të qëndrojnë nën kontrollin operacional të autoriteteve kombëtare të tyre dhe duhet të jenë përgjegjës ndaj tyre.

15. Qeveritë kontraktuese do të marrin në konsideratë dhe do të veprojnë në raportet e inspektimit, duke shikuar fletët e informacionit sipas rek. 19-09 dhe deklaratat që rezultojnë nga inspektimet e dokumentuara të inspektorëve të huaj sipas këtyre marrëveshjeve, në një bazë të ngjashme në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar ndaj raporteve të inspektorëve kombëtarë. Dispozitat e këtij paragrafi nuk do të imponojnë asnjë detyrim ndaj një qeverie kontraktuese që t'i japë raportit të një inspektori të huaj një vlerë më të lartë dëshmie se sa do të kishte në vendin e vet të inspektorit. Qeveritë Kontraktuese do të bashkëpunojnë në mënyrë që të lehtësojnë procedurat gjyqësore ose të tjera që rrjedhin nga një raport i një inspektori sipas këtyre marrëveshjeve.

a) Shtetet kontraktuese duhet të informojnë Komisionin e ICCAT-it deri më 15 shkurt të çdo viti të planeve të tyre të përkohshme për kryerjen e aktiviteteve inspektuese sipas këtij Rekomandimi në atë vit kalendarik dhe Komisioni mund të bëjë sugjerime për shtetet kontraktuese për koordinimin e veprimeve kombëtare në këtë fushë duke përfshirë numrin e inspektorëve dhe anijet që mbartin inspektorë.

b) Marrëveshjet e hartuara në këtë rekomandim dhe planet për pjesëmarrjen do të aplikohen midis shteteve kontraktuese, përveçse kur kanë marrëveshje tjetër midis tyre, dhe kjo marrëveshje duhet t'i bëhet e ditur Komisionit të ICCAT-it. Megjithatë, zbatimi i kësaj skeme do të pezullohet ndërmjet dy shteteve kontraktuese, kur secili nga to ka njoftuar Komisionin e ICCAT-it për të, në pritje të plotësimit të marrëveshjes.

16. a) Rrjetat e peshkimit do të maten në përputhje me rregullat në fuqi për nënzonën në të cilën kryhet inspektimi. Inspektorët do të deklarojnë nënzonën për të cilën bëhet inspektimi dhe një përshkrim të çdo shkeljeje të gjetur në raportin e inspektimit.

b) Inspektorët do të kenë autoritetin për të inspektuar të gjitha veglat e peshkimit në përdorim apo në kuvertë.

17. Inspektori do të ngjisë një shenjë identifikuese të aprovuar nga Komisioni i ICCAT-it për çdo vegël peshkimi të inspektuar që dyshohet të jetë në kundërvajtje me rekomandimet në fuqi të Komisionit të ICCAT-it, në lidhje me shtetin flamur të anijes në fjalë dhe duhet t'i regjistrojë këto fakte në raportin e tij.

18. Inspektori mund të fotografojë mjetet e peshkimit, pajisjet, dokumentacionin dhe çdo element tjetër që ai e konsideron të nevojshëm në mënyrë të tillë që të zbulojë ato karakteristika që sipas mendimit të tyre nuk janë në përputhje me rregulloren në fuqi, në të cilin rast subjektet e fotografuara duhet të jenë të listuara në raport dhe kopjet e fotografive duhet t'i bashkëngjiten kopjes së raportit në CPC-në të flamurit.

19. Inspektorët, sipas nevojës, inspektojnë të gjitha zëniet në bord për të përcaktuar pajtueshmërinë me rekomandimet e ICCAT-it.

20. Modeli i propozuar për kartën e identitetit të inspektorit.

Dimensionet: gjerësia 10.4 cm, lartësia 7 cm



SHTOJCA 8
STANDARDET MINIMALE PËR PROCEDURAT E REGJISTRIMIT TË VIDEOVE I ZBATUESHËM PËR OPERACIONET E TRANSFERIMIT, VENDOSJES NË KOSHA DHE/OSE LËSHIMIT

1. Çdo CPC e anijes, kurthit dhe fermës në fjalë do të sigurojë që procedurat e mëposhtme të zbatohen për të gjitha regjistrimet video të operacioneve të transferimit, futjes në kosha dhe/ose lëshimit të referuara në këtë Rekomandim:

a) në fillim dhe/ose në fund të çdo videoje, kur kërkohet, do të shfaqet numri i autorizimit të transferimit, ose të autorizimit të vendosjes në kosha ose urdhri i lëshimit sipas ICCAT-it;

b) ora dhe data e videos do të shfaqen vazhdimisht gjatë çdo regjistrimi video;

c) regjistrimi i videos duhet të jetë i vazhdueshëm pa asnjë ndërprerje dhe prerje dhe të mbulojë të gjithë operacionin e transferimit, vendosjes në kosha dhe/ose lëshimit;

d) përpara fillimit të operacionit të transferimit, vendosjes në kosha dhe/ose lëshimit, video regjistrimi duhet të përfshijë hapjen dhe mbylljen e rrjetës/portës së koshit dhe, për operacionet e transferimit dhe të vendosjes në kosha, të tregojë nëse koshi (koshat) marrës dhe dhurues përmbajnë ton;

e) regjistrimi i videos duhet të jetë i një cilësie të mjaftueshme për të përcaktuar numrin dhe, sipas rastit, peshën e tonit që transferohet, futet në kosh dhe/ose lëshohet;

f) një kopje e videos do të mbahet në bordin e anijes dhuruese, ose nga ferma ose operatori i kurthit, sipas rastit, gjatë gjithë periudhës së autorizimit për të operuar;

g) shpërndarja e kopjeve të videoregjistrimeve do të ndjekë dispozitat e përmendura në paragrafët 120 deri në 123 të këtij Rekomandimi;

h) pajisja elektronike që përmban regjistrimin origjinal të videos duhet t'i jepet menjëherë vëzhguesit rajonal të ICCAT-it dhe/ose kombëtar të CPC-së pas përfundimit të operacionit të transferimit, vendosjes në kosha dhe/ose lëshimit. Vëzhguesi rajonal i ICCAT-it dhe/ose vëzhguesi i CPC-së duhet ta inicializojnë menjëherë atë për të shmangur çdo manipulim të mëtejshëm.

2. Çdo CPC e anijes, kurthit dhe fermës në fjalë do të marrë masat e nevojshme për të shmangur çdo zëvendësim, botim ose manipulim të regjistrimeve origjinale të videos.

Cilësi e pamjaftueshme e regjistrimit të videos

3. Nëse regjistrimi video është i cilësisë së pamjaftueshme për të përcaktuar numrin dhe, sipas rastit, peshën e tonit që transferohet, futet në kosh dhe/ose lëshohet, operacioni do të përsëritet derisa cilësia e videos të jetë e përshtatshme, duke ndjekur procedurat më poshtë:

a) Për një transferim, operacioni i transferimit në fjalë do të përsëritet në përputhje me dispozitat e përcaktuara në paragrafët 124 deri në 129 të këtij Rekomandimi (transferime vullnetare dhe kontrolli). Ky transferim vullnetar ose i kontrollit do të kryhet në një kosh tjetër, i cili duhet të jetë bosh.

Për ato transferime ku origjina e peshkut është një kurth, toni tashmë i transferuar nga kurthi në koshin pritës mund të kthehet përsëri në kurth dhe transferimi vullnetar anulohet nën mbikëqyrjen e vëzhguesit rajonal të ICCAT-it.

b) Për një operacion vendosje në kosha, operacioni në fjalë do të përsëritet në përputhje me dispozitat e përcaktuara në paragrafët 163 dhe 164 të këtij Rekomandimi.

Operacioni i ri i vendosje në kosha duhet të përfshijë lëvizjen e të gjithë tonit nga koshi i fermës pranuese në një kosh tjetër ferme, i cili duhet të jetë bosh.

c) Për lëshimet, veçimi i peshkut që do të lëshohet do të përsëritet në përputhje me protokollin e lirimit të përcaktuar në aneksin 10 të këtij Rekomandimi.

SHTOJCA 9
STANDARDET DHE PROCEDURAT PËR SISTEMET E KAMERAVE STEREOSKOPIKE NË KONTEKSTIN E OPERACIONEVE TË FUTJES SË TONIT NË KOSHA

1. Përdorimi i sistemit të kamerave stereoskopike.

Përdorimi i sistemeve të kamerave stereoskopike në kontekstin e operacioneve të vendosje në kosha të tonit do të kryhet në përputhje me dispozitat e mëposhtme:

i. Intensiteti i marrjes së mostrave të peshqve të gjallë nuk duhet të jetë nën 20% të sasisë së peshkut të vendosur në kosha. Kur është e mundur teknikisht, marrja e mostrave të peshqve të gjallë duhet të jetë në vijim, duke matur një në çdo pesë ekzemplarë. Një mostër e tillë do të përbëhet nga peshq të matur në një distancë prej 2 deri në 8 metrash nga kamera.

ii. Dimensionet e portave të transferimit që lidhin koshin dhënës dhe koshin pranues duhet të jene në gjerësi maksimale prej 8–10 metrash dhe lartësi maksimale prej 8–10 metrash.

iii. Vlerësimi i matjeve të gjatësisë stereoskopike duhet të ndërmerret përpara secilit operacion të vendosjes në kosha, duke përdorur një shirit shkalle në distancë prej 2 dhe 8 m.

iv. Kur matjet e gjatësisë së peshkut paraqesin një shpërndarje multimodale (dy ose më shumë kohorte të madhësive të ndryshme), mund të përdoret më shumë se një algoritëm konvertimi për të njëjtin operacion të hedhjes në kosha.

v. Algoritmi më i përditësuar i krijuar nga SCRS-ja do të përdoret për të kthyer gjatësinë në pendën e bishtit në pesha të përgjithshme, sipas kategorisë së madhësisë së peshkut të matur gjatë operacionit të grumbullimit.

vi. Marzhi i gabimit për përcaktimin e peshës, i natyrshëm për specifikimet teknike të sistemit të kamerës stereoskopike, nuk duhet të kalojë një interval prej +/- 5 përqindësh.

vii. Raporti mbi rezultatet e programit stereoskopik duhet të përfshijë detaje mbi të gjitha specifikimet teknike të mësipërme, përfshirë intensitetin e mostrës, mënyrën e metodologjisë së marrjes së mostrës, distancën nga kamera, përmasat e portës së transferimit dhe algoritmet (relacionin gjatësi - peshë). SCRS-ja do të shqyrtojë këto specifikime, dhe nëse është e nevojshme të japë rekomandime për t'i modifikuar ato.

2. Rezultatet e vendosje në kosha të tonit

Në përfundim të një operacioni të vendosjes në kosha, ose setit të plotë të operacioneve të të vendosjes në kosha nën një JFO ose në kurthe të të njëjtit shtet anëtar të CPC/BE, autoriteti kompetent i CPC-së i fermës do t'i komunikojë informacionin e mëposhtëm autoritetit kompetent të CPC-së së anijes ose kurthit:

a) Një raport teknik në lidhje me sistemin e kamerës stereoskopike, i cili duhet të përmbajë në veçanti:

- informacione të përgjithshme: speciet, vendndodhjen, koshin, datën, algoritmin;
- informacioni statistikor për përmasat: pesha dhe gjatësia mesatare, pesha dhe gjatësia minimale, pesha dhe gjatësia maksimale, numri i peshkut të kampionuar, shpërndarja e peshës, shpërndarja e madhësisë;
- algoritmi i përdorur për të kthyer gjatësinë në peshë;
- marzhi i gabimit të sistemit të kamerës stereoskopike të përdorur: në rastin kur softueri i kamerës nuk ka një metodë automatike për llogaritjen e këtij kufiri gabimi, ai do të llogaritet siç detajohet në pikat 1 deri në 4 të aneksit së kësaj shtojce.

b) Një raport faktik në lidhje me operacionin e vendosjes në kosha, i cili duhet të përmbajë në veçanti:

- rezultatet e detajuara të programit të marrjes së mostrave, me numrin dhe peshën totale të tonit të kuq në kafaz, si dhe madhësinë dhe peshën e çdo peshku që u mor në kampion;
- deklaratat përkatëse të vendosjes në kosha;

- përcaktimi i rasteve kur mospërputhjet prej më shumë se 10% midis numrit të individëve të koshit dhe numrit të raportuar si të kapur në ITD kërkojnë hetim nga autoriteti kompetent i CPC-së flamur ose kurth, në përputhje me paragrafin 174, dhe rastet kur rezultatet e vendosjes në kosha tregojnë kjo zënie nuk është në përputhje me paragrafët 33 deri në 35;

- informacion i përgjithshëm mbi operacionin e vendosjes në kosha: numri i operacionit të vendosjes në kosha, emri i fermës, numri i koshit, numri eBCD, numri ITD, emri dhe flamuri i anijes të peshkimit, emri dhe flamuri i anijes tërheqëse, data e funksionimit të sistemit të kamerës stereoskopike dhe emri i skedarit të filmimit;

- krahasimi midis sasive të deklaruara në eBCD dhe sasive të gjetura me sistemin e kamerës stereoskopike, në numrin e peshqve, peshën mesatare dhe peshën totale (formula e përdorur për llogaritjen e diferencës do të jetë: (Sistemi Stereoskopik-eBCD)/Sistemi Stereoskopik* 100).

3. Raporti i vendosjes në kosha

Raporti i vendosjes në kosha të përmendur në paragrafin 186 të këtij Rekomandimi do të përfshijë:

a) rezultatet e vendosjes në kosha të përmendura në pikën 2;

b) raportet përkatëse të operacioneve të lëshimit, të kryera në përputhje me aneksin 10.

4. Përdorimi i rezultatit të kamerës stereoskopike

Duke aplikuar marzhin e gabimit të natyrshëm për specifikimet teknike të sistemit të kamerës stereoskopike të përdorur, autoriteti kompetent i CPC-së së fermës do të përcaktojë limitet (vlerën më të ulët dhe më të lartë) e peshës totale të tonit në kosh, në përputhje me pikën 5 të aneksit të kësaj shtojce.

Kur merren rezultatet e analizës së pamjeve video të kamerës stereoskopike dhe limitet (vlera më e ulët dhe më e lartë) e peshës totale të tonit në kosh, të komunikuara nga autoriteti kompetent i CPC-së së fermës, autoriteti kompetent shtetëror i CPC-së së anijes së peshkimit ose të kurthit/anëtar i BE-së do të marrë masat e mëposhtme:

a) të zbatojë masat e mëposhtme në lidhje me lëshimet dhe përshtatjen e seksioneve eBCD për anijet e peshkimit që operojnë në kuadër të një operacioni individual peshkimi (jashtë një JFO);

i. kur pesha totale e deklaruar nga anija e peshkimit në eBCD është brenda intervalit të rezultateve të sistemit të kamerës stereoskopike:

- nuk do të urdhërohet lirimi;

- eBCD do të ndryshohet si në numër (duke përdorur numrin e peshqve që rezulton nga përdorimi i sistemit të kamerës stereoskopike) dhe peshën mesatare, ndërsa pesha totale nuk do të ndryshohet;

ii. kur pesha totale e deklaruar nga anija peshkimit në seksionin e zënies së eBCD-së është nën shifrën më të ulët të limitit të rezultateve të sistemit të kamerës stereoskopike:

- do të urdhërohet një lëshim duke përdorur shifrën më të ulët në diapazonin e rezultateve të sistemit të kamerës stereoskopike;

- operacionet e lëshimit do të kryhen në përputhje me procedurën e përcaktuar në aneksin 10;

- pasi të kryhen operacionet e lëshimit, eBCD do të modifikohet si në numër (duke përdorur numrin e peshqve që rezulton nga përdorimi i sistemit të kamerës stereoskopike minus numrin e peshqve të lëshuar) dhe peshën mesatare, ndërsa pesha totale nuk do të modifikohet.

iii. kur pesha totale e deklaruar nga anija peshkimit në seksionin e zënies së eBCD-së tejkalon shifrën më të lartë të limitit të sistemit të kamerës stereoskopike:

- nuk do të urdhërohet lëshimi;

- eBCD do të modifikohet për peshën totale (duke përdorur shifrën më të lartë të limitit të rezultateve të sistemit të kamerës stereoskopike), për numrin e peshqve (duke përdorur rezultatet nga sistemi i kamerës stereoskopike) dhe peshën mesatare në përputhje me rrethanat.

b) të sigurojë që për çdo modifikim përkatës të eBCD-së, vlerat (numri dhe pesha) e futur në seksionin 2 do të jenë në përputhje me ato në seksionin 6 dhe vlerat në seksionet 3, 4 dhe 6, nuk do të jenë më të larta se ato në seksionin 2.

5. Dispozitat e zbatueshme për JFO dhe kurthe

1. Vendimet që vijnë si pasojë e dallimeve midis raportit të zënies dhe rezultateve nga programi i sistemit të kamerës stereoskopike do të merren nga autoriteti kompetent i CPC-së së anijes ose të kurthit:

a) bazuar në krahasimin midis totalit të peshave që rezultojnë nga programi i sistemit të kamerës

stereoskopike të të gjitha operacioneve të vendosjes në kosha të tonit nga një JFO/kurthe, me totalin e peshave të zënieve të deklaruara nga anijet pjesëmarrëse në atë JFO ose nga ato kurthe dhe, në rastin e JFO-ve dhe kurtheve që përfshijnë një CPC të vetëm dhe/ose shtet anëtar të BE-së;

b) në nivelin e operacioneve të vendosjes në kosha për JFO-të që përfshijnë më shumë se një CPC dhe/ose shtet anëtar të BE-së, përveç rasteve kur bihet dakord ndryshe nga të gjitha autoritetet kompetente të CPC-së/shtetit anëtar të BE-së të anijeve të peshkimit të përfshira në JFO.

2. Në rast të kompensimit të diferencave në peshë midis asaj që është përcaktuar nga kamera stereoskopike dhe e zënies korresponduese të gjetur në në të gjitha raportet individuale të vendosjes në kosha nga një JFO ose kurthe të të njëjtit shtet anëtar të CPC/BE, pavarësisht nëse është kërkuar apo jo urdhër lëshimi, të gjitha eBCD përkatëse do të modifikohen në bazë të limitit më të ulët të rezultateve të sistemit të kamerës stereoskopike.

3. eBCD në lidhje me sasitë e tonit të lëshuar do të modifikohet, gjithashtu, për të pasqyruar peshën dhe numrin përkatës të peshkut të çliruar. eBCD në lidhje me tonin që nuk është lëshuar, por për të cilin rezultatet nga sistemet e kamerave stereoskopike ose teknikat alternative ndryshojnë nga ato të raportuara të zënies dhe të transferimit, gjithashtu do të ndryshohet për të pasqyruar këto dallime.

4. eBCD-ja e zënies nga ku është kryer operacioni i lëshimit do të modifikohet, gjithashtu, për të pasqyruar peshën/numrin e lëshuar.

ANEKSI I SHTOJCËS 9
METODA PËR LLOGARITJEN E MARZHIT TË GABIMIT DHE DIAPAZONIT TË SISTEMIT TË KAMERËS STEREOSKOPIKE

Në përputhje me atë që u ra dakord në mbledhjen ndërsesionale të panelit 2 (mars 2020), përdoret metoda e mëposhtme për llogaritjen e marzhit të gabimit dhe diapazonit të sistemit të kamerës stereoskopike:

1. Llogaritja e diapazonit të gjatësisë në bifurkim (FLi) për çdo kampion (i) duke marrë parasysh kufirin e gabimit FL të dhënë nga sistemi (gabim%):

Diapazoni i gjatësisë identifikohet për çdo mostër (i) nga [FLmin,*i* , FLmax,*i*]

$FL_{min,i}$ = FLi-(FLi*error%): është vlera minimale për diapazonin e gjatësisë në bifurkim për çdo mostër (i)

$FL_{max,i}$ = FLi+ (FLi*error%): është vlera maksimale për diapazonin e gjatësisë në bifurkim për çdo mostër (i)

2. Konvertimi i diapazonit të gjatësisë në një peshë të rrumbullakët (RTW) për çdo mostër (i), duke aplikuar algoritmin e përdorur për të kthyer gjatësinë në peshë:

Diapazoni i peshës së rrumbullakët identifikohet për kampion (i) nga [RTWmin,*i*, RTWmax,*i*]

RTWmin,i: është vlera minimale e diapazonit të peshës së rrumbullakët për çdo kampion (i)

RTWmax,i: është vlera maksimale e diapazonit të peshës së rrumbullakët për çdo kampion (i)

3. Llogaritja e diapazonit mesatar të peshës së rrumbullakosur:

diapazoni mesatar i peshës së rrumbullakët për "n" mostra identifikohet nga

[RTWaveragemin, RTWaveragemax]

$$RTWaveragemin = \mathbf{1}n\Sigma RTWmin,i=\mathbf{1}$$: është vlera minimale për diapazonin mesatar të peshës rrumbullakosur

$$RTWaveragemax = \mathbf{1}n\Sigma RTWmax,i=\mathbf{1}$$: është vlera maksimale për diapazonin mesatar të peshës rrumbullakosur

4. Llogaritja e përqindjes së marzhit të gabimit (%) të sistemit:

$$\frac{(RTWaveragemax - RTWaverage2}{RTWaverage} \times 100$$

RTWaverage: është pesha mesatare e ofruar nga kamera stereoskopike

5. Zbritja e diapazonit të sistemit të kamerës stereoskopike:

Gama e sistemit të kamerës stereoskopike përcaktohet nga:

[Shifra më e ulët e diapazonit, shifra më e lartë e diapazonit]

Më parë, pesha totale llogaritet duke shumëzuar peshën mesatare të dhënë nga kamera stereoskopike me numrin e peshqve që rezultojnë nga përdorimi i kamerës stereoskopike,

d.m.th.: ***RTWtotal = (RTWaverage* Number BFT)***

Kështu, kufijtë e diapazonit llogariten si më poshtë:

Shifra e diapazonit më të ulët = RTWtotal – (sistem marzhi i gabimit * RTWtotal /100)

Shifra më e lartë e diapazonit = totalRTW + (marzhi i sistemit të gabimit *RTW total /100)

SHTOJCA 10
PROTOKOLLI I LËSHIMIT

Lëshimi i urdhrave për lirim

1. Urdhrat e lëshimit përpara se të vendosen në kosh do të lëshohen:

a) nga autoriteti kompetent i operatorit dhurues kur, në bazë të njoftimit paraprak të transferimit, autoriteti kompetent i CPC-së i operatorit dhurues refuzon operacionin e transferimit sipas paragrafit 117; ose

b) nga autoriteti kompetent i CPC-së së fermës kur, në përputhje me paragrafin 154, autorizimi i vendosjes në kosha nuk është lëshuar nga autoriteti kompetent i CPC-së së fermës brenda 1 muaji pas kërkesës për autorizim.

2. Urdhrat e lëshimit pas vendosjes në kosh do të lëshohen:

a) nga autoriteti kompetent i CPC-së së anijes ose kurthit kur, sipas procedurave në paragrafët 180 deri 182, konstatohet se pesha e vendosur në kosh tejkalon atë të raportuar të zënë. Urdhri i lirimit do t'i njoftohet autoritetit kompetent të CPC-së së fermës, i cili ia transmeton atë operatorit të fermës në fjalë; ose

b) nga autoriteti kompetent i CPC-së së fermës kur, pas vjeljes, peshku i mbetur nuk mbulohet nga një eBCD, ose kur një vlerësim i mbartjes (carry-over) ose transferimi i kontrollit ka identifikuar një tepricë të peshkut.

Për rastet sipas seksionit 2(a) më sipër, pesha totale e tonit të kuq që lëshohet do të konvertohet në një numër korrespondues individësh, duke aplikuar peshën mesatare që rezulton nga analiza e pamjeve video të kamerës stereoskopike, në lidhje me operacionin përkatës të vendosjes në kosha, të bëra nga autoriteti kompetent i CPC-së së fermës në përputhje me paragrafin 169 të Rekomandimit.

Ndarja e peshkut përpara operacionit të lëshimit

3. Përpara lirimit nga koshi i fermës, autoriteti kompetent i CPC-së së fermës duhet të sigurojë që:

- peshku që do të lëshohet ndahet dhe zhvendoset në një kosh transporti bosh, dhe transferimi i peshkut në koshin e transportit monitorohet nga kamera e kontrollit në ujë, në përputhje me standardet minimale të përcaktuara në aneksin 8;
- numri i peshqve të ndarë për lirim korrespondon me urdhrin e lëshimit.

4. Ndarja paraprake e peshkut që lëshohet do të kryhet në prani të një vëzhguesi rajonal të ICCAT-it.

Raportimi

6. Për çdo operacion lëshimi të kryer, dhuruesi ose operatori i fermës përgjegjëse për lëshimin, duhet të plotësojë një raport lëshimi, duke përdorur formatin bashkangjitur kësaj shtojce.

7. Vëzhguesi rajonal i ICCAT-it do të vërtetojë informacionin në deklaratën e lëshimit. Dhuruesi ose operatori i fermës duhet t'ua dorëzojë deklaratën e lëshimit autoriteteve të tij brenda 48 orëve nga fillimi i operacionit të lëshimit për t'ia transmetuar Sekretariatit të ICCAT-it.

Dispozitat e përgjithshme

8. Operacionet e lëshimi nga koshiloku, kurthi ose koshi transporti duhet të kryhen menjëherë pas marrjes së urdhrit të lëshimit.

9. Operacionet e lëshimit nga fermat duhet të kryhen brenda 3 muajve nga operacioni i fundit i vendosjes në kosh të peshkut në fjalë dhe në një distancë minimale prej 10 miljesh nga ferma. Për lëshimet e më pak se 5 mt ton, autoriteti kompetent i CPC-së i fermës mund të caktojë një distancë më të shkurtër, prej të paktën 5 miljesh, për lëshimin.

10. Kapiteni i anijes tërheqëse ose operatori i fermës do të jetë përgjegjës për mbijetesën e peshkut derisa të kryhet operacioni i lëshimit.

11. Autoriteti kompetent i CPC-së së fermës mund të zbatojë çdo masë shtesë që ata e gjykojnë të nevojshme për të garantuar që operacionet e lëshimit të zhvillohen në kohën dhe vendin më të përshtatshëm në mënyrë që të rritet probabiliteti i kthimit të peshkut në rezervë.

Raporti ICCAT-it për lëshimet

<table>
<tr><td colspan="2">Raporti ICCAT për lëshimet</td><td colspan="2">Nr. dokumenti</td></tr>
<tr><td colspan="4">1. Të dhënat mbi zëniet/vendosjen në kosha</td></tr>
<tr><td colspan="4">Ferma/anija/kurthi/anije tërheqëse që kryen lëshimin:
Numri i regjistrit ICCAT:
Referenca e urdhrit së lëshimit:
Anije/kurth (1):
Numri JFO:
Numri i autorizimit të vendosjes në kosha (1):
Numri i koshit të lëshimit:
Referencat e eBCD (s)
Numri i autorizimit të lëshimit:</td></tr>
<tr><td colspan="4">2. Të dhëna mbi operacionet e lëshimit</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lloji i lëshimit (3):
Data e operacionit:
Emri i anijes tërheqëse:
Numri i regjistrit të ICCAT-it:
Flamuri:
Ndarja e peshkut përpara operacionit të lëshimit:
Numri i koshit të verifikimit:
Numri i koshit të lëshimit:
Numri i individëve BFT të liruar:
Pesha e BFT-së e lëshuar (kg):</td></tr>
<tr><td colspan="2">Emri i operatorit, data dhe nënshkrimi (2):</td><td colspan="2">Emri i vëzhguesit, nr. ICCAT, data dhe nënshkrimi:</td></tr>
<tr><td>Prezenca e vëzhgueseve në bord (Po/Jo)</td><td colspan="2">Arsyet e mosdakordësisë:</td><td>Rregullat ose procedurat e parespektuara:</td></tr>
</table>

1) Vetëm për lëshimet nga fermat.

2) Nënshkrimi i operatorit të fermës për lëshimet nga fermat, ose kapiteni të anijes së peshkimit për lëshimet e urdhëruara për anije zënëse ose anije tërheqëse.

3) Lëshimi pas përfundimit të raporteve të vendosjes në kosha (shtojca 9, paragrafi 4); toni i mbetur pas vjeljes që nuk është mbuluar nga një eBCD; teprica e tonit të gjetur pas një transferimi kontrolli ose vlerësimi të mbartjes.

SHTOJCA 11
TRAJTIMI I PESHKUT TË NGORDHUR DHE/OSE TË HUMBUR

Regjistrim i tonit të ngordhur ose të humbur

1. Sasia (numri) i tonit që ngordh gjatë çdo operacioni të rregulluar në këtë Rekomandim do të raportohet nga operatori dhurues në rastin e një operacioni transferimi dhe transporti shoqërues, ose operatori i fermës në rastin e një operacioni të vendosjes në kosh ose aktivitetit të kultivimit, dhe zbritet nga kuota e CPC-së përkatëse.

2. Për qëllimet e kësaj shtojce, peshqit e humbur u referohen individëve të munguar të tonit, të cilët, pas diferencave të mundshme të zbuluara gjatë hetimit të përmendur në paragrafin 174, nuk janë justifikuar si të ngordhur.

Trajtimi i peshqve që ngordhin gjatë transferimit të parë

3. Toni që ngordh gjatë zënies dhe transferimit të parë nga një anije me koshilok ose kurth do të regjistrohet në *logbook*-un e anijes me koshilok ose në raportin ditor të zënies së kurthit dhe raportohet në deklaratën e transferimit të ICCAT (ITD) dhe në seksionin e transferimit të eBCD-së.

4. eBCD-ja do t'u jepet anijeve tërheqëse me seksionin 2 (Zënie totale), seksionin 3 (Tregtia e peshkut të gjallë) dhe seksionin 4 (Transferimi - duke përfshirë peshqit "të ngordhur") të përfunduar.

5. Seksioni 2 duhet të përfshijë të gjithë individët e ngordhur. Sasitë totale të raportuara në seksionet 3 dhe 4 e eBCD (si dhe individët e ngordhur) do të jenë të barabarta me sasitë e raportuara në seksionin 2, pas zbritjes së të gjitha ngordhjeve të vëzhguara ndërmjet zënies dhe përfundimit të transferimit.

6. eBCD-ja do të shoqërohet nga ITD në përputhje me dispozitat e këtij Rekomandimi.

7. Një ndarje e eBCD me seksionin 8 (Informacioni tregtar) do të plotësohet dhe do t'i jepet anijes ndihmëse, e cila do të transportojë tonin e ngordhur në breg (ose do të mbahet në anijen e

zënies ose në kurth nëse zbarkohet drejtpërdrejt në breg). Ky peshk i ngordhur dhe eBCD-ja e ndarë duhet të shoqërohet me një kopje të ITD-së.

8. Për sa i përket eBCD-së, peshqit e ngordhur do t'i ndahen anijes peshkimit që ka bërë kapjen ose, në rastin e JFO-ve, anijeve pjesëmarrëse në zënie

Trajtimi i peshqve që ngordhin dhe/ose humbasin gjatë transferimeve të mëtejshme dhe operacioneve të transportit.

9. Anijet tërheqëse duhet të raportojnë, duke përdorur formatin bashkangjitur kësaj shtojce, të gjithë tonin e ngordhur gjatë transportit. Linjat individuale do të plotësohen nga kapiteni sa herë që zbulohet ngordhje ose humbje.

10. Në rast transferimesh të mëtejshme, kapiteni i anijes tërheqëse dhuruese duhet t'i japë origjinalin e raportit kapitenit të anijes tërheqëse që merr peshkun ton, duke mbajtur një kopje në bord për kohëzgjatjen e fushatës.

11. Me mbërritjen e një koshi transporti në fermën e destinacionit, kapiteni i anijes tërheqëse do t'i dorëzojë autoritetit kompetent të CPC-së së fermës setin komplet të raporteve të peshqve të ngordhur, duke përdorur formatin e bashkangjitur kësaj shtojce.

12. Për qëllimin e kapjes së kuotës që do të përcaktohet nga CPC-ja e anijes ose kurthit, pesha e peshkut që ngordh ose humbet gjatë transportit vlerësohet, si më poshtë:

a) për peshqit e ngordhur:

i. në rastin e zbarkimit, do të zbatohet pesha efektive në zbarkim;

ii. në rastin kur peshku i ngordhur hidhet, pesha mesatare e vendosur në kohën e mbylljes në kosh do të zbatohet për numrin e individëve të hedhur;

b) për peshqit që konsiderohen ndryshe si të humbur në momentin e hetimit të përmendur në paragrafin 174, pesha mesatare individuale e vendosur në kohën e mbylljes së koshit do të zbatohet për numrin e individëve që konsiderohen të humbur, siç përcaktohet autoriteti kompetent i CPC-së i anijes ose kurthit që rezulton nga analiza e tij e filmimit të parë të transferimit të videos në kontekstin e hetimit.

Trajtimi i peshqve që ngordhin gjatë operacioneve të vendosjes në kosha

13. Peshqit që ngordhin gjatë operacioneve të vendosjes në kosha raportohen nga operatori në deklaratën e përkatëse. Autoriteti kompetent CPC i fermës do të sigurojë që numri dhe pesha e peshkut që ngordh të raportohet në fushën përkatëse të seksionit 6 të eBCD-së.

Trajtimi i peshqve që ngordhin dhe/ose humbasin gjatë aktiviteteve të rritjes në kosha

14. Peshqit e ngordhur ose të humbur në ferma ose ata që zhduken nga fermat, duke përfshirë peshqit e supozuar të vjedhur ose të arratisur, duhet të raportohen nga operatori i fermës tek autoriteti kompetent i CPC-së së fermës menjëherë pasi të jetë zbuluar ngjarja. Raporti i operatorit të fermës shoqërohet me provat e nevojshme mbështetëse (ankesë për peshkun e vjedhur, raport dëmtimi në rast dëmtimi të kafazit etj.). Pas marrjes së një raporti të tillë, autoriteti kompetent i CPC-së së fermës do të zbatojë ndryshimet e nevojshme ose anulimin e eBCD-së në fjalë (duke ndjekur zhvillimet e nevojshme në sistemin eBCD).

SHTOJCA 12
DEKLARATA ICCAT PËR VENDOSJEN NË KOSHA

<table>
<tr><td colspan="2">Deklarata ICCAT për vendosjen në kosha</td><td colspan="2">Nr. dokumenti</td></tr>
<tr><td colspan="4">1. Vendosja në kosha e tonit</td></tr>
<tr><td colspan="2">Emri i fermës:
Numri i regjistrit të ICCAT-it:
Numri i autorizimit të vendosjes në kosh:
Numri i koshit të transportit:
Numri i koshit të fermës:
Data e mbylljes:</td><td colspan="2">Emri i anijes tërheqëse:
Numri i regjistrit të ICCAT-it:
Flamuri:
Numri JFO:
Numri/at eBCD:
Numri/at e deklaratës së transferimit (ITD):</td></tr>
<tr><td colspan="4">Toni që ngordh gjatë transportit (1):</td></tr>
<tr><td colspan="4">2. Informacion për vendosjet në kosha – operator i fermës dhe vëzhgues ICCAT (2)</td></tr>
<tr><td></td><td>Operator i fermës</td><td colspan="2">Vëzhgues ICCAT</td></tr>
<tr><td>Numri i individëve</td><td></td><td colspan="2"></td></tr>
</table>

Sasia në kg		N/A
Numri dhe sasia e tonit të ngordhur gjatë vendosjes në kosha		
Emri, data dhe nënshkrimi i operatorit të fermës:	Emri i vëzhguesit, nr. ICCAT, data dhe nënshkrimi:	
Prania e vëzhguesit: (Po/Jo)	Arsyet e mosmarrëveshjes:	Rregullat ose procedurat e parespektuara:
3. Informacion për vendosjen në kosha - Autoriteti i CPC-së së fermës		
Numri i individëve	Sasia në kg	
Zyrtari i autoritetit të CPC-së, data dhe nënshkrimi:		

1) Numri total dhe pesha (kg) e BFT-së e raportuar e ngordhur nga kapiteni/ët e anijes/ve tërheqëse që kanë transportoi peshkun në kosha.

2) Sasitë e përcaktuara nga operatori i fermës dhe vëzhguesi i ICCAT-it pas analizimit të kamerës stereoskopike pamjet e operacionit të mbylljes.

3) Sasitë e përcaktuara nga autoritetet e fermës CPC për funksionimin aktual të vendosjes në kosha kur të dhënat janë të disponueshme.

SHTOJCA 13
MINIMUMI I INFORMACIONI TË AUTORIZIMIT PËR PESHKIM

A. Identifikimi:

1. Numri regjistrit ICCAT;
2. Emri i anijes së peshkimit;
3. Numri i jashtëm i regjistrimit (germa dhe numra);

B. Kushtet e peshkimit;

1. Data e lëshimit të autorizimit;
2. Periudha e vlefshme;
3. Kushtet e autorizimit të peshkimit, duke përfshirë, kur është e mundur, speciet, zonën e peshkimit, rrjetat e peshkimit dhe çdo kusht tjetër të aplikueshëm që rrjedh nga ky rekomandim dhe ose legjislacioni kombëtar.

	Nga ... në	**Nga ... në**	**Nga ... në**	**Nga ... në**	**Nga ... në**
Zonat					
Speciet					
Mjetet e peshkimit					
Kushte të tjera					

SHTOJCA 14
PROCEDURA PËR OPERACIONET E MBYLLJES(VULOSJES) TË KOSHAVE TË TRANSPORTIT

Përpara vendosjes së tyre në një anije me koshilok, një kurth ose një anije tërheqëse, ofruesi përgjegjës për ROP-në dhe autoritetet kompetente kombëtare duhet të sigurojnë një minimum prej 25 vulash ICCAT për çdo vëzhgues rajonal dhe kombëtar të ICCAT-it nën përgjegjësinë e tyre dhe të mbajnë një regjistër të vulave të ofruara dhe të përdorura.

Operatori dhurues do të jetë përgjegjës për vulosjen e koshave. Për këtë qëllim, në secilën derë të koshit duhet të vendosen të paktën tri vula, të vendosura në mënyrë që të pengojnë hapjen e dyerve pa thyer vulat.

Operacioni i vulosjes do të regjistrohet në video nga operatori dhurues dhe do të lejojë identifikimin e vulave dhe verifikimin nëse vulat janë vendosur siç duhet. Videoja duhet të jetë në përputhje me paragrafin 1/ "a", "b", "c" të aneksit 8. Regjistrimi video duhet të shoqërojë peshkun deri në fermë. Një kopje të mbahet në bordin e anijes dhuruese ose kurthit, dhe mbetet e aksesueshme për qëllime kontrolli në çdo kohë gjatë fushatës së peshkimit. Një kopje e pamjeve video duhet t'i vihet në dispozicion vëzhguesit rajonal të ICCAT-it në bordin e anijes me koshilok ose në kurth, ose vëzhguesit kombëtarë në anijen tërheqëse marrëse, për t'i transmetuar autoritetit kompetent të CPC-së ose vëzhguesit rajonal të pranishëm në transferimin e mëpasshëm të kontrollit.

Pamjet video të transferimit të mëvonshëm të kontrollit do të përfshijnë operacionin e çvulosjes, i cili do të kryhet në mënyrë të tillë që të lejojë identifikimin e vulave dhe verifikimin që vulat nuk janë ngacmuar.

SHTOJCA 15
FORMATI PËR DEKLARATËN E PËRPUNIMIT DHE TË VJELJES

Përpunim/vjelje (lutemi rrethoni këtu)
Data e vjeljes (d.m.v): . .
Ferma/kurthi (lutemi rrethoni këtu)
Numri i koshit:
Numri i individëve të vjelë:
Pesha e gjallë e tonit të kuq të vjelë:
Pesha e tonit të kuq të përpunuar:
Nr. eBCD i tonit të kuq të vjelë:
Të dhënat e anijes ndihmëse të përfshirë në operacionet e peshkimit: Emri: Flamuri: Nr. i regjistrimit ICCAT:
Destinacioni i tonit të kuq (eksport, treg i brendshëm, të tjera) (lutemi rrethoni këtu) Në rast të destinacioneve të tjera, të specifikohen:
Validimi nga vëzhguesi rajonal i ICCAT-it ose vëzhguesi i CPC-së: Emri i vëzhguesit: Nr. ICCAT: Nënshkrimi:

VENDIM
Nr. 212, datë 27.6.2023

MBI MIRATIMIN E "UDHËZUESIT PËR TESTIMIN E TREGUT PËR GAZSJELLËSIN TRANS ADRIATIK"

Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 13, 15, pika 1, germa "a"; 16, pika 24 dhe nenit 108, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar; dispozitave të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë së Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë (Opinioni Përfundimtar i Përbashkët), korrik 2013; Opinionit 1/2013, të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, datë 14 maj 2013, "Mbi përjashtimin e ndërlidhësit TAP AG, nga kërkesa të caktuara sipas direktivës 2009/73/EC, nga Autoriteti Rregullator i Energjisë i Shqipërisë", rregullores së Komisionit (BE) 2017/459, të datës 16 mars 2017, "Për vendosjen e një kodi rrjeti për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit dhe shfuqizimin e rregullores (BE) nr. 984/2013" (Mekanizmi për Alokimin e Kapacitetit për Kodin e Rrjetit); vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 103, datë 26.6.2019, "Mbi miratimin e transpozimit të rregullores 2017/459, të miratuar me vendimin nr. 2018/06/PHGL-ENC 'Mbi themelimin e kodit të rrjetit për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit"; si dhe neneve 15 dhe 26, të "Rregullores për organizimin, funksionimit dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 27.6.2023, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, me nr. 1839/2 prot., datë 26.6.2023, "Mbi miratimin e 'Udhëzuesit për testimin e tregut për Gazsjellësin Trans Adriatik",

konstatoi se:

Duke pasur parasysh:

- Direktivën 2009/73/EC, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të 13 korrikut 2009, "Për rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror dhe shfuqizimin e direktivës 2003/55/EC)";

- Direktivën (BE) 2019/692, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të 17 prillit 2019, "Për shfuqizimin e direktivës 2009/73/KE, në lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror";

- Rregulloren e (BE) 2017/459, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të 16 marsit 2017 (CAM NC) "Për vendosjen e një kodi rrjeti për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit dhe shfuqizimin e rregullores (BE) nr. 984/2013";

- Rregulloren 2019/942/EC, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të 5 qershorit 2019, "Për tregun e brendshëm të energjisë elektrike";

- Vendimin e Komisionit Evropian, të 16 majit 2013, që përmban "Përjashtimin e Gazsjellësit Trans Adriatik nga aksesi i palëve të treta, rregullimin e tarifave dhe ndarjen e pronësisë të përcaktuara në nenet 9, 32, 41(6), 41(8), 41(10), të direktivës 2009/73/EC;

- Rregulloren 715/2009/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 13 korrik 2009, "Mbi kushtet e aksesit në rrjetet e transmetimit të gazit natyror dhe shfuqizimin e rregullores (EC) nr. 1775/2005";

- Paragrafin 4.1.7, të Opinionit të Përbashkët, ku TAP AG duhet rregullisht (të paktën çdo dy vjet) të kryejë një testim tregu me qëllim që t'u ofrojë të gjitha palëve të interesuara kapacitetet shtesë derisa të arrihet mundësia maksimale e zgjerimit të tubacionit;

- Testimi i tregut, i referuar në paragrafin e mëparshëm, duhet të kryhet në përputhje me udhëzimet e miratuara bashkërisht nga Autoritetet Rregullatore të Energjisë, konkretisht Shqiptare (ERE), Greke (RAE) dhe Italiane (ARERA).

- Në datën 29 gusht 2011, TAP AG paraqiti në Ministrinë Italiane të Zhvillimit Ekonomik dhe në datën 31 gusht 2011 paraqiti tek Autoriteti Rregullator i Energjisë në Greqi (RAE) "Aplikimin e përjashtimit për Gazsjellësin Trans Adriatik", siç parashikohet në nenin 36, të direktivës së gazit 2009/73/EC. Në datën 1 shtator 2011, TAP AG paraqiti tek Enti Rregullator i Energjisë (ERE) "Aplikimin e përjashtimit të Gazsjellësit Trans Adriatik", sipas nenit 22, të direktivës së gazit 2003/55/EC.

- Në qershor 2013, Ministria e Zhvillimit Ekonomik e Italisë, RAE dhe ERE morën vendimin për përjashtimin e ndërlidhësit TAP AG, nga kërkesa të caktuara, sipas direktivës 2009/73/EC, duke miratuar Opinionin Përfundimtar të Përbashkët, një dokument i shkruar në mënyrë të

përbashkët nga ARERA, ERE dhe RAE (këtu dhe më poshtë: "Autoritetet" dhe e ndryshuan për t'u përputhur me vendimin e Komisionit [C(2013)2949 përfundimtar] datë 16 maj 2013, duke marrë parasysh Opinionin 1/2013 të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë datë 14 maj 2013.

- Në datën 16 mars 2017, u miratua rregullorja e re e BE-së 459/2017, "Për krijimin e Kodit të Rrjetit për mekanizmat e alokimit të kapacitetit tek sistemet e transmetimit të gazit dhe shfuqizimin e rregullores së (BE) nr. 984/2013". Rregullorja e BE-së 2017/459 (këtu dhe më poshtë CAM NC) krijon një Kod Rrjeti ku përcaktohen mekanizmat për alokimin e kapacitetit në sistemet e transmetimit të gazit për kapacitetin ekzistues dhe kapacitetin në rritje.

- Në datën 16 qershor 2023, në përputhje me paragrafin 4.1.7, të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët, TAP AG u ka paraqitur autoriteteve "Udhëzimet e vitit 2023 për testimin e tregut të Gazsjellësit Trans Adriatik" (këtu dhe më poshtë: "Udhëzimet 2023").

Gjithashtu, duke pasur parasysh:

- Udhëzimet 2023 të propozuara, sikurse përmbledhur më lart, janë në përputhje me parimet e deklaruara në Opinionin e Përbashkët Përfundimtar, në CAM NC, në të gjitha legjislacionet kombëtare dhe nuk paraqesin barriera të panevojshme në procesin e parashikuar për ndërtimin e kapaciteteve shtesë.

- Procesi është projektuar në atë mënyrë që të lehtësojë bashkëpunimin me OST-të fqinje, me synimin për të siguruar një zhvillim të koordinuar të rrjetit, duke shmangur mospërputhjet e mundshme në ndërtimin e kapaciteteve ndërkufitare; Udhëzimet 2023 marrin parasysh nevojën për të siguruar koordinimin e duhur me testimin e tregut 2021 ende të hapur.

- OST-të janë ende duke vlerësuar mundësinë e përfundimit me një raund të dytë ofertash detyruese që mund të zhvillohen ndërmjet fundit të vitit 2023 dhe fillimit të vitit 2024, për testin e tregut. Udhëzimet 2023 parashikojnë koordinimin e kohës në mënyrë që caktimi i detyrueshëm i kapacitetit të bëhet pasi të përfundojë faza e dytë e detyrimit të procedurës së mëparshme të nisur në vitin 2021.

- Dokumentin e datës 16 qershor 2023, që TAP AG dërgoi "Udhëzimet e testimit të tregut 2023" (shtojca B e kësaj dispozite), në lidhje me ekzaminimin e ofertave të reja të mundshme të kapacitetit në rritje për autoritetet për miratim.

- Autoritetet, pas analizimit të "Udhëzimit të testimit të tregut 2023", i cili në thelb përfshin të njëjtat parime të ndjekura për testimin e tregut 2021, së bashku zhvilluan një dokument që përmban vendimin e miratimit dhe arsyet përkatëse (shtojca A) e këtij vendimi;

- Dokumenti i përbashkët është objekt miratimi edhe nga rregullatorët e Italisë dhe Greqisë, përkatësisht ARERA dhe RAE.

- Procedura e testit të tregut 2023, e propozuar nga TAP AG, është në përputhje me parimet e paraqitura në Opinionin e Përbashkët Përfundimtar dhe me direktivat e rregulloret evropiane për alokimin e kapacitetit ekzistues dhe rritës.

- Nevoja e miratimit të dokumentit të përbashkët që aprovon "Udhëzimet e testimit të tregut 2023" (shtojca a).

- Nevojshmërinë që shtojcat e kësaj dispozite (shtojca a dhe shtojca B) të mbahen konfidenciale të paktën deri në fillimin e testimit të tregut 2023, pasi dokumenti i miratuar "Udhëzuesi për testimin e tregut për Gazsjellësin Trans Adriatik 2023" do të publikohet nga TAP AG në faqen e saj në datën e fillimit të testimit të tregut.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë "Udhëzuesin për testimin e tregut për Gazsjellësin Trans Adriatik 2023" dokumenti i paraqitur nga TAP AG, më 16 qershor 2023 (shtojca B), si edhe të shprehet në vendimin e përbashkët me rregullatorët e Italisë dhe Greqisë, përkatësisht ARERA dhe RAE (shtojca A).

2. Të dërgojë një kopje të këtij vendimi Autoriteteve Rregullatore ARERA dhe RAE, kompanisë TAP AG, si dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

3. Të publikojë këtë vendim në faqen e internetit të ERE-s: www.erealb@ere.gov.al, (vendimin pa anekset A dhe B).

4. Të publikojë anekset A dhe B në faqen e internetit të ERE-s pasi TAP AG ka publikuar "Udhëzuesin për testimin e tregut për Gazsjellësin Trans Adriatik 2023" në faqen e saj të internetit.

5. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët të versionit shqip.

6. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë shoqërinë TAP AG, Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Rregullatorin e Italisë ARERA dhe Rregullatorin e Greqisë RAE për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 268, datë 11.9.2023

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "JOINT VENTURE 2B 1979 DHE 2T" SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1950 kw

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa "a", 38, pika 1, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a" dhe 13 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.9.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1964/18 prot., datë 8.9.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes "Mbi licencimin e shoqërisë 'Joint Venture 2B 1979 dhe 2T' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 1950 kW",

konstatoi se:

- Shoqëria "Joint Venture 2B 1979 dhe 2T" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1964 prot., datë 25.7.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në zonën Grykë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 214, datë 3.8.2023, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Joint Venture 2B 1979 dhe 2T" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për arsye se në këtë aplikim nuk ishte depozituar asnjë dokument, ku Bashkimi i Përkohshëm i shoqërive "2T" sh.p.k. dhe "2B 1979" sh.p.k., i cili mban dhe miratimin e MIE-s për ndërtimin e centralit fotovoltaik, me nr. 7234/2 prot., datë 22.11.2022, t'i ketë njohur të drejtën shoqërisë "Joint Venture 2B 1979 dhe 2T" sh.p.k. për të operuar këtë central.

- ERE, ka njoftuar shoqërinë për vendimin nr. 214/2023 me shkresën nr. 1964/6 prot., datë 8.8.2023 dhe i ka dhënë udhëzimet përkatëse në mbështetje të përcaktimeve të nenit 10, pika 7 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" e ndryshuar.

- Shoqëria "Joint Venture 2B 1979 dhe 2T" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1964/7 prot., datë 10.8.2023, brenda afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 7 të rregullores, ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 251, datë 16.8.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Joint Venture 2B 1979 dhe 2T" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në zonën Grykë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 17.8.2023 dhe 18.8.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 26.8.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1964/12 prot., datë 29.8.2023, nr. 1964/14, datë 7.9.2023 dhe nr. 1964/16 prot., datë 8.9.2023, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues për këtë aplikim.

- Në vijim të depozitimit dhe verifikimit në ERE të deklaratës noteriale, nr. 3723 rep., nr. 1949 kol., datë 10.8.2023, nëpërmjet së cilës përkatësisht shoqëria "2T" sh.p.k., shoqëria "2 B 1979" sh.p.k. dhe shoqëria "Joint Venture 2B 1979 dhe 2T" sh.p.k., deklarojnë se: *Sipas miratimit për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2mw, dhe veprave ndihmëse, në zonën Grykë, Bashkia Fier, qarku Fier" nr. 7234/2, datë 22.11.2022, shoqëria "Joint Venture 2B 1979 dhe 2 T sh.p.k." do të kryejë operimin e impiantit gjatë të gjithë periudhës së afatit të licencës,* është depozituar nga shoqëria dhe shkresa e datës 28.8.2023, me anë të së cilës është vënë në dijeni MIE se Bashkimi i Përkohshëm i shoqërive "2T" sh.p.k. dhe "2B 1979" sh.p.k., në referencë të kontratës së nënshkruar me MIE-n me nr. 7234/2 prot., datë 22.11.2022, kanë krijuar shoqërinë "Joint Venture 2B 1979 dhe 2T" sh.p.k., për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaik.

- Duke qenë se miratimi për pikën e lidhjes me rrjetin e shpërndarjes dhe VNM-së paraprake janë dhënë për kapacitetin 1950 kw, ndërkohë që në kontratën me MIE-n nr. 3110 rep., nr. 1429 kol., datë 19.5.2023, është parashikuar që kapaciteti i centralit është 2 *mw*, aplikuesi ka sqaruar se: *"Fuqia e impiantit për arsye teknike është parashikuar të jetë 1950 kw ose 1.95 mw. Kjo fuqi nuk tejkalon kapacitetin e lejuar prej 2 mw të aprovuar nga MIE".*

- Në nenin 3 të kontratës nr. 3110 rep., nr. 1429 kol., datë 18.5.2023, është përcaktuar se *në çdo rast, kapaciteti nuk mund të kalojë mbi 2 mw.*

- Për sa më sipër, vlerësohet që dhe licenca e prodhimit të energjisë elektrike të jepet për kapacitetin e instaluar 1950 kw.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit dhe ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të nenit 9, të rregullores, pikën 1.1, germat "a", "b" dhe "c"; pikën 1.2, germat "a", "b" "c" dhe "d"; pikën 1.3, germat "a", "b" dhe "c"; pikën 2.1, germat "a", "b", "c", "d", "e" dhe "f".

- Shoqëria ka depozituar në ERE garancinë e lëshuar nga shoqëria prodhuese e paneleve elektrike, në të cilin është përcaktuar garancia 30-vjeçare e tyre. Në referencë të përcaktimeve të nenit 38, pika 1, germa "a" të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa "a" të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar, afati i licencës për prodhimin e energjisë elektrike do të jetë 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Joint Venture 2B 1979 dhe 2T" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 1950 kW, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "Joint Venture 2B 1979 dhe 2T" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 269, datë 11.9.2023

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s PËR APLIKIMIN E SHOQËRISË "SELCA ENERGJI" SHPK PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "SELCA"

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës

së Shqipërisë", si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.9.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1974/6 prot., datë 8.9.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes "Mbi zgjatjen e vendimmarrjes për aplikimin e shoqërisë 'Selca Energji' sh.p.k. për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC 'Selca'",

konstatoi se:

- Shoqëria "Selca Energji" sh.p.k., e licencuar për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC "Selca", me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 39, datë 5.5.2010, i ndryshuar, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1974 prot., datë 27.7.2023, paraqiti aplikimin për modifikimin e licencës, për rritjen e kapacitetit të instaluar të HEC "Selca" nga 1,6 mw në 1,98 mw.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 245, datë 9.8.2023, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Selca Energji" sh.p.k., me vendimin nr. 39/2010, i ndryshuar.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës (në datat 10.8.2023 dhe 11.8.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 19.8.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1974/3 prot., datë 18.8.2023, ERE iu drejtua Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), për dijeni shoqërisë "Selca Energji" sh.p.k., duke kërkuar qëndrimin e MIE-s mbi mënyrën e trajtimit të kërkesës për modifikim licence në ERE, në kuadër të shtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga centralet e prodhimit të energjisë elektrike të privatizuara. Nga MIE nuk ka ende një përgjigje lidhur me kërkesën e ERE.

- ERE me shkresën nr. 1974/4 prot., datë 22.8.2023, i njoftoi shoqërisë mbi marrjen e vendimit nr. 245/2023 dhe evidentoi dokumentacionin që nevojitet të plotësohet.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1974/5 prot., datë 24.8.2023, shoqëria "Selca Energji" sh.p.k. ka ritheksuar se Hidrocentrali i Selcës është një HEC ekzistues (ndërtuar në vitin 1968) i privatizuar, në pronësi të shoqërisë "Selca Energji" sh.p.k. Shoqëria nuk ka një kontratë koncensioni me Ministrinë e Energjisë pasi Hidrocentrali është i privatizuar në pronësi të shoqërisë dhe në këto rrethana nuk ka detyrime ligjore raportuese apo varësie ndaj këtij institucioni. Po ashtu, shoqëria ka dokumentuar në format fotokopje miratimin për shtesën e kapacitetit për lidhjen me rrjetin e sistemit të shpërndarjes nga OSSH sh.a. në të cilën nuk paraqitet ndryshim në skemën e lidhjes.

- Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se nevojitet të plotësohet dokumentacioni në vijim:

Neni 15 "Modifikimi i licencës",

Pika 4

- germa "d": miratimin/qëndrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në lidhje me trajtimin e rasteve për ndryshimin e kapacitetit të centraleve të prodhimit të energjisë elektrike të privatizuara;

- germa "e": miratimin/qëndrimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit mbi rritjen e kapacitetit të instaluar;

germa "f": miratimin/qëndrimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, në rast se leja për përdorimin e burimit ujor vlen dhe për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC "Selca", me kapacitet të shtuar prej 380 kw.

- Në zbatim të nenit 43, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, ku ndër të tjera citohet se: "...*ERE merr në konsideratë ndikimet e pritshme që modifikimet e iniciuara apo të propozuara sjellin ndaj detyrimeve që i licencuari ka në përputhje me këtë ligj dhe kushtet e licencës së tij",* si dhe nenit 53, pika 2 e "Kodit të Procedurave Administrative", i cili përcakton se: "*2. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.*".

- Me qëllim marrjen e një miratimi/qëndrimi të mundshëm nga MIE për kërkesën e dërguar nga ERE dhe marrjen e një miratimi/qëndrimi nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe Agjencia e Mbrojtjes së Burimeve Ujore (AMBU), në lidhje me rritjen e kapacitetit të HEC-it "Selca" me 380 kw, vlerësohet të zgjatet deri në 60 (gjashtëdhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi aplikimin e shoqërisë "Selca Energji"

sh.p.k. për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC "Selca".

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 60 (gjashtëdhjetë) ditë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e shoqërisë "Selca Energji" sh.p.k., për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC "Selca".

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "Selca Energji" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me vendimin nr. (11-2023-4767) 952, datë 12.7.2023, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetases Ermira Xhaferri, e datëlindjes 6.2.1968, lindur në Durrës, dhe data e vdekjes është data e humbjes së saj, më 1 korrik 2001, si dhe caktimin e shtetases Fitnete Shaqja si kujdestare të pasurisë së saj.

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2023 - Numri: 142
Datë: 2023/10/02 12:36:22
4afd06a9-0af5-46eb-b19e-e6b2c887aebf

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 256 lekë